



# Koha



## UNT, amanet i të gjithë shqiptarëve

FAQE 12-13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3148 • E martë 15 gusht 2017 15 DEN



## Harrohen autostradat Perëndimore

Tetovë, 14 gusht - Edhe pse tashmë rishikimi i Buxhetit ka marrë formën zyrtare, megjithatë investimet kapitale infrastrukturore për Maqedoninë Perëndimore - gjegjësisht në viset e banuara kryesisht me shqiptarë nuk kanë gjetur vend në këtë buxhet. Bëhet fjalë

për rrugën e Arbërit dhe rrugën Tetovë-Prizren. Të dy këto projekte do të duhet të presin edhe shumë gjatë pa ndonjë afat që të hyjnë në prioritetet e Qeverisë. Ndonëse shtetet fqinje siç është Shqipëria dhe Kosova tashmë nga ana e tyre punojnë intenzivisht në aspektin e

infrastrukturës, siç është autostrada Prishtinë-Han i Elezit dhe së fundmi kur Qeveria e Shqipërisë ka ndarë 260 milionë euro për vazhdimin e rrugës së Arbërit, Maqedonia në këtë drejtim nuk ka ndërmarrë asgjë. Profesori universitar, Vullnet Palloshi...

Faqe 7

Para zgjedhjeve lokale shumica në veprim

## Shqipja më 15 shtator para deputetëve



Siç merr vesh gazeta KOHA nga burime parlamentare, partitë e shumicës parlamentare - LSDM, BDI dhe ASH, pritet që më 15 shtator ta miratojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Partive të shumicës u shpejtohet, pasi më 25 shtator fillon edhe fushata parazgjedhore për zgjedhjet lokale

FAQE 3

## Universitetet hapin dyert, nis gara për indekse



Shkup, 14 gusht - Duke nisur me të martën e 15 gushtit, në institucionet e arsimit të lartë në Maqedoni do të fillojë edhe gara për regjistrimin e studentëve të ri për vitin akademik 2017/2018. Siparin e kësaj gare duket se do ta hapin universitetet në gjuhën shqipe, pasi si rrallë ndonjë vit më parë - afati i parë i dorëzimit

të dokumenteve nis njëkohësisht, në të njëjtën ditë në Universitetin e Tetovës, Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Në UT, sipas konkursit të publikuar për regjistrimin e studentëve të rinj, do të ketë 3870 vende të lira, prej të cilave 1405 me kuotën shtetërore,

2005 me bashkëfinancim dhe 460 me korrespondencë. Ndërkaq, në UNT për këtë vit janë siguruar 1850 vende gjithsej, prej të cilave 940 me kuotë shtetërore, 410 me kuotën e bashkëfinancimit dhe 230 vende me korrespondencë. Në universitetin privat të UEJL-së, për këtë vit janë planifikuar...

FAQE 2

NË FOKUS

### Poeti nga Peja që thuri himnin e Turqisë



Biografët shënojnë se Akifi filloi të shkollohej që në moshën 4 vjeçare. Pastaj, pasi nga i ati dhe nga hoxhallarët e këtyre shkollave mësoi arabishten, vazhdoi shkollimin në progimnazin e lagjes Fatih. Aty mësoi turqishten, arabishten, persishten dhe...

FAQE 9

RAJON

### Kosova shqetëson ndërkom-bëtarët

FAQE 14

SPECIALE

### Askush nuk e di se çfarë po ndodh në Venezuelë!

FAQE 16-17

NË FOKUS

### Çfarë nuk dimë për Skënderbeun



FAQE 8





## Rritet shit-blerja e prodhimeve bujqësore

Shkup, 14 gusht - Blerja dhe shitja e produkteve bujqësore në tremujorin e dytë të vitit 2017 u rrit për 11.8 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit para-prak. Gjatë kësaj, tek blera e prodhimeve bujqësore nga prodhues individualë është shënuar rritje për 8.4 për ind, ndërsa shitja e prodhimeve bujqësore për prodhime ekonomike ka rritje për 30.9 për qind. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, rritje të blerjes dhe shitjes së prodhimeve bujqësore është vërejtur tek drithërat, bimët mjekësore, bimët foragjere, frutat, pijet alkoolike, bagëtia, ferma e pulave dhe vezëve dhe peshku. Ulje të blerjes dhe shitjes ka tek bimët e kopshtit, qumështi dhe prodhimet e qumështit. Distribucioni i vlerave të blerjes dhe shitjes të prodhimeve bujqësore tregoi rritje në të tre muajt nga tremujori i dytë.

## Dimovski emërohet kryetari i ri i LSM-së



Shkup, 14 gusht - Darko Dimevski të hënën edhe zyrtarisht e mori funksionin kryetar i Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë. Dimovski në konferencë për shtyp publikoi se Regjistri qendror e ka zbatuar vendimin e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, me të cilin ai është person i autorizuar për përfaqësimin e LSM-së. "Prej sot fillon kapitull i ri i sindikalizmit në Maqedoni, me të cilin do të kthehet dinstituti i punëtorëve dhe të gjithë punëtorët pa dallim nëse janë ose jo anëtarë të LSM-së, do të mund t'i realizojnë të drejtat e tyre", tha Dimovski, duke potencuar se ka pritur dhjetë muaj që Regjistri qendror ta zbatojë vendimin e MPPS.

## Maqedoninë në qershor e kanë vizituar 84.778 turistë

Shkup, 14 gusht - Në Maqedoni në qershor të këtij viti ka pasur 84.778 turistë të cilët kanë realizuar 197.016 bujtje, që është për 18,1 për qind më shumë turistë dhe për 14,6 për qind më shumë bujtje në krahasim me qershorin e vitit të kaluar. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, numri i turistëve vendorë në qershor të këtij viti është rritur për 4,1 për qind në krahasim me qershorin e vitit 2016, ndërsa numri i turistëve të huaj është rritur për 24 për qind. Turistët vendorë kanë realizuar për 8,1 për qind, ndërsa të huajt për 18,2 për qind më shumë bujtje. Në gjashtë muajt e parë të këtij viti numri i turistëve është rritur për 12,6 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ku te turistët vendorë ka rritje për 11,4 për qind, ndërsa te ata të huajt për 13,1 për qind. Në këtë periudhë numri i bujtjeve është rritur për 12,5 për qind. Te turistët vendorë ka rritje për 9,7 për qind, ndërsa te të huajt për 14,3 për qind.

Nga 15 gushti universitetet hapin dyert për regjistrimin e studentëve

# Nis gara për indekse

Në tre universitetet ku studimet zhvillohen në gjuhën shqipe, pra në Universitetin e Tetovës, Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup dhe Universitetin e Evropës Juglindore, janë në dispozicion 6450 vende gjithsej. Mirëpo, studime të cilat mbulohen nga buxheti i shtetit ka vetëm në UT dhe UNT, edhe atë 1405 në të parin dhe 940 në të dytin. Dorëzimi i dokumenteve për regjistrim fillon nga 15 gushti dhe zgjat deri 18 gusht në dy universitetet publike dhe 31 gusht në UEJL

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 14 gusht - Duke nisur me të martën e 15 gushtit, në institucionet e arsimit të lartë në Maqedoni do të fillojë edhe gara për regjistrimin e studentëve të ri për vitin akademik 2017/2018. Siparin e kësaj gare duket se do ta hapin universitetet në gjuhën shqipe, pasi si rrallë ndonjë vit më parë - afati i parë i dorëzimit të dokumenteve nis njëkohësisht, në të njëjtën ditë në Universitetin e Tetovës, Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Në UT, sipas konkursit të publikuar për regjistrimin e studentëve të rinj, do të ketë 3870 vende të lira, prej të cilave 1405 me kuotën shtetërore, 2005 me bashkëfinancim dhe 460 me korrespondencë. Ndërkaq, në UNT për këtë vit janë siguruar 1850 vende gjithsej, prej të cilave 940 me kuotë shtetërore, 410 me kuotën e bashkëfinancimit dhe 230 vende me korrespondencë. Në universitetin privat të UEJL-së, për këtë vit janë planifikuar të regjistrohen 730 studentë të rinj, në programet studimore në Tetovë dhe në Shkup. Studimet në UEJL, janë me vetëfinancim, me çmime që lëvizin nga 650 deri 1000 euro për semestër, për dallim prej studimeve në UT dhe UNT, një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë me kuotën e financimit shtetëror e për të cilat paguhet nga 100 euro semestri. Studimet me kuotën e bashkëfinancimit dhe me korrespondencë, në të dyja universitetet publike, në UT dhe UNT do të kushtojnë nga 200 euro semestri. Në përgjithësi, në tre universitetet ku studimet zhvillohen në gjuhën shqipe, për vitin akademik 2017/2018 do të ketë 6450 vende. Në kuadër të studimeve që mbulohen nga buxheti i shtetit, pra që janë në kuotën shtetërore të fi-



nancimit - janë vetëm 2390 vende edhe atë 1850 në UT dhe 940 në UNT. Risi në programet studimore të këtij viti ofrohen edhe në UNT, ku janë shtuar drejtime dhe profile të reja me interes për tregun e punës. Sipas numrit më të madh të vendeve të lira në UNT, janë Fakulteti i Shkencave Sociale me 540 vende, Fakulteti i Shkencave Teknike (420), Fakulteti i Shkencave Informatike (320), Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (190) dhe Fakulteti i Shkencave Teknologjike (110).

Risia e këtij viti për UT-në është zgjerimi me dy fakultete të reja, Fakulteti Pedagogjik, i cili deri vitin e kaluar ishte në kuadër të Fakultetit Filozofik dhe, Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë, i cili u themelua me akt të veçantë juridik vitin e kaluar. Në këto dy fakultete UT do të pranojë 100, respektivisht 180 studentë. Ndërkaq, nisur nga konkursi për vendet e lira në vitin akademik 2017/2018, fakultetet me numrin më të madh të studentëve në UT janë i Shkencave Matematike Natyrore me 520 vende, i Ekonomisë me 450 vende dhe i Shkencave Mjekësore me 390 vende. Në radhë, për nga numri i vendeve të lira vijon Fakulteti i Shkencave të Zbatuara me 385 vende, Filozofisë me 380 vende, Filologjisë me 370 vende dhe Ju-

ridikut me 330 vende. Për Fakultetin e Administrimit Biznesit në Kumanovë janë caktuar 220 vende të lira, ndërsa me më pak se 200 vende janë Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit (190), ai i Arteve (185), i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë (180), i Kulturës Fizike (170) dhe i Pedagogjisë (100). Dorëzimi i dokumenteve do të zgjat deri më 18 gusht për afatin e parë, ndërsa për afatin e dytë - nga 29 gusht deri më 4 shtator.

Në Universitetin më të madh në vend, në "Kirili dhe Metodi" në Shkup, afati i parë i dorëzimit të dokumenteve për regjistrim në vitin akademik 2017/2018 do të jetë të enjten dhe të premten, në datat 17 dhe 18 gusht. Këtu janë siguruar 10.818 vende, prej të cilave 5865 janë për studentë të rregullt me kuotën shtetërore të financimit, 3793 vende për studentë të rregullt me bashkëfinancim dhe 1116 për studime me korrespondencë. Tarifat e studimeve si në të gjitha universitetet publike për një semestër janë 100 euro për studime me kuotën shtetërore të financimit, si dhe 400 euro në kuotën e bashkëfinancimit dhe në kuotën e studimeve me korrespondencë. Përndryshe, me vendimin që solli Qeveria për kuotat 4 studentëve, për të gjitha universitetet publike janë si-

guruar 26.105 vende, prej të cilave 13.953 për studime të rregullta në kuotën shtetërore, 8367 për studime të rregullta me bashkëfinancim dhe 3785 për studime me korrespondencë. Një vëmendje e veçantë, sikurse është bërë e ditur paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, i është kushtuar studimeve që ofrojnë kualifikime të nevojshme për tregun e punës. "Gjatë konfirmimit të numrave për regjistrim të studentëve është bërë llogari për nevojat e tregut të punës, deficitin e profesioneve dhe mundësitë e disponueshme për punësim, numrin e studentëve për të cilat janë akredituar fakultetet, si dhe për treguesit për interesin e nxënësve të shkollave të mesme për regjistrim në fakultete të caktuara viteve të kaluara", bënte të ditur MASH. Si rezultat të qasjes së diskriminimit pozitiv gjinor dhe eurointegrimi, është marrë vendim që në UKM të aktivizohen studimet gjinore në Fakultetin Filozofik të cilat ishin pezulluar 5 vjetet e kaluara, si dhe studimet për Siguri dhe Eurointegrimi, të cilat gjithashtu ishin të pezulluara viteve të fundit. Për herë të parë këtë vit janë konfirmuar edhe kuotat për regjistrimin e studentëve me vetëm njërin print, në programet të caktuara e që do të paguajnë gjysmën e shumës për regjistrim.

## EDHE NË UNIVERSITETIN E SHITIPIT FILLOI REGJISTRIMI

Në 13 fakultete dhe në tre akademi të Universitetit "Goce Delçev" - Shtip të hënën filloi regjistrimi i studentëve në vitin e parë akademik 2017/2018. Studentët, aplikacionet mund t'i dorëzojnë nesër dhe pasnesër. Sipas analizave të UGD, më atraktive edhe sivjet janë fakultetet për shkencë mjekësore, turizëm dhe biznes-logjistikë. "Viti i 11-të me radhë që Universiteti tenton në mënyrë të integruar dhe unike në një vend, së bashku të gjitha fakultetet dhe të gjitha programet studimore në pajtim me konkursin në Shtip dhe qendrat mësimore të universitetit, t'i organizojë në mënyrë të përshtatshme regjistrimet. Në pajtim me konkursin e universitetit, janë planifikuar 5.200 vende të lira, rreth 3.000 në kuotë të rregullt, rreth 1.200 në kuotë për bashkëfinancim dhe 900 në kuotë për studentë të disperzuar", deklaroi Kiril Barbareev, prorektor i UGD-Shtip. Regjistrimet e studentëve të rinj në Universitetin e Shtipit zhvillohen në foajenë e Shtëpisë së Kulturës "Aco Shopov" në Shtip dhe gjithashtu edhe në qendrat mësimore në Strumicë, Shkup, Kavadar, Prilep, Koçan, Vinicë dhe Radovish. Afati i dyti për regjistrim në UGD Shtip është më 25 dhe 26 gusht, ndërsa i treti është më 5 dhe 6 shtator.





Para zgjedhjeve lokale shumica në veprim

# Shqipja më 15 shtator para deputetëve

Siç merr vesh gazeta KOHA nga burime parlamentare, partitë e shumicës parlamentare - LSDM, BDI dhe ASH, pritet që më 15 shtator ta miratojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Partive të shumicës u shpejtohet, pasi më 25 shtator fillon edhe fushata parazgjedhore për zgjedhjet lokale

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 14 gusht - Për dallim nga vitet tjera, këtë vit deputetët e Parlamentit të Maqedonisë nuk pritet të shkojnë në pushim vjetor, edhe pse një gjë e tillë ishte paralajmëruar. Kjo për shkak të agjendës së ngjeshur politike të ligjvënësist, debatet për shkarkimin e prokurorit publik Marko Zverlevski, më pas miratimi i ligjeve që dalin nga plani qeveritarë 3-6-9, mes të cilëve është dhe ligji për gjuhën shqipe si dhe ligji për nëpunës administrativ.

Siç merr vesh gazeta KOHA nga burime parlamentare, partitë e shumicës parlamentare LSDM, BDI dhe ASH, pritet që më 15 shtator ta miratojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve, me çka do të bëhet një avancim i ndjeshëm i gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e pushtetit qendror dhe atij lokal në Maqedoni. "Më 25 shtator vetëm se fillon fushata parazgjedhore dhe Parlamenti nuk do të punojë efektivisht, ndërsa ligji për shqipen është rënë dakord mes partive që më 15 shtator të miratohet nga ana e deputetëve, ndërsa paraprakisht do të jetë në seancë plenare dhe debati nuk prite të zgjasë shumë", njoftojnë për gazetën KOHA burime nga grupet parlamentare të partive në pushtet. Siç shtojnë këto burime, "duhet pritur të shteret debati për prokurorin e përgjithshëm Marko Zverlevski dhe të shkarkohet ai dhe më pas mund të fillojnë lirshëm punët në Parlament, jo vetëm për miratimin e Ligjit për



## IVANOVI E NËNSHKROI REBALANCIN

Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov dje, brenda afatit ligjor, e nënshkroi rebalancin e buxhetit, konfirmuan për mediat nga Kabineti i Presidentit. Rebalanci i buxhetit u votua nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë para shtatë ditëve. Pas nënshkrimit, rebalanci i buxhetit është dërguar në shërbimet e Kuvendit, ku pason publikimi në "Gazetën Zyrtare" dhe hyn në fuqi.



gjuhët, por edhe për një sërë ligjesh tjera që janë në agjendë të panit 3-6-9". Ndryshe, partitë në pushtet, por edhe ato opozitare, e pranojnë se ende nuk kemi zyrarizim të plotë të gjuhës shqipe, por se propozim ligji që pritet të miratohet, sipas vlerësimit të shumë ekspertëve, krijon konturat kryesore drejt barazisë së gjuhës shqipe me gjuhën maqedonase në një të ardhme shumë të afërt. Që të ndodhë kjo, duhet të ketë zbatim

adekuat, ku barrën kryesore për këtë e ka vetë Qeveria e Republikë së Maqedonisë. "Me propozimin që janë marrë vesh BDI bashkë me ASH-në dhe me LSDM-në, gjuha shqipe sa i përket përdorimit të brendshëm të qytetarëve shqiptarë në raport me ata maqedonas, lirisht mund të thuhet se është e barabartë me gjuhën maqedonase. Kjo ka të bëjë edhe me mbylljen e njëres ndër pikat kyçe të Marrëveshjes së Ohrit për dygjuhësisë në Maqedoni, por

edhe zbatimin e plotë të nenit 7 të kushtetutë së Maqedonisë", thonë nga grupi parlamentar i BDI-së. Ndërkaq, deputeti nga Lëvizja BESA Fadil Zendeli, thotë se propozim-ligji që ata e kanë në duartani e rrit ndjeshëm përdorimin e gjuhës shqipe, por sipas tij gjuha shqipe nuk e fiton statusin e gjuhës së dytë zyrtare, ashtu siç e jep Kushtetuta.

"Edhe më herët e kam thënë dhe po e përsëris se, ky propozim-ligji e avancojnë në një masë të ndjeshme përdorimin e gjuhës shqipe, që është e obligueshme për institucionet shtetërore, por fatkeqësisht jo në të gjitha, p.sh. gjyqësori, ushtria, policia. Nga ana tjetër, nuk është e obligueshme edhe për qytetarët maqedonas as në ato komuna të përziera që dokumentacionet e tyre të jenë edhe në gjuhën shqipe. Prandaj, nuk na lejohet të themi se gjuha shqipe është gjuhë e dytë zyrtare ashtu siç e parashih edhe Kushtetuta në dispozitat e saj", thotë për gazetën KOHA Fadil Zendeli, deputet nga Lëvizja BESA.

Ndryshe, përveç ligjit për gjuhën shqipe, para fillimit të fushatës parazgjedhore është paraparë të miratohet edhe ndryshime të ligjit për nëpunës administrativ, përmes të cilit do të hiqet testi për gjuhën angleze, testi psikologjik dhe testi për integritet.

Ndonëse partitë e shumicës parlamentare janë arsyetuar se këto ndryshime janë kërkuar vazhdimisht nga ana e BE, por nga ana tjetër ata nuk pranojnë ta thonë se me këto ndryshime do të jetë më i lehtë procesi i emërimeve në eshalonin e tretë, atë të drejtorive dhe ndërrimi i pozicioneve udhëheqëse përmes kuadrove të afërta me partitë në pushtet në sektorë të ndryshëm të administratës publike.



## Interpelancë edhe për Taravarin

Sipas VMRO-së, Taravari është ministri i tyre më i keq i Shëndetësisë që qytetarët maqedonas e kanë par

Shkup, 14 gusht - VMRO-DPMNE ka ngritur interpelancë edhe për ministrin e Shëndetësisë, Arben Taravarin, të cilin tre ditë e akuzojnë se fsheh një rast ku një vajzë ka ndërruar jetë për shkak të helmimit të gjakut nga plasja e apandisitit (zorrës qore). "Ministri Taravari është i paguar nga qytetarët që t'i zgjidhë problemet e tyre dhe të kontribuojë për shëndetësi të mirë. Mirë është që Taravari të jetë më shumë në punë sesa në pushim me paratë që i merr. Mirë është që më shumë të bashkëpunojë sesa të shfletojë nëpër internet, por edhe online që del dy muaj e gjysmë nuk ka asnjë farë rezultati në punën e tij", porosisin nga VMRO-DPMNE. Sipas tyre, Taravari është ministri i tyre më i keq i Shëndetësisë që qytetarët maqedonas e kanë parë. Ndërkohë, ministri i Shëndetësisë e ka mohuar një gjë të tillë nëpërmjet një statusi në Facebook. Ai shprehet se asnjë ditë nga puna e tij nuk ka qenë në pushim. Ai gjithashtu kërkon nga VMRO-DPMNE-ja të tregojnë se kush është ajo vajzë që ka ndërruar jetë që institucionet kompetente të marrin masa. "Jam këtu, në Gostivar dhe në Shkup, çdo ditë në punë, asnjë ditë të vetme nuk kam qenë në pushim, vetëm si informatë për ju. Së dyti, më tregoni kush është pacientja që ka ndërruar jetë nga helmimi i gjakut, a ka emër dhe mbiemër, nëse ka duhet të paraqitet në institucionet kompetente që të merren masa! Megjithatë edhe ju e dini se nuk ka rast të tillë. Së treti ju nuk keni kredibilitet të flisni për etikë dhe moral, ju kemi dëgjuar gjatë gjithë vitit sesa keni manipuluar, arrestuar dhe vjedhur...në vend se të shpikni tregime për fëmijë, filloni të reformoheni dhe t'i pastroni radhët tuaja nga kriminelët dhe hajdutët, sepse e di se edhe mes jush ka njerëz të ndershëm dhe të mirë, që duhet të udhëheqin opozitë konstruktive. Dhe në fund, e pres interpelancën, është koha", ka shkruar Taravari në profilin e tij të Facebook-ut. Ndryshe, VMRO përveç Taravarit, ka ngritur interpelancë edhe për ministrin e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovskën, ministrin e Bujqësisë, Lupço Nikollovskën, për ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, për ministrin e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Sadullah Duraki si dhe për ministrin e Financave, Dragan Tevdovski.

## ALIMI: VMRO E KEQPËRDORË FOLTOREN

Në Parlament të hënën është zhvilluar vazhdimi i shtatë të seancës së gjashtë, ku në rend dite është shkarkimi i prokurorit publik Marko Zverlevski. Debat i ashpër është zhvilluar mes deputetëve të pushtetit dhe opozitës, kjo pasi deputetë nga VMRO vazhduan me skenarin e njëjtë të bllokimit, atë të replikave dhe kundër replikave. Kundër agjendës së deputetëve të VMRO-së ishte kritik koordinatori i grupit parlamentar të BDI-së Ejup Halimi, të cilëve u bëri thirrje që të mos flasin për tema që nuk janë në rend të ditës. "Më shumë se dy javë grupi i deputetëve të VMRO-DPMNE-së e keqpërdorin foltoren e Kuvendit. Qytetarët janë të vetëdijshëm se kush bën bllokimin e Kuvendit dhe vetë do ta vlerësojnë kush është në të drejtë", tha Alimi, duke theksuar edhe faktin se interpelancat për ministrat sillen ende pa u bërë 100 ditë qeverisje. Ndaj deputetit Halim, reagoi Ilija Dimovski, deputet i VMRO-DPMNE-së, duke i'u drejtuar Xhaferit se e mbron Alimin si ta kishte familjar të vetin. "E mbron Alimin sikurse të ishte djali juaj. Në vend që të diskutohet për Zverlevskin, me mirë të flitet për çështje shumë më të rëndësishme siç janë zjarret, deponitë në Strugë dhe në Tetovë", theksoi Ilija Dimovski nga VMRO. Ndërkaq, Koordinator i grupit parlamentar të LSDM-së, Tomislav Tuntev, për shkarkimin e prokurorit publik Marko Zverlevski, tha se atë që e bën VMRO-DPMNE-ja opozitare "ngjan me prillin", duke aluduar në ndodhitë e dhunshme të 27 prillit, kur u zgjodhë kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi. Tuntev theksoi se shumica parlamentare nuk do të marrë pjesë në "debatin e pakuptimtë". Të gjithë kemi hequr dorë nga diskutimet tona që sa më shpejtë të mbarojë kjo parodi rreth shkarkimit ligjor të prokurorit shtetëror. Kjo çfarë ndodhë tani, kjo gjuhë e urretjes, më shumë ngjan në prillin. Shpresoj që kolegët e opozitës do të ndalojnë dhe sa më shpejtë të fillojnë me procedurën për emërimin e prokurorit të ri", tha Tomislav Tuntev nga LSDM.







Shtetet Perëndimore e kanë cilësuar këtë problem si të pakuptimtë, ndërsa kompanitë multinationale janë arsyetuar se ndjekin "shijet specifike" të blerësve në Lindjen e Evropës

## Ministri Nikollovski jep një lajm të mirë Deri në fund të muajit pagesa të plota të subvencioneve

Shkup, 14 gusht - Rreth 50 milionë euro subvencione janë paguar gjatë dy muajve të fundit në bujqësi. Për realizim mbeten 15 milionë jo të plota, për të cilat vendimet tanimë janë përgatitur. Deri në fund të muajit pritet që mbështetja të bartet në tërësi, informon ministri resor Lupço Nikollovski. Ai vlerësoi se edhe tani, si edhe viteve para-prake, më shumë paguhen detyrime të mbetura, në vend të mbështetjes për vitin rrjedhës. Lidhur me 15 milionë euro të mbetura, ministri tha se bëhet fjalë për subvencione për bujqit tek të cilët kontrollet kanë treguar mospërputhje të asaj që e kanë paraqitur me gjendjen në terren. "Këta prodhues të cilët për shkak të ndonjë arsye nuk do të marrin subvencione, të drejton deri te Agjencia pagesore që të detektohet problemi dhe të tejkalohet", apeloj Nikollovski dhe paralajmëroi se Ministria do të vendosë sistemin të pagesës në kohë. Informoi se deri në fund të vitit, deri më 31 dhjetor, di të paguhen edhe gjashtë milionë euro plotësuese mbështetje, për bujqit e rinj dhe për mbjellje të reja disavjeçare. Ai informoi gjithashtu se sot (e martë) do të dihet saktë se sa sipërfaqe me pyje janë përfshirë nga zjarret që e përfshinë Maqedoninë, pasi në seancën qeveritare, NP "Pyjet e Maqedonisë" do të kumtojë numrin e saktë. Nga kjo do të varet, theksoi, nëse ndalesa për lëvizje në pyje ende do të jetë në fuqi. Nikollovski në konferencën për shtyp potencoi se masa e djegur e pemëve nuk do të vendoset në qarkullim dhe do të jetë nën kontroll të ashpër nga ana e Inspektoratit. Njëherësh paralajmëroi se nga viti i ardhshëm mjetet buxhetore për mbrojtje të pyjeve do të rriten dhe në vend të shtatë milionë denarëve të tanishme do të arrijnë 35 milionë denarë. "Në dhjetë vitet para-prake dhjetëfish është zvogëluar vlera e buxhetit për mbrojtje të pyjeve, prej 70 milionë denarë në vitin 2006, në shtatë milionë në vitin 2017", përmendi ministri.

Duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve në lidhje me zjarret, informon se në kërkesë të tij janë forcuar të gjitha kontrollet edhe ato inspektuese edhe ato të policisë pyjore. Sipas tij, befasues janë të dhënat në lidhje me revizionin e efikasitetit të ndërmarrjes dhe institucioneve kompetente për pyjet.

Kualiteti i prodhimeve që shitet në vendet e Evropës Perëndimore nuk është i njëjtë me atë të shteteve tjera të kontinentit. Shqetësimi fillimisht u ngrit nga vendet e reja anëtare, por tani kryesisht së BE-së i kërkohet jo trajtim si "qytetarë të dorës së dytë". Nëse nuk ka zgjidhje, shtete e Lindjes kërcënojnë me bllokadë

Koha **Fisnik PASHOLLI**

Shkup, 14 gusht - Cilësia e një pjese të prodhimeve ushqimore dhe mjeteve për higjienë nuk është e njëjtë në anëtarët e vjetra dhe të reja të Bashkimit Evropian. Situata është e ngjashme edhe te shtetet nga Ballkani Perëndimor që pretendojnë të anëtarësohen në BE, mes të cilave është edhe Maqedonia. Madje edhe shija e artikujve ushqimor që ju rastis t'i bli ni në shtetet Perëndimore nuk janë me të njëjtën shije me ato te ne, edhe pse janë nga i njëjti prodhues. Shpesh edhe detergjenti i firmës së njëjtë lanë më mirë teshat në shtetet Perëndimore në raport me Evropën Lindore. Për shembull, në tregun Lindor shitet kafë Instant me më pak kofeinë, apo Nutella me më pak lajthia, e kështu me radhë. Këto janë vetëm një pjesë e artikujve ushqimorë që nuk shiten me të njëjtën cilësi në shtetet e Evropës Lindore dhe Perëndimore dhe plasohen jo vetëm në shtetet e rajonit, por edhe në Hungari, Sllovaki, Poloni dhe të gjitha shtetet e tjera që i janë bashkangjitur BE-së në vitin 2004 dhe më vonë. Hulumentet në Çeki kanë konstatuar se në 24 prodhime të testuara, bile 14 kanë qenë më pak cilësore dhe më të shtrenjta se në Gjermani. Përveç hulumentit çek, një nga hulumentet më të njohura për cilësinë e prodhimeve është realizuar në Sllovaki në vitin 2011, që ka treguar të njëjtat rezultate.

### Eurodeputetët kërkojnë masa

Për të mbrojtur konsumatorët në të gjitha shtetet e BE-së, por edhe të Evropës Juglindore, një pjesë e euro-deputetëve nga shtetet e reja anëtare të BE-së, kanë ngritur iniciativë para Parlamentit Evropian që në fund duhet të obligojë prodhuesit nga Bashkimi Evropian që çdo gjë që prodhojnë të kenë cilësi të njëjtë, pavarësisht tregut ku shiten. Por si duket, angazhimet e tyre nuk kanë dhënë rezultate të shpejta, andaj kanë reaguar në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe shefat e qeverive të këtyre shteteve. Kryeministri sllovak, Robert Fico, paralajmëroi kufizimin e importit të më shumë prodhimeve gjoja me cilësi më të dobët nga shtetet e tjera të BE-së, në rast se Brukseli nuk ndërmerr hapa për të përmirësuar këtë situatë. Fico para disa javësh ka ripërsëritur pohimet se prodhuesit e huaj në tregun e Sllovakisë dërgojnë prodhime më pak cilësore se në shtetet e tyre amë. Ai i ka dhënë afat Komisionit Evropian deri në vjeshtë që të fillojë të zgjidhë problemin e përbërjes së ndryshme të artikujve ushqimorë dhe prodhimeve, duke kërcënuar njëherazi se Sllovakia do të mund të vendosë

# Kërkohet cilësi e njëjtë në të gjithë Evropën Lindja kërcënon Perëndimin me bllokadë



embargo të njëanshme dhe të tërheqë artikujt e Evropës Perëndimore nga restorantet sllovaqe. Krahas Sllovakisë, edhe shtetet tjera Lindore i kanë bërë thirrje Komisionit Evropian që të ndërpresë praktikën e kompanive multinationale ushqimore që në shtetet të ndryshme të shesin prodhime me cilësi jo të njëjtë të të njëjtit brend.

Shtetet Perëndimore e kanë cilësuar këtë problem si të pakuptimtë, ndërsa kompanitë multinationale janë arsyetuar se ndjekin "shijet specifike" të blerësve në Lindjen e Evropës. "Kryetarit i Komisionit Evropian, Zhan Klod Juncker, më thotë se disa shtete këtë çështje e trajtojnë si qesharake, ndërsa unë do t'ju pyes: Zotërinj të nderuar, si do të reagonit ju nëse shikon se në detegjentin e juaj ka 20 përqind më pak substancë aktive për larje. Nëse nuk merremi me këtë çështje, atëherë atë dikush do ta keqpërdorë për qëllime politike, andaj këtë më nuk mund ta tolerojmë. Nuk do të tolerojmë që çokollata e të njëjtit paketim dhe çmim të njëjtë të jetë me cilësi më të mirë në Austri se tek ne. Gjëra të tilla e kërcënojnë Unionin, andaj kjo është një çështje e rëndësishme për ne. Nëse vazhdon një praktikë e tillë, unë jam i gatshëm që Sllovakia të ndërmerr masa pozitive diskriminuuese", ka deklaruar kryeministri sllovak Robert Fico.

### BE të dëshmojë se nuk ekzistojnë qytetarë të rendit të dytë

Sipas kryetarit të Komisionit Evropian, Zhan Klod Juncker, kjo është një çështje ku ne si Komision Evropian duhet të tregojmë se në BE nuk ekzistojnë

qytetarë të rendit të dytë. Të gjithë qytetarët kanë të njëjtat të drejta, për shkak se të gjithë kanë të njëjtin dinjitet, ka shtuar Juncker. Për momentin nuk ekziston mundësia që BE të rregullojë shpejt dhe në mënyrë të thjeshtë këtë çështje, për shkak se cilësia e prodhimeve është në dorën e agjencive përkatëse nacionale. Megjithatë, është paralajmëruar se Komisioni Evropian në vjeshtë do të dalë me udhëzimet për agjencitë kombëtare që do të duhet të ndihmojnë në gjetjen e rasteve të diskriminimit të konsumatorëve. Nëse kjo nuk do të zgjidhë problemin, është premtuar se çështja do të zgjidhet me ligj. Nga ana tjetër, edhe Rumania u bashkua me disa vende të Evropës Lindore, duke i bërë thirrje Bashkimit Evropian që të trajtojë me prioritet përdorimin e "standardeve të dyfishta" nga zinxhirët ushqimorë globalë, të cilat shesin prodhime me cilësi të ulët në Evropën Lindore. "Ne duhet të dimë se cilat kompani na trajtojnë si shtetas të dorës së dytë", tha kryeministri rumun, Mihai Tudose. Asnjë nga kompanitë në fjalë nuk janë ligjërish të përgjegjëse për këtë praktikë, duke qenë se standardet e dyfishta janë të ligjshme në BE, përderisa përbërësit janë të sigurt dhe janë të listuara në etiketat përkatëse të produkteve. Përveç Rumanisë, Bullgaria dhe Kroacia, kanë njoftuar se do të përdorin teste të ndryshme për të përcaktuar nëse produktet e shitura në tregjet e tyre ndryshojnë nga ato të shitura në vendet e Evropës Perëndimore. Bullgaria, e cila ishte ndër vendet e para Lindore që nisi vënien në praktikë të testeve të tilla, deklaroi në fund të qershorit se ekspertët gjetën përbërës të

ndryshëm ushqimorë për produkte të së njëjtës markë të shitura në vendet Lindore në krahasim me ato Perëndimore, si në Gjermani apo në Austri. Qeveria bullgare tha se do të nxisë Bashkimin Evropian që t'i japë rëndësinë që i takon kësaj çështjeje. Ministri bullgar i Bujqësisë, Rumen Porozhanov, tha se analizat laboratorike kishin gjetur përbërës të ndryshëm në shtatë nga 31 artikuj identikë të shitur në Bullgari. Gjithashtu, disa shtete të Evropës Lindore, duke përfshirë Poloninë, Hungarinë, Sllovakinë, Bullgarinë, Kroacinë dhe Rumaninë, akuzojnë zinxhirët globalë të ushqimit për përdorimin e kësaj metode për të shitur prodhime të një cilësie të ulët. Ata duan që Komisioni Evropian të japë zgjidhje të cilat të ndryshojnë mbrojtjen e konsumatorëve të bllokut dhe ligjet e sigurisë ushqimore. Kompanitë e mëdha të ushqimit kanë pranuar se është e zakonshme që të përdoren përbërës të ndryshëm për produkte me të njëjtin emër në vende të ndryshme, por këmbëngulin që produktet e tyre të ndryshojnë për t'iu përshtatur shijeve lokale, sesa për të ulur kostot. Ekonomistët thonë se shitja e prodhime me cilësi të ndryshme është praktikë e kompanive të mëdha, që edhe prodhimin e dedikojnë enkas për këtë treg, me shtrirjen e prodhimtarisë në Evropën Lindore. Sipas njohësve të kësaj problematike, prodhuesit nuk kanë obligim që të shesin mall me të njëjtin kualitet në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, por kryesorja është që të respektohen principet themelore që garantojnë sigurinë e prodhimeve ushqimore si dhe tregojnë përmbajtjen e saktë të mallit.

### NË MAQEDONI KA KRITERE, POR Ç'FARË JANË?

Për shembull, në Maqedoni çdo prodhim që hyn duhet të respektojë standardet që kërkohen sipas Ligjeve të Maqedonisë, duke filluar nga Ligji për ushqim dhe veterinarinë dhe standarde të tjera. Por pyetja që shtrihet ka të bëjë me kriteret. Ndryshe, dallimin në cilësi të prodhimeve mund ta vërejnë edhe mërgimtarët si dhe qytetarët e tjerë që udhëtojnë te të afërmit e tyre në Evropën Perëndimore, të cilët kanë konstatuar se, për shembull, markat e njohura të çokollatës në tregun e rajonit shpesh kanë më pak kakao se në vendet e Evropës Perëndimore, apo edhe se detergjentët lajnë më dobët se atje, si dhe një sërë anomalish të tjera. Prodhuesit, dallimin e cilësisë së prodhimit të të njëjtit brend e arsyetojnë me nevojat e ndryshme të konsumatorëve dhe shijet e popullatës lokale. Dallimet në kualitet të prodhimeve që shiten në rajon dhe BE vërtetohen edhe me hulumentet e tregut, që nënkupton se prodhimet janë të përshtatura sipas nevojave dhe kërkesave të ndonjë hapësire gjeografike.





Ndryshime në dy festivalet e Strugës dhe Ohrit

# MPS me Këshill të ri, komuna pa përfaqësues

Në përbërjen e këshillit të ri vazhdon të figurojë si i pandryshuar emri i anëtarit Xheladin Poshka, si përfaqësues i punonjësve të festivalit, ndërkohë që bosh ka mbetur vendi i anëtarit të pestë të bordit, përfaqësuesit të komunës, pozicioni ky që është bojkotuar prej disa vitesh nga komuna. Ndryshimet në Këshillin Drejtues nuk priten të sjellin kthesa në përmbajtjen e manifestimit, që prej vitesh kritikohet jo vetëm për mënyrën e izoluar sesi zhvillohet, por edhe për frymën monoetnike që mbizotëron në të gjitha aspektet e organizimit

Koha Evis HALILI

Shkup, 14 gusht - Pak ditë përpara fillimit të manifestimit "Mbrëmjet Poetike të Strugës", janë ndërruar të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të Festivalit. Poeti Darko Leshkovski është emëruar si kryetar i Këshillit Drejtues, në vend të Sllave Gjorgjo Dimovski, ndërsa janë ndryshuar edhe dy anëtarë të tjerë. Në përbërjen e Këshillit të ri vazhdon të figurojë si i pandryshuar emri i anëtarit Xheladin Poshka, si përfaqësues i punonjësve të Festivalit, ndërkohë që bosh ka mbetur vendi i anëtarit të pestë të bordit, përfaqësuesit të komunës, pozicioni ky që është bojkotuar prej disa vitesh nga komuna. Drejtori i Festivalit, Mite Stefovski,



mandati i të cilit ka skaduar, thotë se Këshilli drejtues do të funksionojë me një anëtar më pak, për shkak se komuna nuk ka dërguar asnjë përfaqësues. "Mandati i kryetarit të KD kishte skaduar, i dy anëtarëve të tjera jo, por që gjithsesi nuk kishim nevojë për këto turbulenca tani në prag të fillimit të festivalit. Presim emra të rëndësishëm që të mblidhen këtu", thotë Mitevski. Ndryshimet në Këshillin Drejtues nuk priten të sjellin kthesa në përmbajtjen e manifestimit, që prej vitesh kritikohet jo vetëm për mënyrën e izoluar sesi zhvillohet, por edhe për frymën monoetnike që mbizotëron në të gjitha aspektet e organizimit. Në një prononcim për "KOHA" kryetari i komunës së Strugës u shpreh se në rast se me drejtuesit e këtij festivali do të vazhdojnë të kenë të njëjtat probleme si edhe vitet e tjera që lidhen me përdorimin e gjuhës shqipe, elementet e munguara shqiptare në këtë manifestim

do të jenë të detyruar të vazhdojnë të bojkotojnë. Numri i poetëve nga vendi nuk është më i madh se një ose dy persona, ndërsa këtë vit si krijues shqiptar nga jashtë Maqedonisë është poetja Luljeta Leshanaku. Emërimi i poetit Darko Leshovski, i njohur me përmbledhjet poetike si "Fëmijë nga një familje e keqe"..., ka krijuar përshtjellim në mesin e krijuesve maqedonas, një pjesë prej të cilëve e cilësojnë si të padenjë për këtë mbajtje të post, ndërsa të tjera shprehen me superlativa dhe japin vlerësimet pozitive për ndikimin që shprehin në këtë festival. Të hënë kanë reaguar edhe nga VMRO-DPMNE, të cilët e kanë cilësuar si ofendim për poetët dhe krijuesit e vërtetë në Maqedoni. Vetë Leshovski përmes ka reaguar në rrjetet sociale ndaj kritikave dhe atyre që e quajnë poet interneti, që s'ka qenë pjesë e manifestimeve dhe ngjarjeve të kulturës.

"Unë jam ai Darko dhe

nuk kërkoj nga ju t'më respektoni dhe as t'ju rendis listën me vlerat dhe lëndat për mua. Respektin ruajeni për më të moshuarit. Mua më mjaftojnë rrugët, pazaret, kafenetë, shokët...", shkruan ndër të tjera Leshovski.

Sa i takon ndryshimeve të përgjithshme, ato priten të ndodhin pas ndryshimit edhe të pjesës tjetër të këtij institucioni, drejtorit, mandati i të cilit ka skaduar prej kohësh. Ndryshimet në këshillin drejtues kanë prekur edhe festivalin tjetër ndërkombehtar - "Vera e Ohrit". Shkarkimet që kanë nisur me Këshillat drejtues, pas përfundimit të zgjedhjeve lokale në muajin tetor, priten të vijojnë edhe me ndryshime në drejtuesit e këtyre drejtorive. Shkarkimet dhe emërimet e reja lidhen me parregullsitë dhe anomalitë që janë evidentuar nga raportet e punës që drejtorët e drejtorive që janë në varësi të Ministrisë së Kulturës i kanë dorëzuar në këtë institucion.

## Kronikë

## Vidhet "Sport lajv" në Shkup

Një i panjohur nën kërcënimin me pistoletë ka kryer grabitje të bastores "Sport-lajv" në rrugën "Gjorçe Petrov" në Shkup dhe ka marrë rreth 40.000 denarë nga qarkullimi ditor. Siç citohet në Buletinin policor, grabitja është kryer të dielën mbrëma rreth orës 22:50 minuta, ndërsa e ka denoncuar i punësuar në këtë bastore. Policia merr masa për gjetjen e autorit.

## Shkup, 30 aksidente për dy ditë

Një këmbësor është lënduar, ndërsa dhjetë persona kanë marrë lëndime më të lehta trupore në dhjetë nga gjithsej 30 aksidentet e regjistruara gjatë fundjavës së kaluar në rajonin e SPB Shkup. Policia e trafikut të premtën ka kryer ekspertizë në 15 aksidente rrugore, nga të cilat në një është lënduar rëndë një këmbësor, në gjashtë aksidente gjashtë persona janë lënduar më lehtë, ndërsa të tjerat janë me pasojë të dëmit material. Nga tetë aksidentet rrugore të regjistruara të shtunën, në dy lëndime të lehta trupore kanë marrë dy persona, ndërsa gjashtë janë me pasojë të dëmit material. Të dielën, ndërsa, kanë ndodhur shtatë aksidente rrugore, ku në një prej tyre më lehtë janë lënduar dy persona. Në të tjerat, është shkaktuar dëm material. Policia e trafikut gjatë tre ditëve të fundit ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të kundërvajtjeve. Janë ndërmarrë masa për 69 shoferë, të cilët nuk i kanë respektuar kufizimet e lëvizjes, shtatë janë përjashtuar nga komunikacioni sepse kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, pesë kanë kaluar në të kuqe, ndërsa tre nuk i kanë respektuar rregullat për parakalim. Janë sanksionuar edhe 12 shoferë të cilët gjatë ecjes nuk e kanë shfrytëzuar rripin e sigurimit ose kanë folur në telefon, 37 shoferë pa leje të qarkullimit gjegjësisht pa regjistrim, 104 për parkim të papërshtatshëm, si dhe 16 shoferë të biçikletave me motor, mopedë dhe motoçikleta të cilët gjatë lëvizjes në rrugë nuk e kanë mbajtur helmët mbrojtëse në kokë. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec" janë larguar 105 automjete.

## Bullgari kapet me 23 kilogram marihuanë

Të dielën rreth orës 18:30 minuta në vendkalimin kufitar në Bllacë, që lidhë Maqedoninë me Kosovën, është konfiskuar një makinë e tipit BMW X5, pronë e një shtetasi bullgar i cili paraprakisht kishte rezultuar se me vete posedonte 23 kilogram substancë narkotike. Sipas informacioneve paraprake që arritëm t'i sigurojmë, doganierët e Maqedonisë, kishin pas dyshimit tek vetura e cila po tentonte të kalonte pikën kufitare në Bllacë gjatë ditës së diel, rreth orës 18:30.

Por doganierët, më pas kishin kërkuar nga shtetasi bullgar që të parkon veturën në vendin e caktuar për kontroll të detajuar dhe ti nënshtrohet një kontrolli të përgjithshëm. Vetëm pas disa momenteve nga kontrolli, në veturë janë gjetur të fshehura plotë 23 kilogram substancë narkotike e tipit marihuanë e cila ishte paraparë të përfundonte në tregun kosovarë.

Më pas policia ka arrestuar personin në fjalë, ndërsa vetura është konfiskuar. Dje i njëjti është nxjerrë para trupit gjykues me urdhër të Prokurorisë ku të njëjtit i është caktuar masë e paraburgimit prej 30 ditëve. (O.XH)

## Vijon konkursi për 500 policë

Sipas zëvendësministrit Nuhui, dy janë kushtet që do ta bëjnë këtë konkurs të jetë në vijë me përcaktimet ligjore dhe konstitucionale - kriteret profesionale dhe përfaqësimi i drejtë

Shkup, 14 gusht - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka shpallur konkurs për 500 vende të reja pune policë. Nga ky dikaster kanë bërë të ditur se edhe në këtë konkurs do të respektohen si kriteret ligjore për seleksionim, ashtu edhe detyrimi konstitucional dhe ligjor për përfaqësim të drejtë. Sipas numrit dy të policisë, Agim Nuhui dy janë kushtet që do ta bëjnë këtë konkurs të jetë në vijë me përcaktimet ligjore dhe konstitucionale. "Qasja e udhëheqësisë së re

në Ministrinë e Brendshme është korrekte, institucionale dhe afirmative në raport me përfaqësimin e drejtë dhe adekuat në fushën e punës dhe marrëdhënien e punës. Kriteret profesionale dhe përfaqësimi i drejtë janë dy kushte kumulative që do ta bëjnë që ky konkurs të jetë në vijë simetrike me përcaktimet ligjore dhe konstitucionale", tha Nuhui. Ai theksoi se gjithë të rinjtë shqiptarë që i plotësojnë kushtet duhet të aplikojnë në këtë konkurs, sepse detyrim ligjor është që të ketë përfaqësim adekuat të pakicave në shtet", thekson më tej Nuhui. Në konkursin është paraparë pranimi i 500 realizuesve në vendin e punës "polic" për punë në MPB edhe atë: Në Sektorin e punëve të brend-



shme Shkup gjithsej 360 realizues, në SPB Manastir 20 realizues, në SPB Ohër 30 realizues, në SPB Strumicë 20 realizues, Shtip 20 realizues, Kumanovë 20 realizues, Tetovës 10 realizues dhe Veles 20 realizues. Ditë më parë rreth 30 kandidatët protestuan para MPB-së, e

të cilat kanë qenë pjesë e grupit ku në konkursin e kaluar nuk arritën të punësohen në polici për shkak të numrit të kufizuar të punësimeve, ndërkohë konkursi shpallet në kohën kur po këto kandidatë që e kanë kaluar trajnimin, vazhdojnë të qëndrojnë në shtëpi.





**THIRRJE PUBLIKE**  
**PËR NDARJE TË KONCESIONEVE PËR HULUMTIME TË DETAJUARA GJEOLGJIKE TË LËNDËVE TË PARA MINERALE**  
**1/2017**

**Shkup, gusht 2017**

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1 e Ligjit për koncesione dhe të partneritetit publik dhe privat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/12, 144/14, 33/15, 104/15 dhe 215/15), nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit për Lëndët e para të mineraleve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16, 120/16 dhe 189/16), Vendimit për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale nr. 42-5909/1 të datës 28.09.2016 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/2016), Komisioni për zbatim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale publikon

**THIRRJE PUBLIKE**  
**PËR NDARJE TË KONCESIONEVE PËR HULUMTIME TË DETAJUARA GJEOLGJIKE TË LËNDËVE TË PARA MINERALE**  
**1/2017**

1. Koncedent është Republika e Maqedonisë - Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
  2. Lëndë e kësaj thirrje publike është ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale të lokaliteteve nga Vendimi për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale nr. 42-5909/1 të datës 28.09.2016 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/2016), edhe atë:
    - Lokaliteti "Paraniva" komuna e Velesit për lëndën e parë minerale – glinë;
    - Lokaliteti "Orlovac" f. Kleçovcë dhe f. Zubovcë komuna e Kumanovës për lëndën e parë minerale – kuarç;
    - Lokaliteti "Tursko Rudare" komuna Çeshinovë – Obleshevë, komuna e Koçanit dhe komuna Probishtip për lëndët e para minerale metalike;
    - Lokaliteti "Drvosht" komuna Bosilovë për lëndën e parë minerale – felsepad
  3. Koncesioni për hulumtime të detajuara gjeologjike ndahen për periudhë prej:
    - Dy vjet për lëndë të para minerale jometalike
    - Gjashtë vjet për lëndë të para minerale metalike
  4. Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë të gjitha subjektet e vendit dhe të huaj juridike dhe konkorsiume të cilët do të marrin dokumentacionin tenderues përmes sistemit elektronik [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk) dhe do të plotësojnë kushtet në pajtim me përcaktimet në dokumentacionin tenderues.
  5. Në dokumentacionin tenderues janë të përbajtura të dhëna në lidhje me lokalitetet për të cilat jepen koncesionet për hulumtime të detajuara gjeologjike, si dhe vlera e ofertës së projektit koncesionues i shprehur si shumë e vlerësuar fillestare e koncesionit dhe kushte që duhet të plotësohen nga ana e koncesionerit.
  6. Ofertuesit duhet domosdo përmes sistemit [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk) të dorëzojnë dokumentacionin e skenuar në vijim për të dëshmuar kushtet personale, profesionale dhe financiare që duhet të plotësojnë për pjesëmarrje në Thirrjen publike:
    - 1) Dokument për veprimtari të regjistruar dhe gjendja aktuale
      - Për subjektet e vendit juridike: dokument për veprimtari të regjistruar dhe gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike: dokument nga organi kompetent – vërtetim se gjendet në regjistrin zyrtar tregtar që udhëhiqet nga ana e organit kompetent të shtetit ose vërtetim nga organi kompetent për certifikim që i plotëson kushtet të përcaktuara me ligj;
    - 2) Informata për gjendje ekonomiko-financiare të subjektit
      - Për subjektet e vendit juridike: Informata për gjendje ekonomiko-financiare të subjektit të cilin e jep Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, raportet pozitive financiare, së paku për vitin e fundit. Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhë më pak ky, raportet financiare dorëzohen për periudhën prej regjistrimit;
      - Për subjektet e huaj juridike: raporti pozitiv revizor nga institucioni revizor me renome të regjistruar për kryerje të revizionit. Raporti revizor të përbajë të dhëna për punën e përgjithshme ekonomike të ofertuesit të huaj për vitin e fundit Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhë më pak se kjo, raportet financiare të dorëzohen për periudhën prej kohës së regjistrimit;
    - 3) Certifikatë për tatimet dhe kontributet e paguara
      - Për subjektet e vendit juridike: të dhënë nga Drejtoria për të hyra publike e Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike dokument të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
    - 4) Dokument se ndaj personit nuk ka procedurë se është në falimentim
      - Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
    - 5) Dokument se ndaj personit nuk ka procedurë se është në likuidim
      - Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
    - 6) Dokument se nuk i është shqiptuar dënimi për vepër penale:
      - Për subjektet e vendit juridike të dhënë për vendim penal gjyqësor të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
    - 7) Dokument se nuk i është shqiptuar dënimi në procedurë kundërvajtje ndalesë për kryerje të detyrës profesionale:
      - Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
    - 8) Deklaratë të vërtetuar në noter nga personi përgjegjës se personi juridik ose anëtar i organit të tij për menaxhim ose organi mbikëqyrës nuk janë të dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për veprat penale në vijim: korrupsion, mashtrim dhe larje parash; (ANEKS Z)
      - Për ofertuesit e huaj është e nevojshme që deklarata e tillë të jetë e vërtetuar në noter, ose nga ndonjë organ tjetër derisa në shtetit prej nga vjen ekziston institucioni i tillë që kryen vlerësimin e llojeve të tilla të deklaratave.
    - 9) Deklaratë, të vërtetuar në noter, se subjektit juridik duke përfshirë edhe subjektet e huaja juridike me filial të shënuar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë m[ë] herët nuk i është marrë koncesion për hulumtime të detajuara gjeologjike ose eksploatim të lëndëve të para minerale, si subjekt juridik që është i lidhur me atë subjekt juridik; (ANEKS Z)
    - 10) Për konzorcium është e nevojshme çdo anëtar i grupit të plotësojë të gjitha kushtet personale, profesionale dhe financiare të kësaj pike.
- Vetëm ofertat e ofertuesve të cilët janë të vlerësuar si të afër do të jenë lëndë e evaluimit.
7. Ofertuesit domosdo përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë duhet të dorëzojnë Garancinë tenderuese në origjinal.
  8. Oferta e tërësishme duhet të jetë në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni shoqëruar i ofertës, e cila kërkohet në pajtim me dokumentacionin tenderues, duhet të jetë e skenuar nga origjinali. Ofertuesit të cilët do të zgjidhen si më të volitshëm duhet të dorëzojnë në origjinal dokumentacionin të cilin më herët e kanë të skenuar dhe të vendosur në ueb portalin [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të kumtesës dhe Vendimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm. Nëse bëhet fjalë për ofertues të huaj, ky dokumentacion duhet të përkthet nga ana e përkthyesit të autorizuar gjyqësor në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga dita e hapjes së Thirrjes Publike, përveç se Raportit revizor.
  9. Ofertuesit mund të dorëzojnë vetëm një ofertë për lokalitetin për ndarje të koncesionit për hulumtime të detajuara gjeologjike.
  10. Dokumentacioni tenderues merret në mënyrë elektronike nga ueb portali: [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk). Të drejtë për marrje të dokumentacionit tenderues ka çdo subjekt i cili do të regjistrohet në ueb portalin: [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk). Të drejtë për pjesëmarrje në procedurën e mëtejshme të Thirrjes publike ka çdo subjekt i regjistruar në ueb portalin: [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), i cili ka marrë dokumentacion tenderues, ka aplikuar me ofertë të vet dhe ka dorëzuar dëshmi për pagesë të realizuar për dokumentacionin e marrë tenderues. Dokumentacioni tenderues mund të merret në ueb portalin: [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk)
  11. Ofertat duhen të jenë me afat të vlefshëm për një vit duke filluar nga data e hapjes publike. Për të aplikuar në thirrjen publike, ofertuesi i interesuar është i obliguar që të paguajë mjete të pakthyeshme në shumë prej 6.000,00 (gjashtë mijë) denarë, të skenojë fletëpagesën dhe ta postojë përmes sistemit në [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk). Paga duhet të bëhet në interes të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, me shenjë: për dokumentacion tenderues për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale sipas Vendimit për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale nr. 42-5909/1 të datës 28.11.2016 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/2016):
 

Llogaria trezore: 10000000063095  
Llogaria e pagesës: 840 06163  
Shifra e të hyrave dhe programi: 724125-00  
Deponent: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë  
Numri tatimor: 403000392597

Për ofertuesit e huaj:  
Ministria e ekonomisë  
Banka popullore e Republikës së Maqedonisë  
Bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 1  
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë  
SWIFT BIC: NBRM MK 2X  
IBAN: MK07 1007 0100 0028 009
  12. Ofertat dorëzohen përmes portalit [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), gjegjësisht vetëm Dokumentacioni tenderues dorëzohet përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.
  13. Afati për dorëzimin e ofertave është më së voni deri më 19.09.2017 deri në ora 10.00. Do të shqyrtohen vetëm ofertat të dorëzuara përmes sistemit [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk) dhe dokumentacioni tenderues i dorëzuar përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.
  14. Oferta duhet të përbajë gjërat në vijim:
    - Ofertë,
    - Garanci tenderuese dhe
    - Dokumente me të cilat dëshmohet plotësimi i kushteve personale, profesionale dhe financiare të ofertuesit, të theksuara në pikën 6 të kësaj thirrje publike.
  15. Gjatë zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm do të shqyrtohen vetëm ofertat që e përbajnë dokumentacionin e plotë në pajtim me Dokumentacionin tenderues.
  16. Kriteri sipas të cilit do të bëhet zgjedhja e ofertës më të volitshme është kompensimi më lartë i ofruar i koncesionit, por jo më i ulët se çmimi fillestar për lokalitetin dhe lëndën e parë minerale teknogjene të kësaj Thirrje publike. Kushti për vlerësimin e ofertave është Garancia e rregulluar tenderuese.
  17. Ankandi publik përmes sistemit për ankand elektronik [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), do të mbahet më 21.09.2017 prej ora 12:00.
  18. Obligimet e koncesionerit do të përcaktohen në Marrëveshjen për koncesion për hulumtime të detajuara gjeologjike. Koncesioneri është i obliguar që hulumtimet e detajuara gjeologjike të kryejë në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi të Republikës së Maqedonisë.
  19. Qeveria e Republikës së Maqedonisë: mund të kryejë ndryshim ose plotësim të dokumentacionit tenderues, më së voni 15 ditë para kalimit të afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave, të mos ndajë koncesionet ose plotësisht të ndërprejë procedurën.
  20. Mënyra e evaluimit të ofertave:
 

Dorëzimi i ofertave bëhet përmes portalit [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), gjegjësisht vetëm Garancia tenderuese dorëzohet përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.

Evaluimi bëhet për të gjitha ofertat të dorëzuara deri më 19.09.2017 deri në ora 10:00.

Evaluimi i ofertave do të realizohet në dy mënyra, edhe atë:

Në hapin e parë kontrollonhet kompletimi dhe validiteti i Dokumentacionit të domosdoshëm.

Nëse vërtetohet se dokumentacioni nuk është i kompletuar, oferta financiare nuk shqyrtohet dhe ofertuesit nuk do të lejohet pjesëmarrje në ankandin elektronik.

Në hapin e dytë, pas vërtetimit të kompletimit dhe validitetit të dokumentacionit nga ana e Komisionit, shqyrtohet oferta financiare dhe lejohet qasje në sistemin për pjesëmarrje në ankandin elektronik. Secili ofertues në sistem mund të shohë rangimin e tij aktual në relacion me ofertat financiare dhe mund të ofrojë në pajtim me rregullat e definuara të publikuara në sistemin [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk).

Komisioni do të përpilojë Raport të evaluimit të ofertave, në të cilin do të përkthet procedura gjatë evaluimit, ankandi elektronik (ankandi), vërejtjet eventuale dhe arsyetimet e Komisionit.
  21. Organi kompetent për shqyrtimin e ankesave në procedurën për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale është Komisioni shtetëror i ankesave për furnizime publike (bul. "Ilinden" nr. 63 A, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë) Ankesa mund të shrohet në afat prej tetë ditëve nga dita e:
    - publikimit të Thirrjes publike për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale në lidhje me të dhënat, veprimet ose lëshimet për ndërmarrjen e veprimeve nga Thirrja publike;
    - evaluimi i ofertave, në lidhje me veprimet ose lëshimet e ndërmarrjes së veprimeve në lidhje me dokumentacionin tenderues, gjegjësisht procedurën për evoluimin e ofertave dhe ankandin;
    - pranimit të vendimit me të cilin vendoset për të drejtë individuale nga procedura për ndarje të koncesionit për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale në lidhje me vërtetimin e aftësisë së paraqitjeve për pjesëmarrje ose evaluim të ofertave dhe vendimit dhe
    - informatë për parregullsi gjatë procedurës së ndarjes së koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale, më së voni në afat prej një viti nga dita e mbarimit të procedurës së realizuar.
  22. Për të gjitha çështjet në lidhje me këtë thirrje publike kandidatët e interesuar mund të drejtohen tek personat e autorizuar për kontakt:
 

**Lupço Efnusev tel: +389 2 3093 520**  
**e-mail: [lupce.efnusev@economy.gov.mk](mailto:lupce.efnusev@economy.gov.mk)**

**Kika Shpritova tel: +389 2 3093 520**  
**e-mail: [kika.shpritova@economy.gov.mk](mailto:kika.shpritova@economy.gov.mk)**

**Komisioni për realizim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike për lëndët e para minerale**





Sipas profesorit Vullnet Palloshi, Maqedonia është duke lëvizur në një situatë kur të gjithë fqinjët do të vijnë me autostrada në kufi, kurse brenda do të hasin në rrugë të mjerueshme për qarkullim. "Dy shtetet fqinje - Kosova dhe Shqipëria janë duke punuar intenzivisht në sferën e lidhjes ndërshtetërore në aspektin e infrastrukturës, kurse Maqedonia po harron infrastrukturën në Maqedoninë Perëndimore"

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 14 gusht - Edhe pse tashmë rishikimi i Buxhetit ka marrë formën zyrtare, megjithatë investimet kapitale infrastrukturore për Maqedoninë Perëndimore - gjegjësisht në viset e banuara kryesisht me shqiptarë nuk kanë gjetur vend në këtë buxhet. Bëhet fjalë për rrugën e Arbërit dhe rrugën Tetovë-Prizren. Të dy këto projekte do të duhet të presin edhe shumë gjatë pa ndonjë afat që të hyjnë në prioritetet e Qeverisë. Ndonëse shtetet fqinje siç është Shqipëria dhe Kosova tashmë nga ana e tyre punojnë intenzivisht në aspektin e infrastrukturës, siç është autostrada Prishtinë-Hani Elezit dhe së fundmi kur Qeveria e Shqipërisë ka ndarë 260 milionë euro për vazhdimin e rrugës së Arbërit, Maqedonia në këtë drejtim nuk ka ndërmarrë asgjë. Profesi universitar, Vullnet Palloshi, thotë për gazetën KOHA se edhe me buxhetin e ri nuk janë avancuar projektet shqiptare. "Fakt është që me rebalancin e ri të buxhetit, shohim se nuk janë avancuar kërkesat e popullatës së Maqedonisë Perëndimore, veçanërisht në pjesët që për një kohë të gjatë, për 20 e sa vite - vetëm se premtohen, prolongohen dhe asnjëherë nuk realizohen. Përveç rrugëve në lidhje edhe me infrastrukturën në përgjithësi, hekurudhat... sërish mund të shohim se ka ngecje të mëdha, faktikisht me këtë përparësi ju jepet projekteve në Maqedoninë Lindore, ndërsa Maqedonia Perëndimore si duket për një periudhë të gjatë kohore për 15 apo 20 vite është harruar

# Neglizhohen projektet madhore infrastrukturore

## Autostradat në Maqedoninë Perëndimore jashtë prioriteteve



ve në Maqedoninë Lindore, ndërsa Maqedonia Perëndimore si duket për një periudhë të gjatë kohore për 15 apo 20 vite është harruar apo e anashkaluar dhe siç duket - nuk kemi fuqi të bindim pjesëmarrësit në Qeveri që duhet të bëhet një ndarje shumë më e mirë e mjeteve për avancimin e popullatës edhe në këtë pjesë të Maqedonisë", thotë Palloshi.

Akuzon edhe OEMVP

Ndërkohë që këto vërejtje edhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore i ka adresuar tek qeveritë, por nuk janë marrë parasysh. "Ne si Odë Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore i kemi tërhequr vërejtjen Qeverisë që gjatë gjithë kësaj periudhe sa funksionojmë, që ata më tepër ti përkushtohen infrastrukturës sepse Maqedonia nuk është vetëm Lindore, mirëpo ka edhe anën e sajë Perëndimore, dhe atë Veriore..., që të zhvillojmë në mënyrë të barabartë, sepse zhvillimi i pabarabartë dhe rajonal ndikon edhe më shumë në ikjen e të rinjve nga vendet tona, sepse kur nuk kemi infrastrukturë - atëherë nuk ke

VULLNET PALLOSHI

"Me rebalancin e ri të buxhetit, shohim se nuk janë avancuar kërkesat e popullatës së Maqedonisë Perëndimore, veçanërisht në pjesët që për një kohë të gjatë, për 20 e sa vite - vetëm se premtohen, prolongohen dhe asnjëherë nuk realizohen. Përveç rrugëve në lidhje edhe me infrastrukturën në përgjithësi, hekurudhat... sërish mund të shohim se ka ngecje të mëdha, faktikisht me këtë përparësi ju jepet projekteve në Maqedoninë Lindore, ndërsa Maqedonia Perëndimore si duket për një periudhë të gjatë kohore për 15 apo 20 vite është harruar



bazë më të madhe për të funksionuar. Pra, inicialisht në shpresojmë dhe besojmë se vitin e ardhshëm, Buxheti do të votohet edhe me projektet, të cilat janë kapitale edhe për ne - shqiptarët, sepse këtë vit realisht nuk kishte edhe aq hapësirë për tu bërë të njëjtat", tha Milaim Ameti, nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore. Ai më tej shton se edhe partitë politike shqiptare nuk janë angazhuar shumë në këtë drejtim. "Për fat të keq, ne kemi pasur parti politike të cilat kanë qenë për gjatë kohë në pushtet dhe nuk kanë

arritur të realizojnë një autostradë prej trembëdhjetë kilometrash Shkup-Bllacë. Kjo është një fatkeqësi për ne - shqiptarët, por shpresojmë se janë vetëdijuesuar dhe do të fokusohen më tepër në zhvillim ekonomik se sa në ato që i përmendët ju më herët", tha ai. Nga ana tjetër, profesori Palloshi, shprehet se dy shtetet fqinje - Kosova dhe Shqipëria janë duke punuar intenzivisht në sferën e lidhjes ndërshtetërore në aspektin e infrastrukturës, kurse Maqedonia nuk u jep prioritet këtyre projekteve. "Fakt është që tashmë është bërë tenderimi

MILAIM AMETI

"si Odë Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore i kemi tërhequr vërejtjen Qeverisë që gjatë gjithë kësaj periudhe sa funksionojmë, që ata më tepër ti përkushtohen infrastrukturës sepse Maqedonia nuk është vetëm Lindore, mirëpo ka edhe anën e sajë Perëndimore, dhe atë Veriore..., që të zhvillojmë në mënyrë të barabartë, sepse zhvillimi i pabarabartë dhe rajonal ndikon edhe më shumë në ikjen e të rinjve nga vendet tona, sepse kur nuk kemi infrastrukturë - atëherë nuk ke bazë më të madhe për të funksionuar



asfaltit... bëhen disa përmirësime minimale sa për të thënë që ja - po punojmë atje. Objektet kapitale anashkalohen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e të gjitha buxheteve që miratohen në Maqedoni", shprehet Palloshi.

Harrohet Rruga e Prizrenit, ajo e Arbërit dhe Bllaca

Ndërkaq, sipas tij, Maqedonia është duke lëvizur në një situatë kur të gjithë fqinjët do të vijnë me autostrada në kufi, kurse brenda do të hasin në rrugë të mjerueshme për qarkullim. "Përveç kësaj, ne kemi edhe pjesën për të cilën gjatë gjithë kohës flitet - Rrugën e Prizrenit, që shohim se për të vetëm flitet.

Një pjesë që ka filluar është filluar me ndihmat nga Gjermania, sepse nuk është prioritet i Qeverisë. Kështu që, për fat të keq, duhet të konstatojmë se avazi i vjetër vazhdon që nënkupton se ne nuk jemi pjesëmarrës në ndarje të buxhetit dhe mjeteve, e veçanërisht të projekteve që janë strategjike për Maqedoninë Perëndimore, por në përgjithësi edhe për vet Maqedoninë, siç është edhe pjesa e Korridorit 8. Kemi edhe pjesën prej Gostivarit në Kërçovë, pasi edhe në këtë pjesë ende nuk kemi hyrë në fazën e mbarimit të dokumentacionit dhe tenderimit. Po ashtu, edhe pjesa e lidhjes së Shkupit, apo autostradës së Shkupit me Bllacën ka mbetë anash. Shumë shpejtë do të vijmë në një situatë shumë të vështirë kur fqinjët tanë do të vijnë me autostrada deri në kufij dhe do të duhet të hyjnë në rrugët regionale me një shpejtësi tejet të kufizuar", deklaroi Palloshi.

Hiqet gjendja e krizës

## Zjarret në Makedonski Brod tërësisht janë shuar

Shkup, 14 gusht - Zjarret në komunën Makedonski Brod, ku është shpallur gjendje krize, në fshatrat Vollçe, Zagrad, Rastezh, Zdunje, Bllizansko dhe Greshnicë janë shuar, informoi të hënën Nadica Vëčkova, zëdhënëse e Qendrës për Menaxhim me Kriza. "Në rajonin tjetër të krizës, në Komunën Çashkë, zjarri tek Jasenovska gllava nga ana e fshatit Popadia është lokalizuar. Sot në terren janë persona nga ekonomia pyjore 'Babuna' për kontroll në terren. Zjarri tek tuneli i Bogomillës në këtë rajon, gjatë ditës së

djeshme është vënë nën kontroll dhe sot po kryhet kontroll i sipërfaqes së djegur nga ana e pesë të punësuarve, të punësuar në EP 'Babuna', deklaroi Vëčkova. Gjatë ditës së djeshme, vazhdoi ajo, ekipi i QMK-së, Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, si dhe persona nga NP "Pyjet e Maqedonisë", po kryejnë mbikëqyrje dhe vlerësim të gjendjes me zjarret nga ajri, gjegjësisht me helikopter. "Zjarret në rajonet e tjera në pjesën më të madhe janë shuar ose

vënë nën kontroll. Një zjarr në sipërfaqe të vogël në komunën Kërçovë, në vendin Fërllagoec, ku po digjen kulloso, barë i thatë dhe pyll i degraduar lisi, ndërsa në mëngjes në këtë zjarr po intervenojnë persona nga EP 'Llopushnik', nga Kërçova", tha Vëčkova. Ajo theksoi se zjarri në afërsi të vendbanimeve Mazhurishte, Mramorani dhe Gorno Sello, në Prilep është vënë nën kontroll. Në rajonin e Strugës në vendin Toskë, midis fshatrave Bogojci dhe Tatesh, ka shpërthyer zjarr pyjor me të cilin është përfshirë pyll lisi dhe me drunj të

ulët, ndërsa në momentin e shuarjes së tij po intervenojnë zjarrfikës nga NJTZ Strugë dhe persona nga EP "Jabllanica". Nga QMK i përkujtojnë qytetarët se ende ekziston ndalesë për lëvizje në pyje dhe janë rritur kontrollet e MPB-së në bashkëpunim me Policinë pyjore. Në pyetjen e gazetarëve për atë se nëse deri tani kanë mbërritur fletëparaqitje për dëme, Vëčkova tha se tani për tani zyrtarisht nuk kanë mbërritur kurrfarë informata. Nga QMK theksuan se vlerësimi i dëmeve është rregulluar në dy



mënyra. Njëra është përmasë të djegur druri, vlerësimin e të cilit e kryen NP "Pyjet e Maqedonisë" dhe e konfirmon Inspektorati shtetëror për pylltari dhe gjueti. Dëmet

e tjera vlerësohen në pajtueshmëri të Ligjit për mbrojtje dhe shpëtim në nivel lokal nga Komisionet për vlerësim të dëmeve të njësitëve të vetëqeverisjes lokale.





**Çdo komb ka një Hero Kombëtar. Por rrallë i ndodh një vendi kaq të vogël si Shqipëria të ketë për të tillë, një figurë si Gjergj Kastriot Skënderbeu. Jo thjesht se për 25 vjet ai e ktheu Shqipërinë në një barrierë të sigurt ndaj ushtrive turke, por njëkohësisht ai u bë barrierë që osmanët mos të përparonin më tej në Evropë. Për këtë qëllim Evropa e njeh Skënderbeun si një "Atlet të Krishtit", një mbret dhe një luftëtar, që, nëse nuk do të ekzistonte, kishte gjasa që kontinenti të ndërronte fenë. Me rastin që dje Heroi ynë Kombëtar kishte ditën e vdekjes**

1. Gjergj Kastriot Skënderbeu lindi në Dibër, më 6 maj të vitit 1405. Vdiq në qytetin e Lezhës, më 17 janar të vitit 1468. Ai jetoi 62 vjet, 9 muaj e 12 ditë. Skënderbeu është figura më e shquar në historinë e Shqipërisë.

2. Gjergj Kastriot Skënderbeu mban titullin Hero Kombëtar që nga viti 1965, titulli më i lartë dhe i vetëm që mban një shqiptar për vlerat e larta të figurës së tij.

3. Gjergj Kastriot Skënderbeu ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit, princit të Shqipërisë së Veriut dhe i princeshës malazeze, Voj-sava. Gjergji ishte fëmija i fundit midis 4 djemve dhe 5 vajzave.

4. Gjergj Kastriot Skënderbeu u martua me Donika Aranitin nga Kanina e Vlorës dhe me të pati një djalë, Gjonin, emrin e të cilit ia vuri për nder të të atit. Për nder të të atit, i biri i Gjonit mori emrin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

5. Vlera më e lartë kombëtare e figurës së tij është se për 25 vjet ai mbajti larg Shqipërisë ushtrinë turke, duke e thyer pothuajse në çdo betejë. Janë të shumta betejat e fituara nga Skënderbeu së bashku me ushtrinë e tij.

6. Vlerat e figurës së Skënderbeut janë ndërkombëtare, duke qenë se ai u bë prijësi i barrierës ndaj ushtrive turke për pushtimin e Evropës dhe moshtirjes së fesë islame në kontinentin evropian.

7. Gjergj Kastrioti Skënderbeu i përkiste fesë së krishterë. U shndërrua në mysliman, pasi shkoi në ushtrinë turke dhe më pas u kthye përsëri i krishterë. Kjo ishte feja më e përhapur në Evropë në atë kohë.

8. Nga personalitete të huaja, nga historinë të huaja, ai ka marrë epitete të tilla si "Atlet i Krishtit" dhe "Ideatori i Aleancës së Parë Euroatlantike". Epitete këto që e ngrenë shumë lart figurën e Heroit tonë Kombëtar.

9. Mendohet se Gjergj Kastriot Skënderbeu ishte shtatshkurtër, truplidhur

dhe shumë i fuqishëm. Shpata të cilën përdori ai ishte e vështirë për ta përdorur një njeri i zakonshëm për nga pesha e saj.

10. Sot në botë emrin e Gjergj Kastriot Skënderbeut e mbajnë sheshe të shumta në kryeqytetet më të rëndësishëm të botës, duke filluar që nga Tirana, Prishtina, Zyrihu, Parisi, Roma, Çikago, Shkupi, etj.

11. Buste dhe shtatore të Skënderbeut ndodhen në Londër, Spanjë, Buenos Aires, Neë York, Kanada, Kosovë, Tiranë. Në të gjitha punimet artistike, Heroi Kombëtar qëndron hipur mbi kalë duke simbolizuar luftëtarin.

12. Përkrenarja me kokën e dhisë që mbante Skënderbeu ishte një simbol i huazuar nga legjendat e Pirros së Epirit dhe Aleksandërit të Madh. Ajo është me metal të bardhë dhe me një rrip (ruban) të larë me ar.

13. Janë dy shpata të Skënderbeut. E para i është dhuruar nga Papa në Krishtlindjet e vitit 1466 dhe është me trup të drejtë, e gjatë 85.5 centimetra dhe e gjerë 5.7, peshon 1.3 kg. E dyta është model turk, është 121 cm dhe peshon 3.2 kg.

14. Kali i Skënderbeut është një tjetër simbol që ka shoqëruar heroin. Sipas Barletit, ai ishte i bardhë, i një race të zgjedhur. Pas vdekjes së Skënderbeut, ai nuk pranoi t'i hipte njeri tjetër dhe ngordhi.

15. Në moshë të vogël së bashku me tre vëllezërit e tij, Skënderbeu u mor peng nga Sulltan Murati II, si ndëshkim për luftën që i shpalli Gjon Kastrioti, i ati i Skënderbeut, si dhe u vendos në Edrene të Turqisë.

16. Për trimërinë dhe zotësinë në artin ushtarak që tregoi gjatë betejave me ushtrinë osmane, gjatë betejave në Azinë e Vogël, Skënderbeu mori nga Sulltani titullin e gjeneralit. Skënderbeu studioi në Stamboll artin ushtarak, njihje gjuhën osmane, latine dhe shqip, si dhe shkruante dhe kishte oratori të lindur. Ballkani dhe Azia e Vogël ishin disa nga detyrat e tij ushtarake pas mbarimit të shkollës, duke u dalluar për trimëri.

17. Familja e Kastriotëve kishte një principatë të vogël në malet midis Matit dhe Dibrës, në kufirin verior, në zotërimet e Topiajve. Kostandin Kastrioti e filloi sundimin e tij mbi këtë principatë në vitin 1383.

18. Gjatë gjithë jetës së tij, Gjergj Kastriot Skënderbeu zhvilloi 30 beteja, nga të cilat 29 prej tyre i fitoi dhe vetëm një humbi. Betejat e udhëhequra nga Skënderbeu kanë qenë nga më të fortat dhe më të përgjak-

# Çfarë nuk dimë për SKËNDERBEUN



shmet.

19. Dy janë uniformat që ka përdorur Gjergj Kastrioti Skënderbeu. E para ishte uniforma e luftës, me përkrenare dhe parzmorë. Ndërsa veshja tjetër që përmend Barleti është ajo popullore me qeleshe dhe xhubletë.

20. Eshtrat e Skënderbeut u zhvarrosën nga turqit pas rënies së Krujës, më 1480, 12 vjet pas vdekjes. Varri i tij, që ndodhej në Kishën e Shën Nikut në Lezhë, u dhunua dhe eshtrat u morën si hajmali nga ushtarët turq.

21. Skënderbeu ka deklaruar se, "unë jam pasardhës i Pirros së Epirit". Marin Barleti në veprën e tij thotë se Skënderbeu i referohej shpesh origjinës së Pirros.

22. Dy herë Papa Piu II kërkoi të vinte në Shqipëri me qëllim kurorëzimin mbret të Skënderbeut. Në arkivat e Vatikanit ndodhet dokumenti që do të kurorëzonte Skënderbeun, Mbret të Epirit.

23. Emrin e Skënderbeut e mbajnë të paktën 10 objekte dhe institucione. Tri rrugë në Tiranë, Durrës e Krujë; një muze në Krujë, një fshat në Librazhd, një pije alkoolike konjak, një skuadër futbollit e Korçës, universiteti ushtarak, një titull i lartë, "Urdhri Gjergj Kastriot Skënderbeu" dhe një shesh në kryeqytet.

24. Emri i Skënderbeut u propozua nga Sami Frashëri t'i vendosej kryeqytetit të vendit. Në 1889 në veprën e tij "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet", Frashëri mendon që qyteti të ngrihej në fushën e Tiranës.

gjithë botën 600 libra, mes tyre romane, libra historikë dhe tregime, madje edhe legjenda, duke e ngritur në pedestal figurën e Skënderbeut.

32. Tri mbahen mend si tradhtitë më të mëdha ndaj Skënderbeut. Nipi i tij, Hamza Kastrioti, princi Moisi Golemi dhe tradhtia në betejën e Beratit, betejë kjo që është konsideruar e vetmja e humbur nga ushtria e Skënderbeut. Ballaban Pasha ishte gjenerali turk që u ndesh më tepër me Skënderbeun. Ballabani ishte shqiptar dhe për portën e lartë ishte i vetmi që e njihte artin e luftës së Skënderbeut. Në një betejë i vrau 8 komandantë të lartë Skënderbeut.

33. Tri herë qyteti i Krujës, që ishte dhe qendra e Skënderbeut, u rrethua nga ushtritë osmane. Dy herë nga sulltanët dhe një herë nga gjenerali më i lartë turk, Evrenoz Pasha. Por nën mbrojtjen e Skënderbeut qyteti asnjëherë nuk ra.

34. Dy sulltanë erdhën vetë në Shqipëri për të ndëshkuar Skënderbeun. Murati II, i cili thuhet se pas humbjes vdiq nga hidhërimi gjatë rrugës së kthimit, si dhe djali i tij, Mehmeti, i cili e la në mes rrethimin e Krujës.

35. Në të tri rrethimet e Krujës Skënderbeu iu desh të përballlej me një ushtri shumë herë më të madhe në numër. 100 mijë me Sulltan Muratin dhe po kaq me Sulltan Mehmetin dhe gjeneralët.

36. Titulli Skënderbej "Iskander Bej" ose "Aleksandër i Madh", iu dha nga Sulltan Murati II, pas fitoreve të betejave në Azi. Gjithashtu iu dha dhe titulli "Sanxhakbej" për zonën e Shqipërisë në vitet 1437-1438.

37. Rreth pesë mijë të vrarë mendohet se është numri më i madh i ushtarëve që ka humbur Skënderbeu në një betejë. Historianët turq thonë se beteja e Beratit ishte dështimi më i madh i Skënderbeut.

38. Një herë Skënderbeu vendosi paqe të përkohshme me Sulltan Mehmetin pas disfatave të ushtrisë turke. Historianët kanë mendime të ndryshme, por Barleti thotë se osmanëve u duhej të linin pak kohë Skënderbeun dhe të merreshin me luftërat në Bosnjë dhe Azi.

39. Më 1443 Skënderbeu braktisi ushtrinë turke. I dërguar nga Sulltani për t'u ndeshur me hungarezët e drejtuar nga Janosh Huniadit, Skënderbeu me ushtarët e tij besnikë largohet nga beteja dhe drejtohet për në Shqipëri.

40. Më 28 Nëntor të vitit 1443 u shpall rimëkëmbja e principatës së Kastriotëve. Kjo ndodhi pasi Gjergj

Kastrioti me një sërë masash ushtarake shtiu në dorë qytetin e Krujës dhe atje ngriti flamurin kuq e zi.

41. Lufta e kalorësisë ishte një nga mjeshtëritë e Skënderbeut. Kalorësia e pajisur me armë të lehta ishte një nga më të përdorshmet, duke bërë që të sulmonte radhët e armikut dhe të tërhiqej shpejt.

42. Pas 25 vitesh luftë, në janar të vitit 1468 Skënderbeu thirri një tjetër kuvend me princat shqiptarë. Barleti thotë se ato ditë Skënderbeu u sëmure rëndë nga ethet dhe shëndeti i tij nuk u përmirësua më.

43. Për vdekjen Skënderbeut ka pasur disa hipoteza. Në veprën e Barletit thuhet se ai vdiq në moshën 62-vjeçare pa asnjë shkak natyror. Vitet e fundit studiuesi Aurel Plasari hedh tezën se Skënderbeu mund të jetë helmuar.

44. Lidhja e Lezhës është i pari bashkim i princërve shqiptarë për të kundërshtuar pushtimin osman. Gjergj Kastriot Skënderbeu ishte organizator i kësaj lidhjeje historike nga ku nisi dhe qëndresa e arbitrit.

45. Gjoni, djali i vetëm i Skënderbeut, u largua në Napoli pas vdekjes së të atit, ku mori titullin "Duke" dhe "Kont". U martua me Irena Brankoviç Paleologu, pasardhësja e fundit e familjes perandorake të Bizantit dhe patën shumë fëmijë. Pasardhësit u shpërngulën në Leçe, në vitin 1700.

46. Gjyshi i Gjergj Kastriot Skënderbeut, Gjoni, vendosi sundimin e tij në Krujë në vitin 1439, por mësohet se Venediku e shpalli armik dhe i preu kokën në Durrës, në vitin 1402. Pas atij erdhi i biri, Gjoni, babai i Skënderbeut, i cili e mori Krujën përsëri dhe gradualisht e shtriu sundimin e tij mbi Tiranën, Matin, Dibrën dhe Mirditën, nga Prizreni në lindje, deri në detin Adriatik në perëndim.

47. Nga viti 1407 deri më 1430, Gjoni luftoi periodikisht me turqit, u mund 3 herë dhe u detyrua të pranonte kushte të rënda paqeje. Pas humbjes në vitin 1421, ai mbante një kontroll të kufizuar në principatën e tij.

48. Pas Kuvendit të vitit 1443, Skënderbeu më 2 mars të vitit 1444, mbajti Kuvendin pasues në Katedralen e Shën Kollit të qytetit të Lezhës. Ky ishte i pari Kuvend Kombëtar i princërve dhe i fisnikëve shqiptarë të shek. XV.

49. Portreti më i hershëm i Gjergj Kastriot Skënderbeut daton në vitin 1466. Gentile Bellini, në vitin 1466 kur Heroi vizitoi qytetin e Lagunovës në Itali, e pikturoi atë me urdhër të autoriteteve venedikase, sipas autorit Friedrich Kenner, mendohet se portreti ka qenë me profil majtas.

50. Një fakt tjetër në jetën e Skënderbeut është edhe iniciativa papnore enciklike për nderimin botëror të Gjergj Kastriotit. Me iniciativën e tij papa i romes mendoi t'i jepte këtë titull të lartë Heroit tonë Kombëtar, i cili është një nga vlerësimet më të mëdha në atë kohë.





Biografët shënojnë se Akifi filloi të shkollohej që në moshën 4 vjeçare. Pastaj, pasi nga i ati dhe nga hoxhallarët e këtyre shkollave mësoi arabishten, vazhdoi shkollimin në progimnazin e lagjes Fatih. Aty mësoi turqishten, arabishten, persishten dhe frëngjishten. Dhe kur t'i shtohet njohja shumë e mirë e gjuhës amtare shqipe, del e qartë se vogëlushi Akif kishte dhunti të jashtëzakonshme për t'u bërë poliglott i spikatur


Nga Xherardo NIKJARI

Akif Mehmet Pejani (Ipekli Mehmed Akif), apo siç njihet më mirë nga letërsia turke - Mehmed Akif Ersoy (1873-1936) është njëri ndër euditët e shumtë të trungut shqiptar, veprat e të cilit arritën lulëzim në ruall të huaj, aq sa ai është cilësuar si kryepoet i Turqisë moderne. Që në fillim duhet theksuar se një figurë kaq e madhe me prejardhje shqiptare, si Akif Mehmet Pejani, nuk njihet, nuk evidentohet, nuk përkthehet dhe nuk hulumtohet sa duhet nga historianët shqiptarë. Madje, as në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, nuk ka të dhëna për të. Por, falë shkrimeve të disa autorëve të mirënjohur shqiptarë si Nexhip Alban dhe Skënder Rizaj, është bërë e njohur biografia dhe vepra e Akif Mehmetit edhe në botën shqiptare. Dhe ç'është e vërteta, ka disa vjet që në Tiranë është hapur shkolla e mesme "Akif Mehmeti".

Babai i Akifit, Tahir efendiu - apo siç e emërojnë biografët turq Ipekli Mehmed Tahir Efendi, ishte nga fshati Shushicë i Pejës dhe ishte biri Nuredin Agës. Pas shkollimit në Pejë, Tahir efendiu shkoi për në Turqi me qëllim të studionte në Medresenë e Fatihut në Stamboll. Studimet i kryen me sukses dhe fiton titullin muderris (profesor). Për kulturën e gjerë që kishte, Tahir efendiu shërben komentes u islamit (vaiz) në xhamitë e Stambollit. Në martesën e Tahir Mehmet Pejani me Emine Sherifin më 1873 lindi Akifi, në shtëpinë e këtij çifti e cila gjendej pranë Bibliotekës Popullore në Stamboll.


Biografët shënojnë se Akifi filloi të shkollohej që në moshën 4 vjeçare. Pastaj, pasi nga i ati dhe nga hoxhallarët e këtyre shkollave mësoi arabishten, vazhdoi shkollimin në progimnazin e lagjes Fatih. Aty mësoi turqishten, arabishten, persishten dhe frëngjishten. Dhe kur t'i shtohet njohja shumë e mirë e gjuhës amtare shqipe, del e qartë se vogëlushi Akif kishte dhunti të jashtëzakonshme për t'u bërë poliglott i spikatur. Në të njëjtën kohë, Akifi tregonte interesim të thek-

# Poeti nga Peja që me zemrën plot Shqipni thuri himnin e Turqisë



• Akif Mehmet Pejani (Ipekli Mehmed Akif) 1873-1936


suar për letërsi dhe sidomos vjershërim. Kur Akifi gjendej në vitin e parë të gjimnazit, në moshën 14 vjeçare, përjetoi dy fatkeqësi të mëdha: i vdiq i ati dhe iu dogj shtëpia. Ishte prizrenasi hoxha Mustafa efendiu, ish nxënës i të atit, i cili mori përsipër përkujdesjen e Akifit. Megjithë këto dhembje dhe vështirësi Akifi do të arrijë ta kryejë gjimnazin dhe fakultetin e veterinarisë-madje me rezultate të shkëlqyeshëm. Me të mbaruar studimet (1893) Akifi fillon veprimtarinë e tij të begatshme arsimore, shkencore dhe letrare. Punësohet në Ministrinë Bujqësisë dhe në Universitetin e Stambollit duke dhënë ligjërata për letërsinë. Më 1896, Akifi martohet me Ismeten. Bashkëshortët do të kishin 6 fëmijë. Derisa gjendej në shërbim të Ministrisë së Bujqësisë atij iu dha rasti të vizitonte Ballkanin, Anadollin dhe Arabinë. Gjatë shërbimit në Ballkan, sidomos në viset e Shqipërisë ku shërbeu për dy vite radhazi, shfrytëzonte rastet për të vizituar Pejën ku çmallej me kushërinjtë dhe të afërmit e tij. Me një rast, kur po largohej nga Peja, e kishte marrë me vete kushëririn Fazil efendiu për ta shkolluar në Stamboll. Dhe, sot e kësaj dite, në fshatin Shushicë të Pejës jetojnë kushërirrit e Akif Mehmetit, ku Adem Beqir Mulaj rrëfen (lindur 1929) hollësisht mbi gjenea-



• Partitura me tekstin e Akif Mehmetit për himnin kombëtar të Turqisë

logjinë e poetit të madh. Megjithëse ishte diplomuar për veterinar, Akifi me devotshmërinë më pasionante i kushtoi studimeve islame, përkthimeve dhe thurjes së vargjeve. Përkthen vepra të rëndësishme nga arabishtja në osmanishte, në mesin e të cilave edhe në Kur'an-in.

Në veprimtarinë e tij letrare, sidomos në poezi, zotërojnë temat islame dhe ngjarjet botërore 1914-1918 si dhe ato çlirimtare 1919-1922. Më 1920, kur u mbajt Kuvendi i Parë i Madh Popullor i udhëhequr nga komandanti Mustafa Qemal-Ataturku, Akifi zgjedhet përfaqësues i vilajetit të Burdurit. Pastaj, dhjet vite të tëra, nga viti 1926-1936 Akifi ligjëron letërsinë turke në postin e profesorit të Universitetit të Kajros në Egjipt. Në atë kohë, i kapluar nga një së-



• Adem Beqir Mulaj (lindur 1929) kushëri i poetit të madh Mehmet Akif Pejani, fotografuar rishitas në fshatin Shushicë të Pejës

mundje r papritur, Akifi detyrohet të kthehet në Stamboll, ku edhe vdiq në Stamboll me 26 dhjetor të vitit 1936. Studiuesit konstatojnë se vjershërimet e Akif Mehmetit i stolis nivele shumë i lartë artistik, mendimi filozofik, stili i rrjedhshëm, i fuqishëm dhe dinamik.

Vargjet e tij, të shkruara në gjuhën osmane, janë të gërshetuara me shumë arabizma dhe persizma, me ç'rast transkriptimet nga osmanishtja në turqishten moderne me shkrirëronja latine u sjellin kokëçarje të mëdha, madje edhe letrarëve dhe përkthyesve më të zhdërvjellët.

Në transkriptimin e veprës së tij SAFAHAT (FYTYRAT) kanë bashkëpunuar disa shkrimtarët të mirënjohur turq, si Dogrul, Kuntay, Olgun dhe Duz-

dag. Kjo vepër kapitale, e thurur me mjeshtëri në vargje poetike, ka subjekt ngjarjet e rëndësishme në historinë botërore nga lashtësitë deri në kohën e autorit. Vepra SAFAHAT e Akif Mehmetit, aq shumë e ribotuar në Turqi, për vlerën e jashtëzakonshme që ka meriton të përkthehet në gjuhën shqipe, aq më shumë kur në të gjendet edhe poema e shkëlqyer kushtuar shqiptarëve dhe Shqipërisë në castet tragjike të këtij shekulli. Është pikërisht kjo poemë që shprehu mllëfën, zemërimin dhe ngritjen e zërit intelektual dhe atdhetar të Akif Mehmet Pejani kundër masakrave të bëra dhe gllabërimeve të trojeve shqiptare. Krijimi i kësaj vepre me motive shqiptare i kushtoi vendin e punës, Akifi dha dorëheqjen nga postet e larta shtetërore për të mbrojtur ideale të tij, për atdheun, Shqipërinë.

**Poema, që ka për subjekt Luftën e Parë Ballkanike, përbëhet nga 96 vargje. Poeti e përfundoi më 6 mars të vitit 1913. Poema fillon me vargjet:**

Tre milionë njerëz po vuajnë nga tri koka pa tru. Shqipëria po digjet... Kësaj here (djegiet) janë shumë të mëdha. Babë, Nëna jote më e dashur, memëdheu i vërtetë, A të bëhet viktimitë e tre horlukëve hajdutë?! Kudo që po ndodhem para syve më del një fushë e përgjakur...

A je ti, apo përfytyrimi yt? Kosovë e pa përkrahur! Ku është shkaku me mijëra herë i pushtimit tënd? Ku është qëllimi i kalimit të rrugës shkatërruese e "rrufesë" mbi varrin tënd? O, rrënjët e palidhura të pavarësisë, ku janë? Të gjitha shpresat, mendoj, përjetë u shuan. Ku je "Bashkim" i shkëlqyer, fantazi e lartë e krijuar? Ty madje me vite të hutoi ajo ëndërr e mallkuar.

Fjala "Bashkim" është dhënë në poemë në gjuhën shqipe me shpjegimin në turqisht. Vallë, a mund të kuptojmë se poeti Akif i drejtohet babait (të vdekur) me zhgënjimin për shpresat e shqiptarëve gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1882) dhe pas shpalljes së Pavarësisë për bashkimin kombëtar - për të cilat, me gjasë babai i kishte rrëfyer me entuziazëm të birit. Ndërkaq në vargjet vijuese poeti identifikon horrlukët hajdutë:

Truallin mos e ka mbytur përnjëherë horizonti i mëngjesit të përgjakur? Malazezi hajdut, serbi gomar, bullgari gjarpër Pastaj greku qen, atdheun

rreth e përçark e kanë rrethuar

Dhe, në përmbyllje të poemës, poeti shprehet: Shumica prej jush, u mor vesh, rrugën e gabuar s'po e shihni...

Hajnin, që tani ju shërben si këshilltar, dëbojeni, Dëgjoni këtë prej meje, që vërtet, jam shqiptar...

Gjë tjetër s'mund të them... Ja, atdheu im është i rrënuar!

Janë shumë dëshmi të shkruara e të pashkruara që vërtetojnë atdhedashurinë e flakët të poetit të madh Akif Mehmet Pejani për kombin shqiptar dhe për Shqipërinë. Në konkursin për përpilimin e himnit kombëtar turk, shpallur më 1921, fitoi teksti Istiklal Marşı (Marshi i pavarësisë) i thurur nga pena poetike e Akif Mehmet Pejani, që është në përdorim zyrtar edhe sot:

Mos ki frikë! Nuk shuhet flamuri i kuq që valon në këtë qiell

Pa u fikur oxhaku i fundit që tymos mbi atdheun tim Ai është ylli i popullit tim, do të shkëlqejë

Ai është imi, imi, vetëm popullit tim

T'u bëfsha kurban! Mos u buzëqeshi popullin tim hero, ç'është kjo forcë dhe kjo madhësi!

Se nuk të falet gjaku që është derdhur për ty

Pavarësia është e drejta e popullit tim që beson në Zot.

**Është me interes të meditojmë, mos ishte vallë, përpilimi i tekstit të himnit turk satisfaksion për Akifin pas zhgënjimit të thellë që përjeton me qëndrimin e shqiptarëve në luftërat ballkanike, kur në poemën e tij është shprehur:**

Ku është ajo pari e kombit që popujve u shpallte dyluftim?

Nuk pashë në fushëbetejë njeri, madje asnjë njeri...Mjerim!

Flaka e trojeve shqiptare flakërohej në shpirtin e poetit, i cili me oratori vullkanschpërthyes kritikonte politikën xhonturke dhe të disa shteteve evropiane ndaj Shqipërisë - në mitingun e rastit të mbajtur pranë xhamisë më të madhe të Stambollit, në Sulejmanie. Populli turk me respektin më të madh e ka bërë të pavdekshëm kryepoetin e vet Akif dhe veprën e tij. Shumë institucione, sheshe, qendra kulturore, kuarte dhe shkolla janë pagëzuar me emrin e tij. Madje, portreti i Akif Mehmetit gjendet edhe në kartëmonedhën e bankës turke me vlerë 100 lira.

(konika.al)





Elita të vendosura,  
bankierë të pakujdesshëm  
dhe koincidenca të  
historisë. Si u arrit në  
monedhën e trazuar

Giorgio La MALFA

# Ja se si u arrit në monedhën e quajtur Euro



Ndodhia e krijimit të Euros është vërtet e jashtëzakonshme. Sa më shumë studiohet, aq më shumë duket e habitshme. Është historia e një monedhe që nuk duhej të lindte, pasi pothuajse asnjëri nuk ishte në favor të një projekti me këtë shtrirje dhe që në fakt, nëpërmjet zinxhirit të një serie rrethanash, u bë një ide e pandalshme. Dhe pikërisht pse në thelb askush nuk kish besuar se vërtet do të arrihej në një monedhë të vetme për Evropën, kur ajo ka parë dritën, është kuptuar se kishte shumë aspekte të problemit, lidhur me të cilat nuk ishte reflektuar sa duhej. Në gjysmën e dytë të viteve Tetëdhjetë të Nëntëqindës, kur fillon kjo histori, rreshtimi i atyre "kundër" ishte i gjerë dhe i fuqishëm. Bënin pjesë Bankat Qendrore të 12 vendeve, që atëherë përbënin Komunitetin Evropian, ndoshta me përjashtim të Banca d'Italia e Carlo Azeglio Ciampi dhe të Banca di Espana. Fuqimisht kundër qenë në veçanti dy bankat qendrore më të rëndësishme: Bundesbank i drejtuar nga sanguini Karl Otto Pohl dhe Bank of England e drejtuar nga Robin Leigh-Pemberton, një loose cannon - një peshë e lehtë për më tepër e pakontrollueshme - në gjykimin e pamëshirshëm të Nigel Lawson, Kancelarit të Skakierës së atëhershme, por që gjithsesi kishte prapa kraheve vullnetin e hekurt të Zonjës Thatcher.

Qenë kundër në thelb qeveritë evropiane, pavarësisht se të gjitha, përveç Anglisë, deklaroheshin me fjalë në favor të idesë së një Bashkimi ekonomik dhe monetar. Dhe në çdo rast idetë e tyre lidhur me organizimin dhe qëllimet e Bashkimit qenë aq të larmishme dhe aq kundërshtuese midis tyre, sa të siguronin se ishte shumë vështirë që të mund të binin dakord midis tyre lidhur me një projekt konkret. Edhe opinionet e ekonomistëve dhe të ekspertëve, në shumicën dërrmuese të tyre, qenë tejet negative. Ekonomistët amerikanë shprehnin hapur dyshimet e tyre, ndërsa evropianët, megjithëse duke mos i inoruar problemet dhe vështirësitë e futjes së një monedhe unike në vende kaq të ndryshëm mes tyre, preferonin që të

mos e thellonin shumë diskutimin, për të mos u akuzuar për evropianizëm të pakët. Së fundi, këtyre vështirësive i shtohet fakti që futja e një monedhe evropiane nuk parashikohet nga traktatet evropiane në atë kohë në fuqi, dhe kështu që kërkohet miratimi i një traktati të ri, me të gjithë vështirësitë që do të sillte një gjë e tillë. Në të vërtetë, pavarësisht kësaj tërësie rrethanash negative, në një pikë të caktuar, midis viteve 1988 dhe 1989, u hartua projekti i një Bashkimi monetar evropian dhe, kur menjëherë më pas ideja u vu në lëvizje, marshimi i tij u bë i pandalshëm.

U negociua me ngut një traktat i ri, i nënshkruar në Maastricht në shkurtin e vitit 1992, në të cilin kapitulli kryesor kishte të bënte me Bashkimin Monetar Evropian. Përveçse në Francë, ku një referendum i premtuar në mënyrë të pamatur nga Francois Mitterrand rrezikoi që të hidhte në erë gjithçka, ratifikimet e traktatit qenë shumë të shpejta (për shembull, Parlamenti italian që ndër më të nguturit dhe më pak reflektuesit). Në fund të vitit 1993, traktati hyri në fuqi.

Më pak se 5 vite më pas lindi Banka Qendrore Evropiane. Njëkohësisht me krijimin e Bankës, u individualizuan 11 vendet e para anëtare të Eurozonës. Nga 1 janari i 1999, politika monetare kaloi në duart e Bankës Qendrore Evropiane. Tri vjet më vonë hynte në qarkullim euro. Si ndodhi kjo lloj amnezie kolektive që mundësoi të realizohej me ngutin maksimal një projekt për të cilin sot, në harkun e pak viteve, edhe

shumë prej atyre që atëherë qenë në favor, kanë përfunduar duke u distancuar prej tij? Është një ndodhi që meriton të rindërtohet, edhe në dritën e një libri të çmuar relativisht të vonshëm të titulluar "Making the European Monetary Union" (shtëpia botuese Harvard University Press, Cambridge Massachusetts 2012), i shkruar nga studiuesi Harold James duke mundur të përdorë, përkrah dokumenteve zyrtare, edhe letrat e atyre viteve të ruajtura në arkivat e Bankave Qendrore dhe të Bankës së Rregulimeve Ndërkombëtare të Bazelit. Historia mund të tregohet si një lloj pjese teatrale me dy akte dhe shumë skena. Akti i parë u zhvillua në gjirin e një komiteti për studimin e Bashkimit ekonomik dhe monetar evropian, i ngritur nga Këshilli Evropian i Hannoverit në qershorin e vitit 1988. Komiteti i kryesuar nga Jacques Delors, në atë kohë President i Komisionit Evropian, i zhvilloi me shumë shpejtësi punimet e tij dhe e dorëzoi raportin përfundimtar, të miratuar me unanimitet nga përbërësit e tij, në prillin e 1989. Kurse akti i dytë filloi me 9 nëntor të 1989 me rënien e Murit të Berlinit dhe përfundoi në Maastricht të Holandës, me nënshkrimin e traktatit me të njëjtin emër, me 7 shkurt të 1992. Në mes ndodhi bashkimi i Gjermanisë që peshoi në mënyrë vendimtare mbi rrjedhën e ngjarjeve. Personazhi kryesor i gjithë kësaj ndodhie, në aktin e parë, ashtu si edhe në të dytin, që Jacques Delors, i cili atëherë kryesonte Komisionin Evropian me një

energji dhe me një prestigj që asnjë prej pasuesve të tij nuk e ka pasur më. Në krah të tij patën një rol të rëndësishëm disa funksionarë të lartë evropianë, midis të cilëve më i kthjellëti që italianin Tommaso Padoa-Schioppa, në ato vite Drejtor i Çështjeve Monetare të Komisionit Evropian. Delors ishte i shtyrë nga bindja se nuk qenë më të mjaftueshëm hapat e pjesshëm me të cilat zhvillohej procesi i integritimit evropian dhe një hop cilësor në gjirin e bashkimit politik të kontinentit. Për ta realizuar, duheshin shtrënguar qeveritë dhe Bankat Qendrore, të fortifikuara siç ishin në mbrojtje të sovraniteteve kombëtare nga të cilat dukej se varej pushteti i tyre. Në aktin e parë, me Delors ndërvepruan guvernatorët e Bankave Qendrore; ndërsa në të dytin hyjnë në skenë qeveritë evropiane të kohës.

## AKTI I I-rë. SKENA E I-RË. LIND KOMITETI DELORS

Qershor 1988. Jacques Delors bind krerët e shteteve dhe të qeverive evropiane që të krijojnë një komitet të urtësh për studimin e Bashkimit ekonomik e monetar evropian dhe ta emërojnë President të tij. Ideja nuk i pëlqeu pothuajse askujt. Dakord me Kancelarin gjerman Helmut Kohl, Delors vendos që të thërrasë për të bërë pjesë në komitet "me titull personal" guvernatorët e Bankave Qendrore të 12 vendeve anëtare (plus tri ekonomistë dhe një Zëvendës-president të Komisionit). Është gjetja e parë. Guvernatorët, en-

ergjikisht kundër idesë për të studiuar krijimin e një djallëzie tjetër evropiane të destinuar, dyshon Karl Otto Pohl, Presidenti i Buba-s (siç quhej më përkëdheli Bundesbanku), që të fusë hundët në kompetencat e tyre si tutorë të rreptë të stabilitetit, por nuk mund të mos qetësohen sadopak duke qenë të thirrur për të qenë pjesë e komitetit. Edhe Zonja Thatcher, armike ndaj çdo propozimi të ardhur nga Brukseli (dhe në veçanti nga Delors), qetësohet disi pasi me dy qen roje si Pohl dhe për gjithçka Buba-s. Konvertimi i Pohl sjell me vete atë të Robin Leigh-Pemberton, qenit roje tjetër që kishte pasur nga qeveria e tij detyrën e vigjilimit që komiteti të mos qulloste gjë. Thatcher, e cila nuk duhet ta kishte ndonjë opinion të lartë, i kishte thënë: "Unë kam besim tek Pohl. Nëqoftëse ai propozon ndonjë gjë, ndiqe". Kështu, me "rekrutimin" e Pohl, ishte në bord edhe Leigh-Pemberton. Në demonstrim të zgjuarsisë së tij, ekziston një letër e tij për Kancelarin e Skakierës përpara mbledhjes së parë në të cilën lexohet se në gjirin e komitetit "pragmatistët kanë në dorë gjënë; me sa duket janë mazhoranca; idealistët janë të heshtur dhe Delors neutral"!!!!

## AKTI I I-rë. SKENA (DHE GJETJE) E II-TË. FILLON KOMITETI

Në mbledhjen e parë Delors shpjegon se detyra e komitetit nuk është ajo që të diskutojë nëse të bëjë apo jo Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Detyra e tyre, thotë ai, është ajo që të shkruajnë një manifest politik lidhur me integritimin evropian, është (vetëm) ajo e kryerjes së një eksplorimi teknik sesi të organizohet një Bashkim Monetar Evropian, në rastin ku politika vendos që të procedojë në këtë drejtim. E paraqitur kështu, edhe më skeptikët midis guvernatorëve i hyjnë punës duke menduar, siç e tha njëri prej tyre, se detyra ishte ajo që të shpjegohej saktësisht "se çfarë do të thoshte Bashkim dhe sidomos sesa ishte i vështirë ai". Delors shtoi se mbledhjet duhej të ishin tejet të rezervuara në mënyrë që të reduktohej sa më shumë të ishte e mundur interferencat e jashtme, domethënë tentativat e qeverive për t'u përzier në vendimet e guvernatorëve. Krijohet kështu një shpirt grupi dhe lihen praktikisht në errësirë qeveritë lidhur me atë se çfarë komiteti po diskuton dhe se në çfarë drejtimi po ecin gjërat.

## AKTI I I-rë. SKENA E III-TË. MBLEDHJET E KOMITETIT

Menaxhimi i një serie primadonash tejet vanitoze siç janë në fakt guvernatorët (përveç Pohl dhe Leigh-Pemberton, duhet shtuar midis protagon-

nistëve edhe francezin Jacques de Larosiere) duhet të ketë qenë mjaft i komplikuar. Por Delors është mjaft i aftë. I drejton guvernatorët drejt përshkrimit të arkitekturës së sistemit të ri që më shumë u afrohet idealeve dhe ëndrrave të tyre të pavarësisë nga pushteti politik.

Në mënyrë të veçantë, Delors i jep Pohl detyron që të përcaktojë karakteristikat e një Banke Qendrore Evropiane dhe Pohl - "a broken reed", një person i dobët dhe jo i besueshëm, do të shkruajë më pas Kancelari i Skakierës, pasi ka thënë në mbledhjen e parë se komiteti duhet ta heqë qafe idenë e Bashkimit monetar dhe t'u shpjegojë politikanëve "se në këtë moment nuk ekziston një shans realist për të ndërtuar një bashkim monetar", përfundon rob i vetë propozimeve të tij, duke përshkruar një Bankë Qendrore që i ngjan në dhe për gjithçka Buba-s. Konvertimi i Pohl sjell me vete atë të Robin Leigh-Pemberton, qenit roje tjetër që kishte pasur nga qeveria e tij detyrën e vigjilimit që komiteti të mos qulloste gjë. Thatcher, e cila nuk duhet ta kishte ndonjë opinion të lartë, i kishte thënë: "Unë kam besim tek Pohl. Nëqoftëse ai propozon ndonjë gjë, ndiqe". Kështu, me "rekrutimin" e Pohl, ishte në bord edhe Leigh-Pemberton. Në demonstrim të zgjuarsisë së tij, ekziston një letër e tij për Kancelarin e Skakierës përpara mbledhjes së parë në të cilën lexohet se në gjirin e komitetit "pragmatistët kanë në dorë gjënë; me sa duket janë mazhoranca; idealistët janë të heshtur dhe Delors neutral"!!!!

## AKTI I I-rë. SKENA E FUNDIT. KONKLuzionet E Komitetit

Në fillim të prillit 1989, Delors sjell një tekst final që në thelb përcakton udhëtimin me tri faza drejt Bashkimit Monetar të adoptuar më pas në Maastricht. Modeli i Bankës Qendrore është ai i Bundesbankut. Objektivi i politikës monetare është stabiliteti i çmimeve. Financat publike e vendeve anëtare duhet të mbahen nën kontroll. Guvernatorët nguten që të konkludojnë, të bindur veç të tjerave se qeveritë gjithsesi nuk do të bëjnë asgjë. Argumenti si të thuash përfundimtar është i Leigh-Pemberton: "Nëqoftëse ua tregoj këto letra të mallkuara Thesarit, atyre u shkatërrohen nervat... Nëqoftëse përfundojmë pas një jave, do të më kërkojnë të bëj amendamente të tjera... Unë kërkoj që të shpëtoj nga kjo bela". Kështu që është

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi



gubernatori i vendit më kundra, i Mbretërisë së Bashkuar, ai që në fund e shtyn në port anijen e Delors. Kështu përfundon akti i parë. E megjithatë, siç është thënë, ka mundësi që kryevepra taktike e Delors nuk do të kishte çuar tek monedha e vetme nëse historia nuk do të kishte bërë pjesën e mbetur.

Qeveritë nuk kishin kurrfarë dëshire që të procedonin me Bashkimin Ekonomik e Monetar, as pas prezantimit të Raportit Delors në prillin e 1989. Problemet qenë tejet të komplikuar. Për të miratuar një traktat të ri nevojitej miratimi unanim i vendeve anëtare. Zonja Thatcher nuk e mendonte aspak. Por ra Muri i Berlinit dhe perspektiva e ribashkimit të Gjermanisë ndryshoi sa hap e mbyll sytë gjithçka.

**AKTI I II-të. SKENA E I-rë. BIE MURI I BERLINIT**

Rënia e Murit të Berlinit nuk gjeneroi asnjë valë gëzimi në kancelaritë evropiane. Në Kujtimet e saj, zonja Thatcher tregon në mënyrë dinake se Mitterrand i telefonon të nesërmen e rënies së Murit dhe i thotë se në momentet e rreziku Franca dhe Anglia duhet të krijojnë front të përbashkët. Rrezik?

Natyrisht, ribashkimi gjerman. Giulio Andreotti, që mendonte se ishte hokatar, tha gjatë atyre ditëve se e donte aq shumë Gjermaninë sa që shkaktonte kënaqësi fakti që qenë dy të tilla. E kështu me radhë. Evropa pyeste sesi do të mund të shmangej që Gjermania të vraponte e vetme në lëndinat e Evropës Lindore. Dhe kështu Mitterrand i erdhi në mendje - ndoshta qe edhe Delors ai që mund t'ia ketë sugjeruar - se, në rast se nuk mund të shmangej ribashkimi gjerman, ndaj të cilit amerikanët qenë në favor, mund të ofrohej marrëveshja evropiane ndaj unifikimit në shkëmbim të heqjes dorë nga doçmarka nga ana e Gjermanisë. Kështu, brenda pak javësh, u nis në drejtim Maastricht.

**AKTI I II-të. SKENA E II-të**

4 janar 1990. Më pak se 2 muaj pas rënies së Murit të Berlinit, Kohl dhe Mitterrand u takuan. Në komunikatën finale, duke cituar së bashku nisjen e negociatave për ribashkimin gjerman dhe ato për krijimin e Bashkimit monetar. Treni nisët. Po të gjitha dyshimet dhe paqartësitë lidhur me praninë e kushteve të nevojshme për suksesin e monedhës së vetme? Të flakura tej nga urgjenca e zgjedhjeve politike. Bundesbanku ishte dhe mbetej kundër, por nga njëra anë Pohl nuk mund të distancohej më nga një projekt i Bankës Qendrore Evropiane të bërë sipas modelit të Bundesbankut dhe nga tjetra Kancelari Kohl nuk donte pengesa ndaj bashkimit gjerman. Dhe kështu është shkruar drejt monedhës së vetme pa mbajtur parasysh kushtet ekonomike dhe politike që do të mund t'i siguronin suksesin dhe pa rënë vërtet dakord sesi ta bënin të funksiononte. Kusuri është histori e vonshme, përfshi këtu rezultatet e zgjedhjeve në Greqi dhe euroskepticismin në rritje në të gjithë Evropën, në jug, ashtu si edhe në veri.

Intendancë sivra, thoshte Charles de Gaulle duke folur për primatin e politikës ndaj ekonomisë. Por në këtë rast intendancë nuk ka pasuar dhe nuk pason. Ja pse jemi në një det belashë.

*(Giorgio La Malfa është politikan dhe akademik italian. Këtë artikull e ka botuar për Il Popolo)*

**Nga viti 2001 deri më sot çdo krizë politike është bërë rreth akomodimit të "unë-it". Në asnjërin prej krizave politike nuk është përshkruar një parim i cili do të ngrihej mbi akomodimin e tërësisë. Pra, çka është ajo që do t'i akomodonte interesat e Kosovës, e jo çka është ajo që akomodon "unë-in e prijësit". Ankthi, anksoziteti, angushtia - cilado prej këtyre sinonimeve emocionale negative - që i krijon lufta për përmbushjen e unë-it, bartet kolektivisht në shoqëri**



Veton SURROI

**1.** Dr. Richard Davidson nga Universiteti i Wisconsinit ia lidhi 256 elektroda në kokë Mattieu Ricardit dhe e mbajti tri orë në makinën e rezonancës magnetike duke kërkuar prej tij që të ushtrojë meditim që nga shkalla parësore deri te ajo më e thelluar. Rezultati doli të jetë ai që kishte menduar prej kohësh, që nga fillimi i studimeve të tij specialiste: lumturia është produkt i mendimit të thelluar dhe është e matshme në pjesët e trurit që dikur konsideroheshin të mos kishin farë lidhjeje me ndjenja. Dr. Davidson tashmë njihet si prijës në një fushë të re të neuroshkencës, atë afektive, ndërsa Mattieu Ricard është një figurë tashmë e njohur me epitelin "njeriu më i lumtur në botë". Ricard ishte i punësuar në Institutin Pasteur në Francë, si doktor shkencash në gjenetikë molekulare, kur më 1972, i inspiruar nga Dalai Lama, vendosi ta braktisë shkencën dhe të bëhet murg budist. Që të dy kanë shkruar libra për përvojën e tyre, dhe te që të dytë përbashkohet konkluzja e njëjtë: kujdesi ndaj trurit, në sajë të një qasjeje të favorshme emocionale e zhvillon atë më tutje. Korteksi prefrontal, ajo pjesë e trurit që tashmë dimë se prodhon aktivitet lumturie në anën e vet të majtë dhe stresi e depresioni në të djathtë, arrin shkallët më të larta të aktivitetit në anën e majtë me mendimin më të thelluar të dashurisë, për më tepër asaj të papërcaktuar e të paperonalizuar.

**2.** Kam përshtypjen, ndoshta edhe bindjen lehtë të verifikueshme, se elektrodën e lidhura në kokën e një qytetareje të Kosovës në ciklet e ndryshme politike, e në veçanti para themelimit të qeverive të ndryshme, do të tregonin aktivitet të shtuar në anën e djathtë të korteksit

# Udhëzime budiste për Parlamentin e Kosovës



prefrontal. Qytetarja e rëndomtë e Kosovës do të kishte shkallë të ndryshme të angushtisë deri te depresioni klinik para se të konstituohet Qeveria, e pasi që të themelohet gjendja do të vazhdonte për të gjithë të tjerët, pos për ata (anëtarë partie, fisi, mëhalla e regjioni) që janë përfshirë në Qeveri. Ekziston një arsye madhore pse është kështu dhe një murg budist si Mattieu Ricard do ta zbulonte menjëherë. Ndërsa shkenca politike bashkëkohore do ta quante kulturë të qeverisjes ekstraktive, pra të gjendjes ku qeverisja shërben për të avancuar interesat materiale të qeveritarëve (familjeve e fisit të tyre) - një kulturë ku Kosova mund të shërbejë si model klinik - Mattieu Ricard do ta shikojë nga një kënd individual. Një burim i madh i angushtisë dhe i depresionit, thotë Ricard, vjen nga të "menduarit për unë-in".

Nëse një individ mendon vetëm në kategorinë e "unë, unë, unë", thotë Ricard, mbërrin në gjendje ku e tërë bota jashtë teje është ose "kërcënim ose një lloj interesi potencial" përfitimi. Në fakt, analiza e murgut budist i afrohet më së shumti të vërtetës së përshkrimit të jetës politike në Kosovë. Ajo, po e po është ekstraktive - pra i ka shërbyer nxjerrjes së përfitimeve materiale kas-tave qeverisëse - por po aq ka qenë e udhëhequr prej motivit të përmbushjes së "unë-it". Për ata që duan të kuptojnë se çka ndodh këto ditë me paralizën parlamentare mjafton një shikim mbrapa në vitin 2001, kur u institucionalizua kultura e unë-it. Në ato zgjedhje partia që mori më së shumti vota qe LDK-ja, por jo mjaftueshëm për të formuar Qeverinë pa koalicion. Lideri i saj qe i interesuar për postin e "unë-it", të presidentit të Kosovës dhe si këmbim ia dha postin e kryeministrit PDK-së. Për

një kohë të gjatë nuk u formua Qeveria, sepse posti i kryeministrit shihej si një tjetër post "unë-i". Atë donte ta merrte Hashim Thaçi, emër që, i lidhur me një gjendje të dhunshme e të kriminalizuar të pasluftës u bllokua nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Nga viti 2001 deri më sot çdo krizë politike është bërë rreth akomodimit të "unë-it". Në asnjërin prej krizave politike nuk është përshkruar një parim i cili do të ngrihej mbi akomodimin e tërësisë. Pra, çka është ajo që do t'i akomodonte interesat e Kosovës, e jo çka është ajo që akomodon "unë-in e prijësit". Ankthi, anksoziteti, angushtia - cilado prej këtyre sinonimeve emocionale negative - që i krijon lufta për përmbushjen e unë-it, bartet kolektivisht në shoqëri.

**3.** Mësimi i dytë i murgut budist - në fakt një mënyrë jete për të - është ajo që ai e quan "ndërgjegjësimi". Mendja meditative e njeriut ka kapacitet depërtimi më të thelluar tek thelbi i çështjeve, dhe, sikur është nxjerrë në incizimet e rezonancës elektromagnetike, momenti kur truri thellohet deri tek të kuptuarit e zgjidhjes së një problemi, rritet gjithashtu aktiviteti në pjesët e lumturisë. Në njërin prej ligjëratave të tij, Ricard e bëri analogjinë me retë e dendura të stuhisë. Shikuar nga poshtë, ato duken kërcënuese e të rrezikshme, por po "pate mundësinë të ngjitesh e të futesh në to, sheh se janë vetëm mjegull". Shikuar nga poshtë, krizat politike në Kosovë duket se janë të thella e serioze. Por po të përpiqesh t'i kuptosh nga brenda, sheh se bëhet fjalë për një grup njerëzish që aspirojnë që me investimin më të vogël intelektual e shpirtëror të krijojnë përfitimin më të madh material. Krizat politike në Kosovë janë përpjek-

je rituale për të mbajtur nivelin më të ulët mendor e social në pozitazhë elitare. Dhe, meqë ky është parimi fillestar e përfundimtar, atëherë këto parime kërkojnë që mekanizmat e demokracisë t'i adaptohen parimit fillestar e përfundimtar, e jo që ato t'i adaptohen demokracisë. Andaj, në krizën e kaluar politike Gjykata Kushtetuese u vu në shërbim të dhunuesve politikë duke krijuar mekanizma Frankestein për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit dhe të Qeverisë. Dhe, andaj në këtë krizë, mekanizmi demokratik i zgjedhjes së Qeverisë varet prej premtimit të një njeriu që akuzohet si shitës vizash se do ta përmbushë shitjen e votës së motrës së tij.

**4.** Porosia e murgut budist Parlamentit të Kosovës? Një, mund të bëheni të lumtur (dhe ta shpërndani tutje lumturinë) nëse mendoni se si do të mbrohet më së miri interesi i Kosovës para atij të "unë-it". Interesi i Kosovës, sikur edhe lumturia me elektrodën, është i matshëm në demokraci e Parlament: një Qeveri e cila ndërtohet nga blerja individuale e deputetëve për të mbërritur numrin 61 përmbush nevojat e "unë-it", jo të tërësisë. Dy, mund të bëheni të lumtur (dhe ta shpërndani tutje lumturinë) nëse ndërgjegjësoheni. Aty jeni për të mbrojtur një interes shumë të madh se ç'është i juaji; ndajeni së bashku këtë ndërgjegjësim me ata që nuk janë të grupit tuaj. Arrini së bashku mbi retë e zeza kërcënuese e shantazhuese; në fund, ato janë vetëm mjegull e grupuar në një vend. Një murg budist në një ambient që më shumë e kërkon ndërhyrjen e Elliot Nessit, detektivit zulmëmadh anti-mafia? Në ankthin kolektiv e në vapë është sfiduese të jesh kreativ.

(koha.net)



## BEKIM FETAJI, PROREKTOR NË UNT



# UNT, NJË AMANET I GJITHË SHQIPTARËVE

Fakti se në kryeqendër jeton një numër i madh i shqiptarëve dhe gjendja jo e volitshme e arsimit të kësaj ane, ishte një çështje dhe nevojë, "një amanet" që duhej zgjedhur dhe besojmë se Universiteti "Nënë Tereza" me kohë do fillojë të tregojë rezultatet e veta pozitive. Arsimimi është me kosto të ulët, kështu që mundësi të barabarta janë krijuar për të gjithë, madje edhe për ato me pak të ardhura financiare, të mund të studiojnë dhe të edukohen në mënyre cilësore

Koha

Delvina KËRLUKU

Prof.dr. Bekim FETAJI është profesor ordinar në fushën e Informatikës pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup. Ka përfunduar studimet e doktoraturës në shkencat kompjuterike në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Universitetin e Teknologjisë në Graz, Austri, në vitin 2008 dhe ka përfunduar studimet e Magjistraturës në Shkencat Kompjuterike në Universitetin "Oxford Brookes", në Oksford të Anglisë në vitin 2004. Është zëvendësrektor për Shkencë pranë Universitetit "Nënë Tereza" dhe Dekan i Fakulteti të Informatikës. Ish-kreu i grupit të kërkimeve në fushën e Programimit dhe Inxhinierisë Softuerike dhe Specifikimeve Formaleve të Softuerit. Më parë ka qenë Dekani i Shkencave Kompjuterike dhe para kësaj - zëvendësdekan për çështje akademike në Shkencat Kompjuterike në Universitetin e Evropës Juglindore. Ka marrë pjesë në më shumë projekte ndërkombëtare dhe kombëtare brenda programeve të ndryshme të bashkimit Evropian si

Tempus, FP7, Erasmus dhe projekte të tjera kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka qenë profesor vizitues në shumë universitete, midis të cilëve në Japoni - në Universitetin e Tokios për Agrikulturë dhe Teknologji, pranë Fakultetit të Shkencave Kompjuterike. Gjithashtu, si profesor vizitues ka qenë edhe në Qendrën "South East European Research Centre (SEERC)", pranë Universitetit të Shefildit - City Universitetit, Selanik, Greqi, si dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, etj. Ka të publikuar mbi 100 punime shkencore ndërkombëtare, ndër të cilat më shumë se 30 punime në revista ndërkombëtare - në disa Revista me ISI ëeb të faktorit të impaktit të Shkencës. Gjithashtu ka të publikuar shtatë libra midis të cilëve një libër në gjuhën angleze dhe i publikuar në Angli, dhe i cili edhe shitet në shitoren online Amazon. Ka qenë në Komitetin shkencor në më tepër konferenca ndërkombëtare si dhe udhëheqës (chair) i disa sesioneve të konferencave si Ed-Media 2008 në Vjenë të Austris, ITI IEEE 2009-

2013, në Cavtat të Kroacisë... Po ashtu është edhe recensues i punimeve shkencore në ACM që nga viti 2009. Gjithashtu ka qenë edhe zëvendëskryetar i Bordit të akreditimit dhe eualimit të arsimit të lartë në Maqedoni.

**KOHA: Prorektor, Universiteti "Nëna Terezë" në Shkup patjetër që ishte një nevojë imediate. Jo vetëm për faktin që kryeqyteti s' kishte asnjë universiteti, kurse "provinca" i kishte dy, por edhe për faktin tjetër, atë thelbësorin, se këtu jeton një numër i madh i shqiptarëve (bashkë me Kumanovën dhe Luginën e Preshevës). Gjithashtu, nuk duhet anashkaluar edhe gjendja jo e volitshme e arsimit të kësaj ane, e cila është pasojë e politikave diskriminuese të pushteteve që vanë. Ç'do t'i shtonit këtij konstatimi, apo me çka do ta kontestoni?**

**FETAJI:** Fakti se në kryeqendër jeton një numër i madh i shqiptarëve dhe gjendja jo e volitshme e arsimit të kësaj ane, ishte një çështje dhe nevojë, "një amanet" që duhej zgjedhur dhe besojmë se Universiteti "Nënë

Tereza" me kohë do fillojë të tregojë rezultatet e veta pozitive. Arsimimi është me kosto të ulët, kështu që mundësi të barabarta janë krijuar për të gjithë, madje edhe për ato me pak të ardhura financiare, të mund të studiojnë dhe të edukohen në mënyre cilësore. Themelimi i një tempulli të dijes siç është Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, që mban emrin e humanistes dhe shenjtores shqiptare, Nënës Terezë, e cila merret me edukimin e gjeneratave të reja të shekullit të ri, jo vetëm që do të përmbushë një amanet të kahershëm, por edhe do të shfrytëzojë kushtet më të favorshme që i ofron kryeqendra me resurset, qasjet ndaj industrisë dhe teknologjive të reja, si dhe frymën e gjerë të një metropoli dhe me këtë të krijojë një vlerë të shtuar, një qasje të re të fuqizimit të edukimit duke shfrytëzuar këto përparësi.

Koha në të cilën jetojmë është koha e një zhvillimi të hovshëm teknologjik, e cila ka implikacion të fuqishëm në të gjitha sferat e jetesës, sidomos te edukimi, informimi dhe komunikimi masiv. Universitetet sot po hyn në botën e gjerë të teknologjisë të arsimit, pasi kjo po bëhet gjithnjë e më e domosdoshme në botën e sotme. Kreativiteti dhe inovacioni janë thelbësore për një arsim cilësor dhe ne fokusohemi në inkorporimin e tyre në procesin arsimor. Për më tepër, informacioni dhe sistemet e komunikimit kanë shpërthyer jashtë dimensionit lokal dhe domosdoshmëria për të punuar me kultura dhe komunitete të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare - për të trajtuar qasje të ndryshme shkencore në zgjidhjen e problemeve dhe për të rritur nivelin e arsimit, kreativitetin dhe inovacionet - janë bërë të patjetërsueshme.

**KOHA: Me vetë hapjen e këtij tempulli të dijes, u ngrit mjaft pluhur rreth nevojës për hapjen e tij, por edhe për pranimin e kuadrit, i cili në masë të madhe vinte nga radhët e partisë në pushtet, goftë nga udhëheqësit e mëparshëm, goftë nga aktualët. Pastaj, dorën në zemër, u pranuan edhe fëmijë miqsh e kolegësh partiakë. Mos është ky perceptim i gabueshëm? Nëse këtu ka të vërtetë, si do ta zhdavaritnit këtë mjegullnajë?**

**FETAJI:** Themelimi i Universitetit duhej të bëhej adekuat sipas kushteve dhe ligjeve të Maqedonisë. Ne procesin e themelimit u krijuan Komisionet amë, të cilët sipas Ligjit, duhej të kalojnë dhe votohen në Parlamentin e shtetit. Komisionet amë në përbërjen e tyre kishin profesorë aktual me më eksperiencë dhe midis të cilëve edhe nga një përfaqësues nga universitetet ndërkombëtare, domethënë jashtë Maqedonisë. Dhe pasi kaluan Komisionet amë në Parlament, ato ishin përgjegjës për hapjen e konkurseve dhe pranimin e kuadrit. Puna e tyre nuk ishte aspak e lehtë dhe duke marrë parasysh të gjithë implikacionet, perceptimi im është se ato u munduan në mënyrë maksimale dhe arritën të bëjnë një punë të mirë profesionale. Sa i përket pranimin të kuadrove "fëmijë miqsh e kolegësh partiakë", perceptimi im se kjo nuk ka qenë rasti dhe se çdokush që plotëson kushtet dhe kriteriumet ligjore ka mundur të konkurrojë, dhe pranohet dhe nuk duhet të hendi kepojmë dhe diskriminohet dikush për kriteret dhe kategori joligjore, vetëm se ka dikë familjar ose ish kolegë. Te kjo çështje duhet të jemi mjaft të kujdesshëm se tani



vijmë në situata që dikush punon dhe studion dhe arrin suksese në fushën e vet profesionale me mundin e vet, mirëpo me vete faktin që mundet të ketë edhe ndonjë familjar tjetër, ose politikan, i cili gjithashtu është i suksesshëm që tani s'mundet të punon. A do të thotë kjo se atë të parin nuk guxojmë ta lëmë të konkurrojë dhe diskriminojmë e të mos lejohej të pranohet ose të punojë në atë fushë vetëm pse ka tjetër të suksesshëm në familjen e vet ose ka ndonjë të njohur? A do të thotë kjo që, nëse njëri në familje arrin suksese, atëherë të gjithë familjarët tjerë mos të merren, studiojnë dhe punojnë në këtë fushë që ka arritur familjari i parë? Sigurisht që jo. Shoqëria dhe sistemi shoqëror duhet të afrojë mundësi të barabarta të gjithëve, sidomos atyre që punojnë dhe e meritojnë dhe i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret sipas Ligjit. Nëse dikush edhe pranohet në mënyrë jo të rregullt dhe pa merita akademike dhe shkencore, ajo do të evidentohet me kohë dhe ekzistojnë mekanizma të ndryshëm përmes kriterëve për thirrje akademike dhe të tjerë që mundet të përmirësojnë edhe këto lëshime eventuale në sistem.

**KOHA: Fillimi ishte i vështirë, shumë e natyrshme. Por tani, si paraqitet situata në planin ekipor të kuadrit dhe me konsolidimin e programeve? Kur jemi këtu, ç'do na thoshit për zgjerimin e fakulteteve dhe programeve?**

**FETAJI:** Ne jemi entuziastë dhe optimist të pamasë, por edhe jemi të vetëdijshëm se kemi shumë sfida. Por, me angazhimin tonë, me mbështetjen morale të të gjithë dashamirësve të arsimit dhe me mirëkuptim për të gjithë lëshimet eventuale fillestare, ne jemi të sigurt që do t'ia dalim të jemi në nivelin e detyrës të misionit tonë të përbashkët, të mundësojmë studime cilësore dhe ambient të ngrohtë dhe miqësor universitar, dhe ky tempull i dijes ne të ardhmen të jetë gurrthemeli ynë për krijimin e gjeneratave të reja që do të udhëheqin shoqërinë tone dhe do të na bëjnë krenar.

Sa i përket momentit, plan programet dhe fakultetet pranë UNT-së, pra Universiteti Nëna Terezë ngelin në 5 Fakultet që i kishte që në fillim mirëpo shtohen drejtime studimore dhe tanimë UNT-ja ka 21 drejtime studimore së bashku si ne ciklin e parë dhe atë të dytin. Të gjitha detajet me përshkrimet dhe plan programet e drejtimeve studimore mundet të gjinden në ëeb faqen e Universitetit ne eëë.unt.edu.mk. Këtu do të përmendi vetëm drejtimet. Kështu në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës ka 3 drejtime studimore dhe atë: Arkitekture dhe Dizajn, Ndërtimtari dhe Konstruksion dhe Gjeodezi dhe





Universitetet e lartpërmendur.

Sa i përket kampusit të ri të Universitetit, duke u referuar në programin e qeverisë të publikuar në faqen zyrtare, thuhet se: "Qeveria do ta përfundojë ndërtimin e kompleksit universitar "Nënë Tereza". Kjo le të kuptohet se objekti i këtij universiteti do të përfundojë brenda 3 viteve. Lidhur me këtë ngjarje ditë më parë në emisionin "Në Fokus" u prononcua edhe Rektori i UNT-së Prof. Dr. Aziz Pollozhani, i cili ndër të tjera u shpreh se sipas bisedave që ka pasur pret që në shtator-tetor të hidhet edhe gurë-themeli i objektit të universitetit, i cili me hapësirë gjendet përballë ambasadës së Amerikës. Sa i përket kampusit të ri është me rëndësi të përmendet se ky do të jetë kampusi i parë në Maqedoni dhe në regjionin më të gjerë, i ndërtuar apostafat për nevojat specifike të çdo drejtimi mësimor dhe jo një ndërtesë e thjeshtë e cila pastaj riadaptohet për mësimdhënie siç kanë qenë rasti deri tani nëpër Universitetet. Për çdo drejtim studimor këshillat mësimor shkencorë të Fakulteteve kanë përcaktuar anëtarin e vet në grupin punues të Universitetit dhe i cili grup punues përcaktoi brenda një periudhe kohore prej mbi 2 muajsh kriteriumet dhe nevojat specifike të çdo fakulteti dhe drejtimi në veçanti sidomos specifikat laboratorike dhe ato hapësimore, si dhe përcaktimi i raportit të hapësirës me numrin e mësimdhënësve dhe studentëve që do të vijojnë mësimin sipas standardeve botërore dhe ne duke respektuar ligjet e Maqedonisë për këtë kategori të definuar në procedurat për akreditim.

Në kriteriumet e definuara vlen të përmendet midis tjerave aspekti i akustikës, ku nuk guxon në klasë të dëgjohen zhurmata nga klasa tjetër dhe nga korridorë por akustikisht duhet të jenë të izoluar dhe njeri mësimdhënës mos i pengon tjetrit gjatë ligjërimit siç ndodh tani nëpër shumë Universitete. Gjithashtu në aspekt teknik inxhinierim i teknologjive të reja, proektorëve WiFi, LCD televizorëve me "touch screen" në vend të projektorëve klasik, kablllove optik, etj. Gjithashtu kampusi është definuar të plotëson edhe kushtet për kampus të gjelbërt (green campus) me të cilin do të shfrytëzohen ujërat e shiut dhe të njëjtët do të ripërdoren, çatia do të ketë fotoqelija të cilët do të akumulojnë nxehësinë e dritës duke marrë parasysh se Shkupi ka shumë ditë me diell dhe e njëjta do të gjeneron rrymë elektrike, e cila do të përdoret për nevojat e Universitetit. Gjithashtu, krieteriumi tjetër parashikon që dizajni i ndërtesës të përfshin shumë hapësira të gjëra me dritare, me qëllim që së paku deri në ora 16h mos ketë nevojë të ndizen dritat. Pra nëse çdo gjë shkon sipas planifikimeve dhe parapërgatitjeve të realizuara do të kemi një kampus të sofistikuar të hapësira e të cilit është parashikuar që 70% të ngel hapësirë e gjelbër, në të cilën do të përfshihen edhe hapësira të gjelbërta, terrene sporti, dhe gazibo-hapësira në të cilët studentët do të mblidhen gjatë pushimeve të diskutojnë dhe pse jo të debatojnë siç edhe janë shfrytëzuar në të kaluarën në Universitet me prestigjioze të botës.

**KOHA: Lexojmë se po ballafaqohen edhe me hapësirat e përshtatshme. Kur pritet që UNT ta ketë shtëpinë e vet?**

**FETAJI:** Për momentin, Universiteti "Nënë Tereza" zhvillon mësimin në 3 objekte dhe atë në ndërtesën e mëparshme të Universiteti të Tetovës, në Shkup afër përmendores së Skënderbeut, në Hapësirat e UEJL-së, në Shkup si dhe në ndërtesën e sindikatave të Maqedonisë në qendër të Shkupit afër parlamentit. Këto hapësira janë të përshtatshme për vijimin e mësimin duke marrë parasysh se në disa objekte edhe deri tani ne mbi 10 vitet e fundit mësim kanë mbajtur 2

**vendit, keni lidhur marrëveshje bashkëpunimi? Aq më tepër kur ju jeni pa përvojën e mjaftueshme si institucion?**

**FETAJI:** Bashkëpunimi është gjithsesi komponentë më e rëndësishme dhe këtu duhet potencuar sidomos me Universitet tjera në gjuhën Shqipe. Bashkëpunimi përfshin moduse të ndryshme duke filluar nga mobiliteti i stafit akademik, d.m.th ndihma njëri tjetrit me kuadrot mësimorë, pastaj mobiliteti i studentëve duke mundësuar kështu edhe plotësimin e një prej kushteve esenciale të Bolonjës, pastaj bashkëpunimin në konkurrim në projektet e ndryshme shkencore dhe ato industriale, te bashkimit evropian dhe projekteve rajonale ku kërkohet që çdo Universitet të jetë pjesë e ndonjë rrjeti të Universiteteve lokale dhe ndërkombëtare. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka lidhur Universiteti "Nënë Tereza" që tani është mjaft e madhe. Në këtë aspekt Universiteti "Nënë Tereza" ka lidhur bashkëpunim me shumicën e Universiteteve shqipfolëse sidomos Universiteteve të Kosovës dhe Shqipërisë dhe sidomos ato të vendit, Universitetin e Evropës Juglindore dhe Universitetin e Tetovës-në të cilët gjatë tërë kohës edhe i kanë ndihmuar Universiteti "Nënë Tereza" në aspekte të ndryshme si duke i afruar hapësirat e veta mësimore ashtu edhe duke i ofruar ndihmë në konsolidimin e kuadrit. Gjithashtu UNT-ja ka lidhur bashkëpunim edhe me Universitetin e Shtipit dhe atë të Manastirit, të cilët edhe i kanë huazuar edhe shumë softuere të tyre për menaxhimin e serviseve studentore dhe ato organizative, sidomos këtu vlen të përmendet e-indeksi i Universiteti të Shtipit, i cili tanimë është përkthyer edhe në gjuhën shqipe, dhe prej këtij viti akademik të ri do të përdoret në UNT. Gjithashtu, Universiteti "Nënë Tereza" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë Universitete të Turqisë dhe në vijim janë diskutime në lidhje me bashkëpunime të reja me Universitete tjera të Evropës dhe të Shteteve të Bashkuar të Amerikës. Universiteti "Nënë Tereza" në planin e vet strategjik e ka të parashikuar që 4 vitet e para të krijon një rrjet të gjerë rajonale dhe ndërkombëtare dhe sidomos për këtë qëllim trajnon stafin vet, dhe kërkon nga çdo anëtar i stafit të konkurron në programin www.cost.eu të bashkimit evropian, program ky i cili mundëson krijimin e rrjeteve të shkencëtareve nëpër fusha të ndryshme duke bashkëpunuar në krijime të ideve të përbashkëta për projekte hulumtuese shkencore.

**KOHA: Gjatë studimeve, por edhe detyra e punës ju ka dërguar në Shqipëri, Serbi, Greqi, Angli, Austri, Japoni, etj. Cila është përvoja juaj dhe cili është thelbi i funksionimit të sistemit arsimor, në këto shtete?**

**FETAJI:** Po unë studimet kam vijuar dhe mbaruar në Angli në vitin 2003 dhe 2004. Saktësisht në Universitetin Oxford Brookes, në Oxford, studimet e Magjistraturës në shkencat kompjuterike. Sistemi i edukimit në Angli është ndryshe dhe në vend se në semestra zhvillohej në terme dhe brenda një viti akademik ka 4 terme, ose siç u referohemi ne 4 semestra. Lëndëve u referohen si module dhe ka parakushte të caktuara për të hyrë ose zgjedhur disa lëndë studimi. Studimet modulare të tilla si sistem edukimi kanë



një përparësi për shkak se në fund përmes lëndëve zgjedhore studenti përcakton ekspertizën e vet duke zgjedhur lëndët përkatëse në termet/semestrat përkatës. Domethënë nëse në fillim ai zgjedh një lëndë zgjedhore atëherë mundet ti vijon dhe zgjedh vetëm lëndët modulare që janë në atë vijë dhe që në fund mbarojnë në 2 drejtime (ekspertiza) të përafërta dhe më vonë ngushtohen në vetëm një një ekspertize.

Kam qenë edhe në shtetet e bashkuar të Amerikës përkatësisht përmes një bashkëpunimi me Universitetin e Indianës dhe Purdue në Indianapolis (IUPUI) përfunduar një kurs online dhe me vonë edhe vizituar kampusin dhe vijuar edhe disa ligjërata atje në suaza të marrëveshjes që kishte Universiteti i Evropës Juglindore me IUPUI. Në SHBA sistemi i edukimit kishte disa specifika të veta jo vetëm në sistemet e krediteve të cilët sipas meje ishin më mirë të definuar se ato në Evropë sipas Bolonjës, por edhe fakti që afrohej sistemi i edukimit i bazuar në "mayor/minor" që më së miri e kisha përkthyer si studime "primare/sekundare". Këtu në princip studentët 2/3 e kohës studiojnë fushën primare të tyre ndërse 1/3 e kohës studiojnë fushën sekondare që kanë mundësi ta zgjedhin dhe kjo u jepte një qasje në aspekte të shumta me rëndësi multidisiplinare, e cila mjaft vlerësohej në SHBA. Për shembull mundësohej të studioje Informatikën si primare dhe Mjekësinë si sekondare dhe në fund merr diplomën e Bio-Informatikës që nënkupton informatikan (shkenca kompjuterike) i cili ka shkathtësi në aplikimin e informatikës në mjekësi, drejtim ky që me sukses i ngërthente të dy drejtimet. Mirëpo mundej të ndodhe edhe e kundërta primare të ketë Mjekësinë dhe sekondare t'i zgjedh Informatikën. Me këtë rast ai merr diplomën "Clinical Informatics" (Informatika Klinike) dhe konsiderohet si Mjek, i cili ka shkathtësi informatike specifike (shembull mundet të operon pacientet duke përdorur sistem softuerik specifik) Derisa në Austri ku isha në studimet e doktoraturës në vitin 2004-2008, saktësisht në Universitetin Teknik në Grac, Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, sistemi i edukimit ishte ndryshe dhe sipas Bolonjës. Këtu kushtohej një dallim i veçantë disa kategorive siç janë provimet, projektet praktike dhe hulumtimet shkencorë të cilët ishin të inkuorporuar thellë në sistemin e edukimit. Një gërshetim i tillë dhe kontaktet e shumta me industrinë për të realizuar pjesën praktike dhe angazhimi i studentëve në projekte hulumtuese të shumta të Universitetit për të mësuar dhe vlerësuar hulumtimin përmes punimeve shkencore që kanë

realizuar ishte një model mjaft i mirë dhe njëkohësisht mjaft sfidues. Gjatë vitit 2009, një muaji isha si Profesor vizitues në studimet e Magjistraturës në Japoni, pranë Universitetit të Tokios për Agrikulturë dhe Teknologji, Fakultetin e Shkencave Kompjuterike. Këtu sistemi i edukimit ishte paksa ndryshe nga ajo në Evropë dhe viti shkollor fillonte në Prill dhe mbaronte vitin tjetër në Mars.

**KOHA: Nëse ne do të bënim të gjitha gjërat të cilat jemi të aftë t'i bëjmë, do të mahnitim veten me kuptimin e plotë të fjalës?**

**FETAJI:** Jam i mendimit se në jetë ne kemi aq kohë dhe fuqi sa të mbarojmë vetëm disa gjëra që do ti përcaktojmë më me rëndësi dhe nuk duhet të zgjerohemi në shumë aspekte por të zgjedhim dhe fokusohemi në disa qëllime konkrete, se edhe kohën që e kemi në disponim kalon shpejtë, sidomos duke u munduar të mbajmë një balans në relacionin punë-familje, gjë e cila sipas meje është mjaft rëndë të balancohet, sidomos në kushtet tona shoqërore aktuale në Maqedoni.

**KOHA: Të udhëheqësh familjen më mirë, apo një institucion arsimor?**

**FETAJI:** Në praktikë shpesh të imponuar nga dinamika e jetës dhe vëllimi i madh i punëve harrojmë dhe më së tepërmi i kushtojmë vëmendje punës, dhe në rastin tim më shumë vëmendje i kam kushtuar institucionit arsimor ku jam, Universitetit "Nënë Tereza". Të udhëheqësh me familjen e konsideroj të shenjtë dhe një nder. Udhëheqja e një institucioni arsimor normalisht si edhe në familje është punë e ekipore mirëpo mjaft më sfiduese në aspekte të ndryshme dhe kërkon koordinim më të madh në mes një grupi më të gjerë njerëzish si drejtoreshë të administratës, dekanëve, prorektorëve dhe rektorit.

Udhëqehja e institucioneve arsimore shpesh në vete nënkupton edhe sfida të dimensioneve të ndryshme për shkak vëllimit, multidisiplinartetit dhe dinamikës së punëve dhe një numrit të madh të njerëzve të kyçur në proces dhe në fund për çdo punë të kryer me mjaft mund jo çdo herë do të kesh përkrahjen dhe faleminderimin e të tjerëve. Por ka satisfaksionin e vet kur kryen një punë me sukses dhe sidomos kur për këtë merr edhe përgëzimin nga kolegët, respektin dhe vlerësimin pozitiv. Duke vënë së bashku "Familjen" dhe "punën" është me të vërtetë një sfidë që ia vlen për të reflektuar mbi mënyrën tonë të jetës, vlerat që na shoqërojnë në jetën e përditshme, dhe balancimit të të cilëve duhet dhënë kujdes i veçantë.





Në deklaratën e 5 ambasadave të vendeve perëndimore në Prishtinë theksohet se, "është përgjegjësi e udhëheqësve të Kosovës formimi i këtyre institucioneve, por edhe për të bërë reforma të domosdoshme për parandalimin e një bllokade të tillë në të ardhmen"

**Përfaqësuesit e ambasadave të Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara kanë thënë se janë të shqetësuar me gjendjen e krijuar në Kosovë, si pasojë e moszgjdhjes së institucioneve të reja**

Kuinti dhe SHBA u kërkojnë liderëve të Kosovës të tejkalojnë dallimet

# Kosova ende pa udhëheqje, shqetësohen ndërkombëtarët

Kuvendi i Kosovës u mblodh për të katërtën herë radhazi në përpjekje për të zgjedhur udhëheqjen e re. Në sallën e Kuvendit, sërish nuk ishin të pranishëm deputetët e koalicionit të Partisë Demokratike të Kosovës, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës, si dhe ata të komuniteteve pakicë. Kryesuesi i Kuvendit të Kosovës, deputeti Adem Mikullovc, që në fillim ka thënë se në mungesë të deputetëve do të shkohohej në një pushim prej 15 minutash. Pas pushimit, deputeti Mikullovc i thirri përfaqësuesit e partive politike në një takim konsultativ të mërkurën në orën 10:00. Pa zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit nuk do të mund të vazhdohej me asnjë procedurë tjetër rreth formimit të institucioneve. Pas ndërprerjes së seancës konstituive, Partia Demokratike e Kosovës ka mbajtur një konferencë për media ku ka kritikuar kryesuesin e seancës, Adem Mikullovc, për siç është thënë keqpërdorim të foltores. Besim Beqaj, anëtar i kryesisë së PDK-së tha se në seancën kon-



stituive nuk mund të procedohej pa prezencën e koalicionit fitues të zgjedhjeve dhe pa prezencën e numrit të duhur të deputetëve. Ai tha se "PDK-ja konsideron se është një abuzim i pa precedentë i foltores dhe shkelje e normave kushtetuese, sepse dihen rregullat e qarta se si mbahen seancat e Kuvendit". "Koalicioni PAN nuk është bllokues, mandatar ka nevojë për konsulta shtesë, ne do t'i themelojmë institucionet shumë shpejtë. Dhe të gjithë ata që po performojnë një jo-kushtetueshmëri, po përformojnë një abuzim dhe po

krijojnë veprime pa precedent", tha Beqaj. Në asnjë normë kushtetuese, shtoi Beqaj, nuk do të lejohen veprime të tilla. Ai ka konfirmuar se në takim konsultativ të thirrur për të mërkurën nga kryesuesi Mikullovc, përfaqësuesit e PAN-it do të jenë të pranishëm. Përfaqësuesit e ambasadave të Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara kanë thënë se janë të shqetësuar me gjendjen e krijuar në Kosovë, si pasojë e moszgjdhjes së institucioneve të reja. "Ne jemi të shqetësuar për situatën politike që po vazh-

don në Kosovë", thuhet në deklaratë. Në deklaratën e 5 ambasadave të vendeve perëndimore në Prishtinë theksohet se, "është përgjegjësi e udhëheqësve të Kosovës formimi i këtyre institucioneve, por edhe për të bërë reforma të domosdoshme për parandalimin e një bllokade të tillë në të ardhmen". "Kosova ballafaqohet me shumë sfida në periudhë afatmesme dhe afatgjatë, përfshirë programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, situatën energjetike, por po ashtu edhe nevojën për zhvillim ekonomik, forcim të sundimit të ligjit, perspektivën

## GJURIQ: LISTA SRSPKA ËSHTË PROJEKT KOMBËTAR ME RËNDËSI PËR SERBINË

Në Beograd, në një mbledhje të ftuar nga Marko Gjuriq, kanë marrë pjesë përfaqësues të komunave me shumicë serbe nga Kosova si dhe zyrtarë të Listës Srpska. Ata, transmeton Koha.net, kanë biseduar rreth zgjedhjeve lokale në Kosovës që do të mbahen më 22 tetor. "Lista Srpska është projekt politik me rëndësi kombëtare për Serbinë dhe popullin serb në Kosovë dhe për këtë arsye në zgjedhjet lokale të 22 tetorit vendimtare do të jetë që ajo, me përkrahje të institucioneve të Serbisë, të dalë me kandidatë që në secilin nga 10 komunat me shumicë serbe ta tubojë popullin", citon tanjug të ketë thënë drejtori i të ashtuquajturës Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë Marko Gjuriq pas takimit me përfaqësuesit e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Ai ka kërkuar unitet të kësaj liste. Sipas fjalëve të tij, në takim është kërkuar lista Srpska të dalë me kandidatët më të mirë për kryetar komunash. "Shteti i Serbisë do të vazhdojë të përkrahë organizmin politik të serbëve në Kosovë, të përkrahë përpjekjet e përfaqësuesve serbë që të kenë sa më shumë hise në institucione, në të gjitha format e jetës shoqërore, pasi nga ato varet ekzistenca e jonë në Kosovë", ka thënë Gjuriq. Kryetari i Listës Srpska Goran Rakiq ka thënë se kjo listë është e vetmja parti që tubon serbët, që Serbinë e ka në zemër dhe që jetën më të mirë të serbëve në Kosovë e ka në vend të parë.

evropiane dhe raportet e Kosovës me Serbinë", thuhet në deklaratë. Më tej shtohet se "është e rëndësishme që deputetët e zgjedhur në Kuvendin e Kosovës të marrin pjesë në seancat e Kuvendit dhe të lejojnë që ai të fillojë punën e vet".

## Mafiozët italianë po vriten për drogën shqiptare

Kryeprokurori i Antimafies italiane, Franco Roberti, deklaroi se mafiozët italianë po vriten me njëri-tjetrin për shkak të "lumenjve të hashashit" që trafikohen nga Shqipëria. Zyrtari i lartë i Drejtësisë në Itali, vrasjen e tmerrshme të ndodhur në Foggia të Italisë, e ka lidhur, veç të tjerash, edhe me trafikun e drogës nga Shqipëria. "Konflikti është ndezur rreth trafikut të drogës, sidomos të drogave të lehta që vijnë nga Shqipëria. Një biznes kolosal që ushqen oteksin e klaneve dhe që përfshin gjithë bregun e Adriatikut, nisur nga ai foxhian deri në Evropë", deklaroi kreu i Prokurorisë së Antimafies italiane, Franco Roberti. Ai ka thënë se në luftën ndaj trafikut të drogës, të dyja vendet duhet të bëjnë më tepër. "Duhet bërë më shumë, edhe në planin e



bashkëpunimit ndërkombëtar për të ndaluar lumin e drogave të lehta që vijnë nga Shqipëria, sepse janë pikërisht ato që çojnë në shpërthimin e konflikteve", ka thënë më tej kryeprokurori italian i Antimafies. Ai ka bërë me dije se ka zhvilluar takime konkrete me zyrtarët e Shqipërisë në lidhje me nevojën e hetimeve të përbashkëta dhe të goditjes së

fenomenit të trafikut të drogës, shkruan Panorama. "Ishim në Shqipëri muajin e kaluar për të kërkuar bashkëpunim, takuam në Romë ministrin e Brendshëm shqiptar, që premtoi bashkëpunim më të madh. Duhet të fitojmë mbi omertan dhe për ta bërë këtë, duhet krijuar një kulturë e ligjshmërisë që në atë territor është ende periferik", theksoi më tej kryeprokurori italian i Antimafies, në një intervistë të dhënë për "Rai Uno". Sipas Robertit, përplasjet mes klaneve në Pulia vijojnë prej 30 vjetësh me një bilanc prej 300 vrasjesh, nga të cilat 80% kanë mbetur pa u zbuluar. Shkaku i zgjimit të kësaj lufte të egër, duket se vjen nga Shqipëria, pasi sipas autoriteteve italiane bëhet fjalë për sasi të mëdha të kanabisit që mbërrijnë në brigjet italiane nga Shqipëria.

## Nis seminari për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

Drejtori i Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Rrahman Paçarizi, tha se e veçanta e këtij viti është se ka pasur një interesim të madh të brezave të mërgatës për të qenë pjesë e seminarit. Ai këto komente i bëri me rastin e hapjes së seminarit 36 për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Universitetin e Prishtinës, ku ishin të pranishëm përfaqësues universitarë, albanologë dhe studentë nga vende të ndryshme të botës, të cilët gjatë dy javëve do ta mësojnë gjuhën shqipe përmes kurseve intensive. Paçarizi është shprehur se fatkeqësisht nuk ka kapacitet për të përmbushur kërkesat e gjithë atyre që dëshirojnë të jenë pjesë e programit. "Ju ftojme ta mësoni letërsinë shqipe dhe ta mësoni kulturën shqipe", u shpreh ai. Ministri në detyrë i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami është shprehur se është obligim i Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës që të përkrahin albanologët. "Ky seminar do të ndikojë në internacionalizimin e albanologjisë", tha ai. Nita Rugova, dekan e Fakultetit Filologjik, u shpreh se e tërë Prishtina i gëzohet ardhjes së seminaristëve

të huaj. "Ky seminar është një rrugëtim i vështirë në kërkim të zhvillimit akademik, një tubim i lartë shoqëror që ka arritur të bëhet institucion. Dhjetëra studentë i kemi shkëmbyer falë këtij seminarit", tha ajo. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është themeluar në vitin 1974 pranë Fakultetit të Filologjisë (atëherë: Fakulteti Filozofik) të Universitetit të Prishtinës. Ky Seminar organizohet për studentë e studiues që merren me probleme të gjuhës, të letërsisë e të kulturës shqiptare, po edhe me albanologjinë përgjithësisht. Seminari ka zhvilluar gjithsej tridhjetë e pesë sesione. Në vitin 1991 është ndërprerë veprimtaria e tij nga organet e dhunshme serbe. Në vitet 1995 e 1996 sesionet e këtij Seminarit u mbajtën në Tiranë në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Nga viti 2000 Seminari zhvillohet sërish në Prishtinë. Sesionet 19 dhe 20 (2000-2001) janë organizuar në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

## Arrestohen dy kosovarë të dyshuar se kanë dashur tu bashkohen ekstremistëve

Autoritetet në Kosovë thonë se i kanë arrestuar dy persona të dyshuar se janë përpjekur të bashkohen grupeve ekstremiste në Siri dhe Irak. Një gjykatë në Prishtinë i ka akuzuar ata me përpjekje për bashkim me grupet islamike në konfliktin e armato-

sur dhe dje ka urdhëruar paraburgim në kohëzgjatje prej një muaji. Në një kumtesë të qeverisë theksohet se të dyshuarit, të identifikuar vetëm me iniciale A.D. dhe K.B., kishin provuar të kalojnë në Siri nga Turqia, ku ishin zënë nga forcat turke, rapor-

ton agjencia AP. Ata janë kthyer nga Stambolli në Kosovë. Nëse shpallen fajtorë, ata mund të dënohet deri në 15 vjet burg. Autoritetet në Kosovë thonë se afro 70 shtetas konsiderohet se luftojnë për grupet ekstremiste në Siri dhe Irak





I akuzuari për vrasjen në Virxhinia paraqitet në gjykatë

# Dhuna në Virxhinia, Shtëpia e Bardhë mbron Trumpin

Në një koment pas zhurmës së madhe, Shtëpia e Bardhë tha se Presidenti Donald Trump dënoi shumë ashpër çdo formë dhune, urrejtjeje dhe paragjykimimi dhe sigurisht që këtu përfshihen supremacistët e bardhë, Ku Klux Klan, neonazistët dhe çdo grup ekstremist



Shtëpia e Bardhë mbrojti reagimin e Donald Trump ndaj dhunës vdekjeprurëse në një miting supremacistësh të bardhë në Virxhinia, ndërsa shtohen gjithnjë e më shumë kritikata se Presidenti nuk dënoi qartësisht grupet e ekstremit të djathtë. Trump dënoi dhunën, por nuk përmendi me emra grupet raciste, diçka që vajza e tij Ivanka Trump e bëri shumë më mirë, duke thënë se nuk ka vend në shoqëri për racizimin, supremacinë e bardhë dhe neonazistët. Në një koment pas zhurmës së madhe, Shtëpia e Bardhë tha se Presidenti Donald Trump dënoi shumë ashpër çdo formë dhune, urrejtjeje dhe

paragjykimimi dhe sigurisht që këtu përfshihen supremacistët e bardhë, Ku Klux Klan, neonazistët dhe çdo grup ekstremist. Nuk duket që kjo të ketë bindur shumë njerëz, pasi Trump vazhdon të jetë objektiv i kritikave, pavarësisht se çfarë zgjedh të bëjë. Gjithçka nisi pas përleshjeve të dhunshme gjatë mitingut të supremacistëve të bardhë në Sharlottesville me protestuesit, ndërsa dhuna arriti kulmin kur një makinë u vërsul drejt këtyre të fundit, duke vrarë një person dhe plagosur shumë të tjerë.

Situata vazhdon të jetë e tensionuar në qytet dhe kjo u pa mjaft qartë kur turma e zemëruar dëboi një nga organizuesit e mitingut që po përpiqej të mbante një fjalim pas dhunës. Jason Kessler, një prej supremacistëve të bardhë, fajësoi policinë për dhunën, por reagimi i njerëzve të pranishëm tregoi qartë se askush nuk i beson përrallave të një racisti si ai. Personi i akuzuar për sulm me makinën e tij në turmën e protestuesve, që demonstron kundër aktivistëve të së djathtës ek-

streme në shtetin Virxhinia në Shtetet e Bashkuara, pritët të paraqitet në gjykatë. Personi, James Alex Fields, 20 vjeçar, është i akuzuar për vrasje të shkallës së dytë, pasi një femër është vrarë dhe 19 persona të tjerë janë plagosur, gjatë sulmit me automobil para dy ditësh. Një këshilltar i presidenti amerikan, Donald Trump, ka vlerësuar se ky sulm "e plotëson definicionin e terrorizmit". Autoritetet federale amerikane thonë se kanë hapur hetime për të drejtat civile lidhur me rrethanat që ndikuan që i akuzuari Fields t'i qëlloj me makinë njerëzit në qytetin Sharllotsvill në Virxhinia. Femra e vrarë ishte Heather Heyer, 32 vjeçare, punëtore në fushë të drejtësisë, e cila nga të njohurit e saj ishte përshkruar si aktiviste për të drejtën sociale. "Në çfarëdo kohe, që ju kryeni sulm kundër njerëzve për të shkaktuar frikë, është terrorizëm", tha H.R. McMaster, këshilltar për siguri kombëtare i presidentit Trump, lidhur me sulmin në Sharllotsvill, gjatë një interviste në rrjetin ABC.

## Dhjetëra të vdekur pas një sulmi terrorist në Burkina Faso



Pas një shkëmbimi zjarri në kryeqytetin e Burkina Fasos janë vrarë mjaft vetë. Xhihadistët kishin sulmuar me armë automatike një restorant në qytet, e ishin fshehur më pas aty

Pas një sulmi natën ndaj restorantit Kafe Stambolli në Ouagadougou të Burkina Fasos janë vrarë sipas të dhënave zyrtare të paktën 20 vetë. Mes tyre edhe dy terroristët. Mes viktimave ndodhet edhe një qytetar turk. Mjaft vetë u plagosën. Autoritetet njoftojnë se gjendja është nën kontroll. Të panjohur kishin sulmuar të dielën në orët e vona një restorant me armë automatike. Sipas të dhënave të dëshmitarëve tre persona kishin zbritur nga një makinë dhe kishin hapur zjarr ndaj klientëve në restorant. Sulmuesit ishin fshehur më pas në restorant dhe kishin marrë klientët peng. Qeveria gjermane e ka dënuar aktin. Nga Ministria e Jashtme në Berlin bëhet e ditur, se kjo tregon se gjendja e sigurisë dhe stanblitetit në rajon është mjaft e rrezikuar. "Duhet të pengohet përhapja e terrorizmit në rajonin Sahel dhe Afrikën Perëndimore", thuhet në Berlin. Edhe presidenti francez e dënoi aktin duke e kategorizuar si "sulm terrorist". Franca bën të ditur se do të qëndrojë krah vendeve në rajon për të luftuar kundër grupimeve terroriste.

## Djali i Maduros kërcënon Trumpin

Nicolas Maduro Guerra, djali i presidentit të Venezuelës, kërcënoi se do të marrë Shtëpinë e Bardhë me armë, nëse Donald Trump dërgon ushtrinë në vendin e tij. Shtëpia e Bardhë e ka dënuar regjimin e presidentit Nicolas Maduro për shkelje të të drejtave të njeriut, diçka që konfirmohet edhe nga më

shumë se 120 të vrarët në protesta që prej prillit. I pyetur nga mediat se çdo të bëhet me Venezuelën, Trump tha se atje njerëzit po vuajnë dhe po vdesin, prandaj nuk ka përjashtuar opsionin ushtarak. Kjo shkaktoi reagimin e mjaft politikanëve në Venezuelë, mes të cilëve ra në sy

kërcënimi i djalit të Maduros, megjithëse ky i fundit duket se nuk e di ku është Shtëpia e Bardhë. "Nëse dhunohet atdheu ynë, pushkët do të mbërrijnë në Nju Jork. Z. Trump, ne do të vijmë dhe do të marrim Shtëpinë e Bardhë", u shpreh Nicolas Maduro Guerra. Administrata Trump vendosi

sanksione ndaj Venezuelës pasi presidenti Maduro zëvendësoi Parlamentin e kontrolluar nga opozita me asamblenë e tij kushtetuese. Protestat që prej muajsh vazhdojnë në Venezuelë janë ashpërsuar ndjeshëm pas kësaj lëvizje të Maduros, duke zhytur vendin latin gjithnjë e më shumë në kaos.

## Gjatë pelegrinazhit të Haxhit në Arabinë Saudite 31 të vdekur

Të paktën 31 persona kanë vdekur të dielën në mbrëmje, gjatë pelegrinazhit të Haxhit në Arabinë Saudite, transmeton agjencia Anadolu. Agjencia saudite e lajmeve SPA, raportoi se të gjithë pelegrinët e ndërë janë shtetas të huaj, por deri më tani nuk ka zbuluar shkaqet e vdekjes së tyre. Haxhi është një nga detyrimet themelore fetare të myslimanëve, për çka këtë vit në Mekë dhe Medinë pritët ardhja e mbi dy milionë pelegrinëve. SPA raporton se në Arabinë Saudite tashmë kanë arritur të paktën 620 mijë pelegrinë.

## Vendet ish-socialiste me jetëgjatësinë më të shkurtër në Evropë

Evropa meriton emërtimin "Kontinenti i Vjetër" pasi ka një popullsi me moshë mesatare më të madhe se kontinentet e tjera. Sot në Evropë ka rreth 32 milionë pensionistë për çdo 100 punëtorë të moshës 20-64 vjeç, pra rreth tre punëtorë për një pensionist. Ky raport pritët të bjerë në dy punëtorë për një pensionist në mesin e shekullit të XXI. Studimi thekson se sidomos Evropa Jugore kombinon shpopullimin me plakjen e popullsisë. Në vende të tilla si

Greqia dhe Italia, ka një numër në rritje të atyre që lënë në tregun e punës për të dalë në pension, se të rinjtë që hyjnë në tregun e punës. Një seri faktorësh sociale, ekonomike dhe psikologjike kombinohen për të nxitur çiftet sidomos në Evropën Jugore që të mos kenë shumë fëmijë si më parë: të ardhura më pak të disponueshme, liri personale, dëshira për të ndjekur karrierën profesionale, norma të larta të divorcit, çmizim të

martesës dhe familjes. Italia është vendi në Evropë ku gratë kanë moshën mesatare më të lartë, fëmijën e parë e lindin pothuajse në 31 vjeç. Në vende si Spanja çiftet e reja nuk mund të përballojnë krijimin familjes dhe të kenë një fëmijë para moshës 30 vjeç. Në bazë të analizave të EUROSTAT-it, vlerësohet se të paktën dy të tretat e vendeve evropiane do të kërkojnë kontributin e emigrantëve nga vendet jo-evropiane për të siguruar stabilitetin

demografik në Evropë deri në vitin 2050. Në aspektin e jetëgjatësisë ka një ndarje mes Evropës Lindore dhe asaj Veriore. Evropianët me jetëgjatësi më të madhe jetojnë në Italinë veriore, në veri të Spanjës, në rajonet bregdetare të Francës, dhe zona të Zvicrës dhe Norvegjisë. Më jetëshkurtër janë njerëzit në Evropën Lindore, vendet ish-socialiste, ku normën më të ulët e kanë Lituania dhe Bullgaria.

## Australi, kërkohet heqja e sekretit rreth abuzimeve të priftërinjve me fëmijët

Klerikët katolikë duhet të përballen me padi kriminale nëse nuk raportojnë abuzimet seksuale që i tregohen atyre gjatë rrëfimit. Ky është rekomandimi i një paneli në Australi dhe përfshihet mes 85 propozimeve të reja pas një hetimi 4-vjeçar për abuzimin institucional në vend. Anë-

tarët e panelit thanë se gjatë punës së tyre dëgjuan histori të frikshme abuzimi që nuk iu raportuan kurrë autoriteteve përkatëse. Komisioni Mbretëror për Reagimin Institucional ndaj Abuzimit Seksual të Fëmijëve e nisi punën e tij në vitin 2013 dhe dëgjoji dëshmitë e mijëra viktimave.

Sipas komisionit, propozimet e tij do t'i kalojnë tashmë ligjvënësve. Anëtarët e komisionit thanë se në shumë raste, priftërinjtë pedofilë treguan gjatë rrëfimit se çfarë kishin bërë, duke e ditur se sekretit i tyre nuk do t'i shkonte policisë. Gjatë hetimit, komisioni zbuloi se 7% e

priftërinjve katolikë të Australisë abuzuan me mijëra fëmijë gjatë viteve 1950 deri në 2010. Propozime të tjera të komisionit përfshijnë ndryshimin e teknikave të policisë për marrjen në pyetje si dhe metoda për të pakësuar traumën e viktimave gjatë dhënies së dëshmitë.





Sot shpërndarja e shumë mallrave - vaj, sheqer, kafe, oriz dhe letrës higjienike - menaxhohet nga një ushtarak në kuadër të planit "Rubro por rubro"

Vendi latinoamerikan nuk arrin të dalë nga kriza, edhe pse qeveri dhe opozitë e deformatojnë realitetin boll që të sigurojnë një avantazh politik

Nga Natalia VIANA

# Askush nuk e di se çfarë po ndodh në Venezuelë!



Me 5 qershor të 2017 venezuelianët janë zgjuar me të njëjtin president, siç ndodh qysh kur Nicolás Maduro ka marrë stafetën e Hugo Chávez në 2013. Për shumë manifestues që gjatë dy muajve të mëparshëm kishin mbushur sheshet në qytete të ndryshme të vendit ka qenë një zhgënjim tjetër. Kishin qarkulluar zëra, të amplifikuara nga mesazhe në WhatsApp, sipas të cilave një ditë më parë Maduro ishte larguar nga vendi. Ky episod, bashkë me shumë të tjerë, demonstroi se gjithçka ndodh në Venezuelë është shënuar nga dizinformimi dhe nga lajme false të përhapura nga simpatizantë të qeverisë dhe të opozitës. Në politikën venezueliane gjithçka është spektakël. Kështu që harrojmë gjërat që kenë lexuar gjatë këtyre muajve: Venezuela nuk po përjeton një katastrofë humanitare prej mungesës së mallrave ushqimorë; qeveria e Maduro nuk është duke rënë; policia nuk po masakron manifestuesit nëpër rrugë. Por nuk është as e vërtetë që gjithçka ecën mirë dhe se protestat e dhuna që e shoqëron janë krijuar nga "terroristë" të armatosur, siç thonë mbështetësit e qeverisë. Ky raportazh është frut i 3 javëve të kaluara duke dëgjuar atë që thonë venezuelianët dhe udhëheqësit e tyre.

Sapo arrijmë në karakas, asistojmë në një protestë të opozitës në zonën lindore të qytetit. Manifestime si ky e tronditin kryeqytetin qysh nga fillimet e prillit, me një ritëm prej të paktën një çdo dy ditë. Në rrugët kryesore qëndrojnë makina të blinduara dhe shikohen radhë të gjata agjentësh të policisë kombëtare bolivariene me armë të kalibrit të rëndë. Edhe ushtarët e ushtrisë, me uniformat e tyre ngjyrë ulliri, zënë cepat e rrugëve dhe vendet më të përshtatshme për të frikësuar manifestuesit potencialë. Shumë rrugë që të çojnë në vendet e protestave janë bllokuar. Manifestimet ndjekin një skemë fikse: në sheshin Altamira, në një lagje të banuar nga shtrësa e mesme, zotëri dhe zonja bionde që mbajnë veshur kapelet karakteristike me ngjyrat e Venezuelës flasin ndërsa studentët nga universiteti të ndryshme - si Universidad Central de Caracas, Universidad Metropolitana dhe Universidad Santa María - parakalojnë duke mbajtur postera dhe tabela me mesazhe kundër Maduro, duke e akuzuar se është diktator. Disa nxjerrin nga çantat e shpinës "armët e luftës": kaska, bluza të zeza që përdorin për të mbuluar

fytyrën, maskat antigaz, doreza të trasha, mburoja druri të prera me kujdes. Ka shumë të rinj midis 16 dhe 25 vjeçeve që gjejnë në këto kontestime një mënyrë shprehjeje të dëshirës së tyre për ndryshim. Gjatë manifestimeve sulmojnë banka dhe dyqane. Mbajnë me vete gurë dhe përdorin doreza të trasha për të kthyer mbrapsht gazin lot-sjellës të qëlluar nga policia; disa lëshojnë bomba molotov apo artizanale kundër policëve. Përsëriten si heronj nga opozita. Asgjë nga kjo nuk përbën risi në Venezuelë. Slogani "calle, calle, calle" (rrugë, rrugë, rrugë) përdoret nga liderë të ndryshëm të opozitës, me energji më të lartë apo më të ulët, nga viti 1998, kur Hugo Chávez u zgjodh president. Protestat, bojkotimet dhe grevat kanë qenë të shumta sa që është e lehtë mos ti mbash mend sa. Në shumë raste manifestuesit janë mbështetur nga Shtetet e Bashkuara nëpërmjet financimeve të Agjencisë për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID). Pas vdekjes së Chávez në 2013, ka pasur të paktën 3 valë protestash. Manifestuesit sigurojnë se kësaj radhe është hera e mirë për ta rrëzuar qeverinë. "Do të vazhdojmë të manifestojmë. Tashmë nuk ka më asnjëri në këtë vend që e do këtë regjim", na thotë 23 vjeçari Alejandro Ferrero, që mban veshur një kasko me ngjyrat e flamurit venezuelian. Prej prillit janë arrestuar më shumë se 2800 manifestues. Më shumë se 200 janë ende në burg.

## PARLAMENT I PRIVUAR NGA AUTORITETI

Motivi i valës së fundit të protestave gjendet në një ndërtesë të bardhë në qendër të Karakasit, ku punon apo duhet të punojë parlamenti, duke qenë se në gushtin e 2016 Gjykata Supreme e ka zhveshur nga autoriteti dhe qysh

atëherë asnjëri nuk e di mirë sesi ta nxjerrë nga kjo situatë. Një fat i trishtuar, por shumë venezuelian, për një parlament që nga dhjetori i 2015, kur është rinovuar, kontrollohet nga opozita, pasi ka qenë për 16 vjet në duart e chavistëve. Partitë opozitare që janë pjesë e Mesa de Unidad Democrática (MUD) kanë fituar shumicën prej 2/3 të vendeve dhe kjo i ka mundësuar që të miratojnë ligje që shkojnë kundër zgjedhjeve kryesore politike të qeverisë dhe të kenë fjalën e fundit lidhur me huat ndërkombëtare apo mbi bilancin shtetëror. Ditën e betimit të parlamentit të ri, Presidenti i Asamblesë Henry Ramos Allup ka propozuar një ligj për dhënie e amnisti të gjithë të burgosurve politikë dhe në diskutimin e tij ka deklaruar: "Gjatë muajve të ardhshëm do të përdorim një metodë, një sistem për ta ndryshuar qeverinë me anë instrumentesh kushtetues". Disa orë më parë, Presidenti Nicolás Maduro kish firmosur një dekret që i hiqte Parlamentin pushtetin e emërimit të Drejtorit të Bankës Qendrore dhe Gjykata Supreme i kish penguar 3 deputetët të opozitës që të betoheshin (për të shmangur që opozita të arrinte mazhorancën). MUD-i nuk e ka respektuar vendimin e gjykatës dhe qysh atëherë qeveria nuk me ngjyrat e flamurit venezuelian. Prej prillit janë arrestuar më shumë se 2800 manifestues. Më shumë se 200 janë ende në burg.

absurde ta privosh parlamentin nga autoriteti duke e akuzuar për rebelim dhe fyerje, sikur të ishte një njeri i vetëm", thotë Borges. "Maduro ka miratuar bilancin vetë, nëpërmjet Gjykatës Supreme. Ka miratuar ligjin për borxhin publik pa e kaluar nga parlamentin, i mbyllur nga një qeveri të cilës nuk i intereson vota popullore apo demokracia". Lufta midis pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv është rënduar në 2016. Një tentativë dialogu e mbështetur nga Papa Françesku dhe nga Bashkimi i Vendeve Jugamerikane (UNASUR) në shtator ka përfunduar me asgjë faktike. Referendumi për të rrëzuar Maduro, i propozuar nga partitë e opozitës, është bllokuar nga Këshilli Kombëtar Elektoral (CNE), që ka pezulluar mbledhjen e formave për mashtrimet në 5 shtete në fund të tetorit. Këtë javë CNE-ja ka njoftuar se zgjedhjet e guvernatorëve, që do të mund t'i garantonin shumicën opozitës (dhe, për pasojë, kontrollin e forcave të policive rajonale), do të mbahehin në semestrin e parë të 2017, me 6 muaj vonë. Këto zgjedhje nuk janë mbajtur akoma.

## KUSHTETUTË E KONTESTUAR

Në qendër të Karakasit, sytë e Hugo Chávez, i vdekur në marsin e 2013, janë kudo. Ministri i Arsimit Elias Jaua na pret në zyrën e tij midis fotove të ndryshme të ish presidentit. Njeri i besuar i Chávez, Jaua ka qenë Sekretar i Presidencës, Ministër i Jashtëm, Ministër i Ekonomisë Popullore, Ministër i Bujqësisë dhe Zëvendës-president. Sot është i impenjuar edhe që të realizojë objektivin kryesor të qeverisë për të tejkaluar ngërçin e krijuar nga opozita (që nuk e ka ndërmend të pushojë së manifestuar): ti japë jetë Asamblesë Kushtetuese të

propozuar nga Maduro me 1 maj. Nëse projekti i qeverisë do të përfundojë me sukses, organi i ri do t'i anashkalojë të gjithë pushtetet e tjera dhe do të mund të imponohet ndaj Parlamentit apo deri edhe ta mbyllë atë. Jaua e ka lëkurën e errët dhe një shikim serioz prapa syzeve me skelet katror. Shpjegon plot afsh se problemi më i madh u vendit është "refuzimi i pajustificueshëm i opozitës për të dialoguar me qeverinë dhe parapëlqimi i saj për dhunë". Jaua ka detyrën që të koordinojë punën për Asamblesë Kushtetuese, një bast i rrezikshëm, që kërkon të vihet dorë në një prej trashëgimive më të rëndësishme të Chávez: kushtetuta e 1999. Edhe pse në atë kohë u kritikua, sot të gjithë politikanët akuzojnë njëri tjetrin se po e shkelin këtë tekst. "Problemi nuk është të modifikohet kushtetuta", shpjegon Jaua. "Duhet rikrijuar parimi sipas të cilit sovraniteti popullor është burimi suprem i datit të kombit. Dialogu nuk bëhet duke përfshirë një rreth të ngushtë politikanësh të opozitës, por nëpërmjet një procesi elektoral universal, të drejtpërdrejtë dhe sekret, që i bën të dalin liderin e qeverisë dhe të opozitës kundër kësaj dhune". Sipas formulës të menduar nga qeveria, përbërësit e Asamblesë Kushtetuese do të zgjidhen gjysma me bazë rajonale, kurse gjysma tjetër do të vijë nga 9 sektorë të tjerë të shoqërisë, si për shembull fshatarë, biznesmenë, indigjenë, njerëz me aftësi të kufizuara, universitarë dhe përfaqësues të këshillave komunalë. Pavarësisht ndryshimeve të paraqitura nga një asamble kushtetuese të zgjedhur sipas këtyre rregullave, Jaua thekson se "bazat doktrinare dhe folozofike të kushtetutës së 1999 do të mbesin të pandryshuara". Por propozimi i qeverisë e ka

nxehur klimën politike. Me 11 maj opozita ka mbushur rrugët e Las Mercedes, një lagje në zonën lindore të Karakasit. Protesta, e organizuar në më pak se 24 orë, ishte krejtësisht ndryshe nga ajo që kishte filluar gjithmonë prej aty një ditë më parë, kur turma kishte kërkuar që të hynte në qendër të qytetit, duke sfiaduar kordonat e policisë. Ka pasur përleshje dhe një student 24 vjeçar i Shkencave të Komunikimit, Miguel Fernando Castillo Bracho, ka mbetur i vrarë. Me 11 maj familjet, të drejtuar nga një klerik katolik, faleshin, këndonin dhe mbanin kurora me lule për të kujtuar të riun e vrarë. Sipas prokurorisë venezueliane, Castillo është goditur nga një plumb i qëlluar nga një armë artizanale. "Jam këtu si nënë, për të ndarë dhimbjen e nënave të këtyre të rinjve të vrarë, për shkak të represionit dhe të ligësisë së qeverisë", ka thënë profesorja Ana Karina Malave. Prej marsit kanë vdekur më shumë se 90 persona gjatë protestave. Numërimi i viktimave, një perversitet i sensacionalizimit venezuelian, është përdorur si armë nga të dy rreshtimet politike. Në Karakas, një prej qyteteve më të dhunshme të botës, ka pasur incidente vdekjeprurëse në të gjitha valët e manifestimeve kundër chavizmit. Në 2014 qeveria ka përdorur vdekjen e 43 manifestuesve, të vrarë gjatë një proteste, për të dënuar me 14 vite liderin e opozitës Leopoldo López. Qysh atëherë, López është i burgosuri politik më i famshëm i vendit. Në prillin e 2002, 19 të vdekurit gjatë një dite proteste u përdorën nga ushtarakët si pretekst për të kërkuar dorëheqjen e Chávez dhe i hapën rrugën një grushti shteti që do të zgjaste më pak se 48 orë.

Ernesto Villegas është Ministër i Komunikacioneve dhe President i televizionit shtetëror Venezolana de Televisión (VTV). Por mbi të gjitha është gazetar. Villegas ka shkruar një libër për grushtin e shtetit të 2002 të titulluar "Abril, golpe adentro" (Prill, grusht shteti i brendshëm). "Të të gjithë të vdekurit kanë të njëjtën vlerë, janë të gjithë të dhimbshëm, pavarësisht nga përkatësia politike e viktimës", thotë ministri dhe shton se të vdekurit e shkaktuar nga policia janë shumë më pak nga ato që thuhet andej këtej. Villegas thekson se nga 77 persona që janë vrarë në 6 muajt e parë të vitit sipas të dhënave të mbledhura nga zyra e tij, vetëm 25 janë vrarë teksa merrnin pjesë në protesta. Midis viktimave ka persona të vrarë prej plumbave të qëlluara nga armë artizanale apo armë zjarri. Paúl Moreno, një student 24 vjeçar i Mjekësisë, është shtypur nga një makinë në Maracaibo, në përfundim të vendit. Juan Peranalete, një student 20 vjeçar, është vrarë - sipas versionit të Prokurorisë së Përgjithshme Luisa Ortega Díaz - pasi është goditur në gjoks nga një bombë gazi lotsjellës të lëshuar nga policia. Midis viktimave janë 4 chavistë, 4 policë





dhe 8 persona kanë vdekur në vend tekta plaçkitnin një furrë buke në Karakas. Rasti për të cilin është folur më shumë është ai i Orlando Figuera, një djalë 21 vjeçar që me 20 maj, pasi është akuzuar për vjedhje, është linçuar, therë me thikë dhe djegur i gjallë nga manifestuesit që ndodheshin në sheshin Altamira. Figuera ka vdekur në spital 15 ditë më vonë, sipas prindërve të tij, që janë chavistë, djali punonte si punëtor parkimi në Las Mercedes dhe është vranë "pse ishte chavist". Lajmi nuk ka tërhequr shumë vëmendje në shtypin ndërkombëtar dhe është përdorur nga qeveria për të akuzuar opozitën. "Kur flasim për Venezuelën", pohon Villegas, "mjetet e huaja të informimit nuk zbatojnë rregullat standard të gazetarisë. Burimet zyrtare nuk konsiderohen të vlefshme. Ideja bazë është se çdo gjë e thënë kundër qeverisë përbën lajm, pa pasur nevojë të verifikohet". Villegas nënvizon një diferencë themelore midis 2002 dhe sot: rrjetet sociale. Në Venezuelë 53% e popullsisë ka akses në internet dhe midis shtresave popullore e dhëna shkon në 70%. "në 2002 qemë robër të televizionit", thotë ministri. "Sot komunikimi online ka zëvendësuar televizionin në disa zona dhe për disa grupmosha. Vlejën më shumë mesazhet e shkëmbyera në grupet WhatsApp; Facebook është aplikacioni më popullore në vend dhe Twitter përdoret shumë nga politikanët".

### MË SHUMË PROTESTA DHE MË SHUMË TË VDEKUR

Manifestimet si ai ku ka vdekur Miguel Fernando Castillo Bracho nuk gjejnë hapësirë në kanalet televizive free (Në veçanti Telesur dhe VTV u kush-tojnë shumë hapësirë programeve të propagandës kundër opozitarëve), nga ana tjetër është e pamundur të kontrollohet lumi i videove amatorese të përhapura në faqet anti-chaviste si Maduradas apo La Patilla. "Ka edhe një tendencë tjetër: shumë gjëra të prodhuara për Venezuelën vijnë nga Miami. Nëse do të bëhej një kërkim mbi përdoruesit më influentë online, do të shikohej se rreth 60% e tyre jeton jashtë Venezuelës". Kundërsulmi chavist procedon me po aq shpejtësi në faqe të tilla si La Iguana Tv, që boton video ku shikohen manifestues të hedhin eksplozivë artizanale kundër policisë. Njanjëherë lajmet e përhapura nga televizioni shtetëror manipulohen në mënyrë të dukshme, për shembull duket futur armë në fotografi të manifestuesve. Me një felpë mbi shpatulla, Henrique Capriles duket sikur sapo ka bërë xhoxing. Është figura kryesore e opozitës prej më shumë se 10 vitesh. Thekson se kriza ekonomike nuk do të zgjidhet deri kur nuk do t'i gjindet një rrugë-dalje krizës politike dhe duke folur me të të krijohet ndjesia se kjo rrugë-dalje

është larg. Capriles, kandidati presidencial që bashkon opozitën dhe që në 2013 është mundur nga Nicolás Maduro me vetëm 224000 vota, nuk do të mund të paraqitet në zgjedhje për 15 vitet e ardhshme. "Sipas kushtetutës, ndalimi politik fillon vetëm kur ka një vendim të formës së prerë. Rasti im ka të bëjë me një gjobë prej 40000 bolivares (rreth 6 dollarë në tregun e zi) pse kam marrë një donacion nga Mbretëria e Bashkuara e destinuar për një projekt shkollor". Dy ditë pas intervistës me Agência Pública, Capriles, Guvernatori i shtetit Miranda, do të shikojë që do t'i merret pasaporta në aeroport dhe nuk do të mund të largohet nga vendi për të shkruar në OKB, ku donte të denonconte shkeljet e të drejtave të njeriut në zhvillim në Venezuelë. Capriles mendon se kaosi mund të rritet. Nëse projekti i Asamblesë Kushtetuese ecën përpara, thotë, ai, Venezuela mund ta gjejë veten me dy kushtetuta. "Jam jashtëzakonisht i preokupuar, pasi qeveria i ka radikalizuar pozicionet e saj", thotë ai. Për Capriles zgjidhja është që të vazhdohet të manifestohet. "Maduro e ka injo-pruar rezultatin e kutive të votimit, një mazhorancë dërmuese në favor të forcave të ndryshimit. Çfarë kemi propozuar? Një referendum për ta votëbesuar presidentin, i parashikuar nga kushtetuta. Çfarë ka ndodhur? Na është mohuar. Çfarë duhet të bëjmë kur na i mbyllin të gjitha portat demokratike? Çfarë duhet të bëjë një udhëheqës?".

Gjatë manifestimeve, Capriles bëhet njeri tjetër. E çon turmën në delir, duke sharë Maduro dhe duke siguruar se qeveria është në pikën e rrëzimit. Në studion e tij duket më i arsyeshëm dhe paqëtues. "Jam i bindur se ndryshimi do të ndonjë nëpërmjet votës, pasi duhet të mendojmë për pas Maduro. Një qeveri që lind nga një rebelim ushtarak, nga një grusht shteti, nuk mund t'i japë stabilitet vendit". Në 2002 Capriles ndoqi nga afër grushtin e shtetit të dështuar, por sot këmbëngul për distancimin nga ajo trashëgimi e mallkuar. Me 11 prill 2002, disa orë përpara se Chávez të merrej nga ushtarakët që merrnin pjesë në puç, Julio Borges, në atë kohë President i Partisë Primera Justicia dhe sot President i Parlamentit, doli në televizion dhe i kërkoi qeverisë të dorëhiqej. Në të majtë të tij ishte Leopoldo López, Kryebashkiak i ri i Chacao, një komunë e rajonit metropolitan të Karakasit. Të nesërmen López shkoi me policinë bashkiake të arrestojë Ramón Rodríguez Chacín, Ministër i Brendshëm dhe i Drejtësisë, në kuadër të një spastrimi që, ashtu si grushti i shtetit, zgjati pak. Kur u fut me forcë në shtëpinë e ministrit, López ishte në shoqërinë e Capriles, në atë kohë Kryebashkiak i ri i Baruta, gjithmonë në rajonin metropolitan të Karakasit. Po atë ditë, Capriles qe protagonist i një

episodi të diskutueshëm në ambasadën kubaneze në Karakas. Ndërtesa ishte nën rrethim qysh nga 9 prilli. Turma kërcënonte se do të futej brenda dhe, qysh kur qarkullonin zëra se brenda ndodhej Zëvendëspresidenti Diosdado Cabello, që kërkonte azil politik, ndërtesës nuk i shkonin më as rryma, as uji. Capriles hyri në ambasadë dhe kërkoi që të bënte një kontroll. Ambasadori refuzoi, duke i apeluar të drejtës ndërkombëtare. Në dalje, Capriles zgjodhi që të lante duart: "Nuk mund ta konfirmoj apo të them ndryshe se Cabello ndodhet në ambasadë, pasi nuk ma lanë të kontrolloja". Capriles thekson se shkoi aty më tërheqës dhe se i ngritën një kurth. "Nuk kam marrë pjesë kurrë në grushtin e shtetit, kurrë!", përsëriti gjatë një interviste. Ndërkohë Diosdado Cabello është bërë politikani më i fuqishëm i chavizmit. Çdo të martë në orën 20 VTV-ja transmeton "Con el mazo dando", një program piktoresk që zgjat rreth 4 orë. Është takimi i përjavshëm me Cabello, që ka marrë stafetën nga Chávez, që si president bënte një emision të ngjashëm. Programi i merr emrin nga një çelës mekanik që prezantuesi e përdor për të goditur tavolinën kur dëshiron të theksojë atë që thotë. Ish uahtaraku flet përpara një logoje të madhe me siglën 4F (simbol i grushtit të shtetit të dështuar të tentuar nga Chávez në 1992) dhe shprehjen "Aquí no se habla mal de Chávez", këtu nuk flitet keq për Chávez. Cabello është figurë kyçe e një qeverie që i bën gjithnjë e më shumë apel mbështetjes së ushtrisë. Ka qenë Zëvendëspresident gjatë grushtit të shtetit dhe President i Parlamentit, Ministër i Punëve Botore dhe i Politikave të Banimit, si dhe Guvernatori i shtetit Miranda, një post që e ka humbur ndaj Capriles. Pa një mandat zyrtar në qeveri dhe me një vend të kotë prej deputeti në një parlament që nuk funksionon, është një prej njerëzve të propagandës chaviste. "Në këtë moment Cabello është politikani që i njeh më shumë forcat e armatosura", shpjegon Rocio San Miguel, Drejtore e OJQ-së Control Ciudadano para la Seguridad, la Defensa y la Fuerza Armada. "I pëlqen që ta shesë këtë imazh të vetes, dëshiron të besohet se kontrollon forcat e armatosura, por nuk është kështu. Në këtë moment asnjëri në Venezuelë nuk e ka kontrollin e forcave të armatosura. As vetë Maduro". Është pikërisht lidhur me këtë pikë në të cilën ndërhyrja opozita, që qysh nga fillimi i vitit po kërkoi që t'i bindë ushtarakët t'a ndërpresin mbështetjen Maduro. "Sot qeveria është e ulur mbi bajoneta. Por shpresojmë që në forcat e armatosura të ketë një komponente demokratike dhe institucionale, që të mos mbështesë një qeveri të korruptuar", thotë Borges, "Po kërkojmë ti bindim ushtarakët që të mos kenë frikë nga një proces elektro-

ral në gjendje të bashkojë vendin". Edhe Parlamenti po provon që t'i bindë ushtarakët. Në fund të majit është krijuar një komision garancie për tranzicionin, i cili duhet të miratojë një amnisti për të mbrojtur këndryshon rreshtim. "Jo vetëm amnisti, por edhe stimuj", shpjegon deputeti Freddy Guevara, Zëvendëspresident i Parlamentit dhe Koordinator i Partisë Voluntad Popular, e drejtuar nga Leopoldo López. "Kush arrestohet apo shkarkohet pse mbështet luftën për demokraci duhet ta dijë se kur do të vijë demokracia do të kompensohet".

### GENERALI BESNIK

Në këtë mënyrë liderët e opozitës kërkohen që të sigurojnë ushtarakët për faktin se nëqoftëse do të vijë në pushtet nuk do të zbatojnë asnjë represion si ai i dëshiruar nga Chávez pas grushtit të shtetit të dështuar të 2002, ku morën pjesë edhe disa liderë aktualë të opozitës. Në atë kohë qeveria chaviste reformoi policinë dhe konsolidoi pranimin e doktrinës bolivariene në ushtri, duke u besuar pozicione komanduesve ushtarakëve besnikë. "Chávez ka sjellë ushtarakët në pushtet për të stabilizuar qeverinë, por pas vdekjes së tij Maduro i ka bërë lëshime të tjera ushtrisë dhe sot lidhja midis politikave dhe forcave të armatosura është edhe më e ngushtë", shpjegon San Miguel. "Sot kemi një qeveri që udhëhiqet nga një civil, por që ka të gjitha karakteristikat e një ekzekutivi ushtarak. Shoqëria është militarizuar dhe jeta e përditshme rregullohet nga forcat e armatosura, të cilët menaxhojnë shpërndarjen e mallrave ushqimore, transportet, farmaceutit". Prej 32 ministrave të qeverisë së Maduro, 11 janë ushtarakë dhe 11 nga 23 guvernatorët shtetërorë janë ushtarakë në pension. Veç kësaj, ushtria është e pranishme në Zona Económica Militar Socialista, një kompleks industrial i krijuar nga Maduro në 2013 në shpresën e rigjallërimit të ekonomisë. Midis bizneseve të lindura me shpalljen e kësaj iniciative, 5 kanë raporte me forcat e armatosura: një bankë, një industri bujqësore e zooteknike, një kanal televiziv digjital, një kompani ndërtimesh dhe një furnizimi ujor në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Qysh atëherë janë krijuar 3 kompani të tjera. Compañia Anónima Militar de Industrias Mineras, Petrolíferas y de Gas (Camimpeg) është krijuar në fillim të 2016 për të racionalizuar shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Këshilli Drejtues emërohet nga Gjenerali Vladimir Padrino López, Ministër Mbrojtjeje, dhe qeveria është aksioneri kryesor. Maduro thotë se kjo kompani kufizohet vetëm në "sigurimin e shërbimeve PDV-SA-së", kompanisë petroliere shtetërore. Ushtarakët janë në vijë të parë edhe në luftën e qeverisë kundër krizës ekonomike, veçanërisht nëpërmjet

Gran Misión Abastecimiento Soberano, e drejtuar gjithmonë nga Padrino López. Programi shërben për të rregulluar importimin dhe shpërndarjen e mallrave ushqimore popullsisë më të varfër nëpërmjet komitetëve lokale të furnizimit dhe prodhimit (CLAP). Këto komitete, të lidhur me këshillat komunalë e lagjeve të varfra, shpërndajnë thasë që përmbajnë rreth 12 kilogram produkte bazë si oriz, miell, makarona e vaj, me çmime të subvencionuara nga qeveria. Pavarësisht problemeve, politika e CLAP-it i ka lehtësuar vështirësitë e krijuara nga mungesa e mallrave ushqimore, që ka arritur momentin më kritik në 2016.

Një studim i tri universiteteve i kryer gjithmonë në 2016 ka zbuluar se 70% e venezuelianëve kishte humbur mesatarisht 8 kilogram në harkun e një viti, një e dhënë katastrofike po të kihet parasysh se nën chavizmin popullsisë që vuante nga mungesat ushqimore ishte reduktuar nga 15% në 5%. Sot shpërndarja e shumë mallrave - vaj, sheqer, kafe, oriz dhe letrës higjienike - menaxhohet nga një ushtarak në kuadër të planit "Rubro por rubro". Kur vala e fundit e protestave është shtrirë nga Karaksi në shtete të tjera të vendit - duke sjellë me vete plaçkitje, bllokimet rrugore dhe sulme kundër strukturave të policisë - qeveria ka nisur fazën e dytë e planit "Zamora", që parashikon përdorimin e ushtrisë për të garantuar rendin publik në zona të tëra të vendit. Në mes të majit, Ministria e Mbrojtjes ka dërguar 2000 ushtarë të Gardës Kombëtare Bolivariene dhe 600 ushtarë të forcave speciale në shtetin Táchira, në kufi me Kolumbinë. Prej majit, forcat e armatosura e të gjithë vendit janë autorizuar të arrestojnë manifestues, që më pas gjykohej nga gjykata ushtarakë. Gjenerali Padrino López nuk lodhet kurrë së treguari mbështetjen e tij për Maduro.

Deklaron se Asambleja Kushtetuese "është një propozim revolucionar dhe thellësisht demokratik, që ne e mbështesim". Kërkon "përfundimin e fushatës së urrejtjes kundër forcave të armatosura" dhe ka mbështetur publikisht daljen e Venezuelës nga Organizata e Shteteve Amerikane (OEA), e lajmëruar në fund të prillit. Luis Almagro, Sekretari i Përgjithshëm i saj, është objektivi i pjesës më të madhe të kritikave të tij. Rritja e influencës së ushtarakëve në sektorë strategjikë të ekonomisë ngre një seri problemesh, sidomos rrezikun që të rritet korrupsioni, thembra e vërtetë e Akilit e qeverisë chaviste. "Për momentin raporti midis ushtarakëve dhe qeverisë funksionon dhe do të vazhdojë të funksionojë në të ardhmen e afërt", thotë Rocio San Miguel. Por një kërcënim i qëndron sipër: "Ka 3 krime që prekin nga afër kupolën ushtarakë të vendit: narcotrafiku, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe korrupsioni". Të kërkosh një zë

të paanshëm në Venezuelë është e pamundur. Maksimumi dhe me lodhje të madhe, mund të gjendet një bashkëbisedues realist. Luis Vicente León, Drejtore i Institutit Datanalisis, nuk është lloji i njeriut që nuk dëshiron të rreshtohet; mendon se Maduro po fillon të abuzojë me pushtetin e tij dhe se qeveria e tij ka marrë tipare diktatoriale. Por fakti që është një ekspert të dhënash (Datanalisis është një prej institutëve më të rëndësishëm të Venezuelës) e shtyn León të bëjë konsiderata të tjera: shpjegon se nga 2016, kur pakësimi i mallrave ushqimore ka arritur pikun e tij, popullariteti i Maduro është rritur. "Kishte rënë ndjeshëm pasi kishte fituar me 51% të votave; momenti më i keq i tij ka qenë në dhjetor të 2016, kur kishte zbritur në 18% të konsensusit. Por këtë vit, paradoksalisht, Presidenti ka rikuperuar 6 pikë përqindjeje, duke u ngjitur nga 18 në 24% besim. Kjo e dhënë varet nga ai 35% i popullsisë që e quan veten të pavarur, domethënë as me Maduro, as me opozitën". León thotë edhe se 90.5% e venezuelianëve mendon se vendi po ecën keq apo shumë keq dhe se 70% fajëson qeverinë për këtë. "Por as opozita nuk ngjall shumë besim. Duhet të flasë për të ardhmen e vendit, por preferon që të vazhdojë të sokëllijë kundër Maduro". León paralajmëron një negociatë midis qeverisë dhe opozitës. "Pa një traktativë politike do të jetë e pamundur të rikuperohet një ekuilibër. Opozita duhet ta përdorë forcën e saj në Parlament dhe në rrugë jo për ta detyruar qeverinë të dorëhiqet, por për të kërkuar një negociatë me të cilën të rithemelohej institucionet". Nëqoftëse, siç duket, opozita do të vendosë të mos e ndjekë këtë rrugë të dytë, qeveria do të vazhdojë t'i "getizojë manifestimet", duke i bërë më të dhunshme. "Duhet ta shmanjim me çdo kusht". León tregon edhe një faktor tjetër, më të thellë: "Në Venezuelë mungojnë qumështi, kafeja dhe orizi, por ajo që mungon më shumë është e vërteta dhe, akoma më shumë se ajo, objektiviteti. Në këtë vend nuk kuptohet më se cila është e vërteta, në mjetet e informimit, në diskutime, në debate, në intervista. Vlera e së vërtetës ka humbur krejtësisht, si në qeveri, ashtu edhe në opozitë. Bëhet luftë se kush thotë më shumë gënjeshtër. Humbja e së vërtetës nënkupton se nuk mund të ndahen më zërat nga realiteti. Kështu që pozicionimi bëhet shumë i vështirë". Në Venezuelë duket se është hapur një frakturë sociale që më pas është shtrirë në pjesën tjetër të kontinentit. "Kur fraktura sociale është maksimale, atëherë edhe e vërteta konsiderohet tradhti", përfundon León.

(Autorja është një gazetare braziliane, drejtuese e uebsajtit të gazetarisë investigative Agência Pública)





Në këto 15 ditë trajnimi grave ju mësuam se si të përdornin armët, taktikat dhe ndihmën e parë si dhe luftimin trup më trup



## “GATI PËR BETEJË”: Gratë siriane përgatiten për të luftuar kundër ISIS-it

Rreth 210 gra nga Siria u trajnuan për rreth 15 ditë nga Forcat Demokratike të Sirisë (SDF), për të luftuar kundër ISIS. Gratë mbaruan dje stërvitjen e tyre në një fshat të Sirisë veriore. Tashmë pas përfundimit të trajnimit të tyre ushtarak, gratë janë gati t'i bashkohen trupave të SDF në betejën kundër Shtetit Islamik. Në këto 15 ditë trajnimi grave ju mësuam se si të përdornin armët, taktikat dhe ndihmën e parë si dhe luftimin trup më trup. Një zëdhënës i SDF tha se ata duan që të çlirojnë zonat e Sirisë nga Shteti Islamik dhe të “thyejnë” mentalitetin mashkullor.







Qatip Osmani, flet pas fitores ndaj Vardarit

# Trajneri i Shkëndijës “paralajmëron” Milanin

Trajneri i Shkëndijës është i vetëdijshëm për forcën e kundërshtarit, por shprehet i vendosur që tetovarët ta bëjnë lojën e tyre dhe të mundohen ta nxjerrin më të mirën nga përballja e dyfishtë me gjigantin italian

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 14 gusht - Pas fitores ndaj Vardarit me rezultat 2:0, trajneri Qatip Osmani ka filluar të mendojë për duelin e vitit ndaj “Rossoneri”, që do të luhet të enjten në stadiumin “San Siro” nga ora 20:45. Trajneri i Shkëndijës është i vetëdijshëm për forcën e kundërshtarit, por shprehet i vendosur që tetovarët ta bëjnë lojën e tyre dhe të mundohen ta nxjerrin më të mirën nga përballja e dyfishtë me gjigantin italian. “Pas fitores ndaj Vardarit, tash do të mendojmë për ndeshjen me Milanin. Ne do të dalim në fushë, do të mundohemi ta luajmë lojën tonë, edhe pse përballë kemi një kundërshtar të fuqishëm siç është Milani”, është shprehur trajneri shqiptar.

## Porosia e Destanit

Ecuria pozitive e Shkëndijës në eliminatoret e UEFA



## MILAN —SHKËNDIJA, JA SA BILETA U SHITËN DERI TË HËNËN NË MËSDITË!

Tashmë po afrohet dueli i shumëpritur ndërmjet Milanit dhe Shkëndijës, i vlefshëm për fazën e “Play-Offit” të Europa Leagues, që do të zhvillohet të enjten mbrëma në stadiumin “San Siro” nga ora 20:45. Dhe, interesimi i tifozëve për ta përcjellë këtë ndeshje në stadium sa vjen e shtohet. Sipas mediave italiane, deri të hënën në mesditë numri i biletave të shitura për këtë ndeshje e ka arritur shifrën e 25 mijëve. Lajmin e ka bërë të ditur gjiganti mediatic italian “Sky”, përcjellë zeri.info, sipas të së cilit, numri i biletave që do të shiten deri të enjten do ta kalojë dyfishin e atij aktual.

Europa League dhe starti i suksesshëm i sezonit të ri në LPFM kanë lënë të kënaqur pronarin Lazim Destani, i cili këtë e ka shprehur publikisht përmes një postimi në profilin e tij

në Facebook. Destani vlerëson arritjen e ekipit në fazën e play offit të Europa Leagues për të dytin vit me radhë dhe paraqiten bindëse kundër Vardarit në kampionat, ndër-

sa inkurajon ekipin para përballjeve me Milanin. “Ju jeni Shkëndija e pritjeve dhe dëshirave të tifozëve, Ballistëve dhe gjithë adhuruesve të skuadrës kuqezi. Ju jeni

skuadra e lojës së bukur dhe e fitoreve të njëpasnjëshme. Unë gëzohem nga këto suksese të skuadrës kuqezi por gëzimi im bëhet akoma më i madh kur i shikoj të kënaqen gjithë ata tifozë e adhurues të Shkëndijës, anembanë trojeve tona. Shkëndija dje në ndeshjen me Vardarin në Tetovë, na bëri krenarë duke e nisur me fitore sezonin e ri. Me këtë rast, uroj të na shkojë mbarë dhe paçim suksese në këtë sezon. Meqenëse jemi para ndeshjes sonë historike me gjigantin e futbollit evropian Milanin, unë dua t’ju përgëzoj për sukseset në Europa Ligë ku ju arritët ta bëni realitet synimin dhe premtimin tonë për ta parë Shkëndijën në skenën evropiane. Me datën 17 të këtij muaji, do t’i përjetojmë fjalët e bukura, fjalët që i drejtohen Shkëndijës dhe gjithë tifozëve, – Mirëse Vini në ‘San Siro’! Jam i bindur se në përballjen me Milanin, ju lojtarët do ta jepni më të mirën. Me vet këtë përballje, krenarinë dhe dinjitetin tashmë na e keni sjellë, ndërsa shpresoj dhe uroj, nga Milano të ktheheni kryelartë e me rezultat të mirë! Ju priftë e mbaral!” ka shkruar Destani në Facebook para lojës së madhe të Shkëndijës me Milanin.

UEFA cakton gjyqtarët, ndeshja Milan-Shkëndija vëzhgohet nga një shqiptar

UEFA ka caktuar gjyqtarët të cilët do të ndajnë drejtësinë për fazën e play-offit të Europa Leagues, ku marrin pjesë Skënderbeu dhe Shkëndija. Përballja mes Dinamos së Zagrebit dhe Vardarin në Tetovë, do të luhet në orën 19:00 më datë 17 gusht, do të gjykohej nga gjyqtari letonez Andris Treimanis, shkruan Panorama Sport. 32-vjeçari është arbitër i FIFA-s që nga 2011-a, por nuk ka asnjë precedent të mëparshëm ku të ketë gjykuar skuadra shqiptare apo përfaqësueset e Shqipërisë. Ndeshja mes Milanit dhe Shkëndijës së Tetovës, e cila do të luhet në orën 20:45 më datë 17 gusht, do të gjykohej nga austriaku Harald Lechner. 35-vjeçari është arbitër i FIFA-s që prej vitit 2010, por nuk ka asnjë precedent të mëparshëm ku të ketë gjykuar skuadra shqiptare apo përfaqësueset e Shqipërisë. Pjesë e stafit të dërguar nga UEFA për ndeshjen Milan-Shkëndija do të jetë gjithashtu edhe një shqiptar. Sokol Jareci, ish-arbitër i njohur në Shqipëri, është përzgjedhur si vëzhgues i arbitrave të këtij takimi.

## Superkupa e Spanjës

# Reali gjunjëzon Barcelonën

Në shansin e parë që kishte përballë 90 mijë spektatorëve në “Camp Nou”, Barcelona dështoi t’i jepte impaktin e duhur sezonit, duke humbur 3-1 ndaj Realit të Madridit. Sfida e parë e Superkupës së Spanjës shkoi në favor të “Los Blancos”, që u imponuan në tempullin “blaugrana” dhe tani presin kthimin në kryeqytet

Shanset e shënimit ndryshuan disa herë kuadratin në fraksionin e parë, në një krah Suarez dhe Messi ndërsa në tjetrin Isco dhe Bale. Por, barazpeshja mbretëroi deri në minutën e 50, kur Gerard Pique shënoi autogol. Mbrojtësi i Barcelonës befasoi portierin Ter Stegen me një ndërhyrje që synonte të largonte topin, por e çoi atë në rrjetë. Por, vendasit arritën të barazonin pas një faulli në zonë nga portieri Keylor Navas, i cili shkaktoi penallti dhe i dha mundësi-



inë Lionel Mesit të shënonte nga pika e bardhë. Barcelona tentoi më pas gjithçka duke lënë hapësira në prapavijë dhe u ndëshkua me golin e dytë. Cristiano Ronaldo bëri “Camp Nou” të heshtë me një goditje perfekte që tregoi pikërisht në tempullin rival, se është ai fituesi në fuqi i Topit të Artë. Portugezi përkeqësoi situatën me daljen pas kartonit të dytë të verdhë, por nuk ndikoi në sfidën që “hipotekoi” trofeun për Realin. Goli i tretë i “Los

Blancos” ishte një kryevepër e Asensio që vendos “de facto” dhe fituesin e Superkupës, pa pritur sfidën e dytë. Humbja në tempullin “blaugrana” ndaj rivalit më të ashpër në futboll e ka shtuar pakënaqësinë e tifozëve ndaj Barcelonës dhe trajnerit Valverde ende pa nisur mirë sezoni. Disfata 3-1 ndaj Realit të Madridit sanksionoi “de facto” dhe fituesin e Superkupës së Spanjës dhe me përjashtim të mrekullive në Bernabeu, katalan-

asit duhet të dorëzojnë trofeun. Largimi i Neymar ka lënë boshllëqe që mund të mbushen nga lojtarët tjerë të nevojshëm. Afrimi i Paulinhos duket se nuk do të jetë i mjaftueshëm. Mesfushori Sergio Busquets pranon se Barcelona duhet të bëjë më shumë transferime, por këmbëngul se nevoja nuk është rritur nga humbja e tyre në ndeshjen e parë të Superkupës së Spanjës ndaj Real Madridit. “Skuadra nuk ka nevojë për blerje të reja për

## CRISTIANO RREZIKON 4 NDESHJE PEZULLIM

Edhe pse jo titullar, Cristiano Ronaldo u bë protagonist i raundit të parë të Superkupës së Spanjës mes Realit dhe Barcelonës. Sulmuesi portugez hyri në fushë në minutën e 58, duke zëvendësuar Karim Benzema. Pas penalltisë së Messit, që u shoqërua me protesta të shumta nga ana e madrilenëve, Cristiano mori për dore ekipin. Numri 7 i Realit shënoi një gol të mrekullueshëm dhe hoqi fanelën për t’ia treguar stadiumit “Camp Nou”. Kjo bëri që të ndëshkohej me karton të verdhë. Vetëm një minutë më vonë, portugezi u rrëzua në zonë pas një dueli me Umtitin. Arbitri e interpretoi simulum këtë rëzim dhe e ndëshkoi me kartonin e dytë të verdhë Cristianon, i cili i nervozuar jashtë mase, shtyu me dorë gjyqtarin Burgos Bengoetxea. Ky veprim mund ta pezullojë Cristianon për 4 ndeshje, pa përfshirë ndeshjen e kthimit të Superkupës së Spanjës.



shkak të këtij rezultati. Ne kemi nevojë për përforcime sepse kemi për t’i rinovuar gjërat. Është shumë e vështirë, por ne shkojmë në “Bernabeu” me qëllim që të rikthehemi në diskutim. Nuk kërko-

jme justifikime”, tha mesfushori spanjoll. Barcelonës do t’i duhet të fitojë 3-0 në Madrid për të marrë trofeun, por loja që treguan “merengues” në transfertë jep pak shpresa për tifozët “blaugrana”.





Në bazë të nenit 34 paragrafi 3 e Ligjit për vlerësim dhe nenit 8 të Statutit të Odës së vlerësuesve të RM, Kryetari i Odës së vlerësuesve të RM, në pajtim me kërkesën me shkrim të një grupi të vlerësuesve më datë 11.08.2017 ka sjellë vendim për publikim të:

**SHPALLJE PUBLIKE**

Për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit drejtues të Odës së vlerësuesve të RM  
Publikohet shpallje publike për zgjedhje të 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit drejtues të Odës së vlerësuesve të RM.

Për anëtarë të Këshillit drejtues mund të paraqiten kandidatët të cilët përmbushin kushtet në vijim:

1. Të jetë anëtar i Odës së vlerësuesve

Gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes për anëtar të KD, kandidatët e interesuar duhet të parashtrojnë:

1. Biografi të shkurtë - CV

Afati për paraqitje është 10 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike.

Kandidatët e interesuar dokumentet e tyre duhet që në origjinal t'i dorëzojnë në selinë e Odës së vlerësuesve të RM, në rr. Makedonija nr. 47/2 Shkup.



Në bazë të nenit 34 paragrafi 3 e Ligjit për vlerësim dhe nenit 12 të Statutit të Odës së vlerësuesve të RM, Kryetari i Odës së vlerësuesve të RM, në bazë të kërkesës me shkrim të një grupi të vlerësuesve më datë 11.08.2017 ka sjellë vendim për publikim të:

**SHPALLJE PUBLIKE**

Për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës të Odës së vlerësuesve të RM  
Publikohet shpallje publike për zgjedhje të 3 (tre) anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës të Odës së vlerësuesve të RM.

Për anëtarë të Këshillit mbikëqyrës mund të paraqiten kandidatët të cilët përmbushin kushtet në vijim:

3. Të jetë anëtar i Odës së vlerësuesve

Gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes për anëtar të KM, kandidatët e interesuar duhet të parashtrojnë:

3. Biografi të shkurtë - CV

Afati për paraqitje është 10 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike.

Kandidatët e interesuar dokumentet e tyre duhet që në origjinal t'i dorëzojnë në selinë e Odës së vlerësuesve të RM, në rr. Makedonija nr. 47/2 Shkup.



Në bazë të nenit 34 paragrafi 3 e Ligjit për vlerësim dhe nenit 10 të Statutit të Odës së vlerësuesve të RM, Kryetari i Odës së vlerësuesve të RM, në pajtim me kërkesën me shkrim të një grupi të vlerësuesve më datë 11.08.2017 ka sjellë vendim për publikim të:

**SHPALLJE PUBLIKE**

Për zgjedhje të Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe Kryetarit të Odës së vlerësuesve të RM  
Publikohet shpallje publike për zgjedhje të Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe Kryetarit të Odës së vlerësuesve të RM.

Për Kryetari të Këshillit drejtues dhe Kryetar të Odës së vlerësuesve të RM mund të paraqiten kandidatët të cilët përmbushin kushtet në vijim:

2. Të jetë anëtar i Odës së vlerësuesve

Gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes për Kryetar të Këshillit Drejtues dhe Kryetarit të Odës së vlerësuesve të RM, kandidatët e interesuar duhet të parashtrojnë:

2. Biografi të shkurtë - CV

Afati për paraqitje është 10 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike.

Kandidatët e interesuar dokumentet e tyre duhet që në origjinal t'i dorëzojnë në selinë e Odës së vlerësuesve të RM, në rr. Makedonija nr. 47/2 Shkup.



Në bazë të nenit 34 paragrafi 3 e Ligjit për vlerësim dhe nenit 14 të Statutit të Odës së vlerësuesve të RM, Kryetari i Odës së vlerësuesve të RM, në pajtim me kërkesën me shkrim nga një grup i vlerësuesve më datë 11.08.2017 ka sjellë vendim për publikim të:

**SHPALLJE PUBLIKE**

Për zgjedhje të anëtarëve të Komisionit disiplinor të Odës së vlerësuesve të RM  
Publikohet shpallje publike për zgjedhje të 6 (gjashtë) anëtarëve të Komisionit disiplinor të Odës së vlerësuesve të RM.

Për anëtarë të Komisionit disiplinor mund të paraqiten kandidatët të cilët përmbushin kushtet në vijim:

4. Të jetë anëtar i Odës së vlerësuesve

Gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes për anëtar të KD, kandidatët e interesuar duhet të parashtrojnë:

4. Biografi të shkurtë - CV

Afati për paraqitje është 10 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike.

Kandidatët e interesuar dokumentet e tyre duhet që në origjinal t'i dorëzojnë në selinë e Odës së vlerësuesve të RM, në rr. Makedonija nr. 47/2 Shkup.



**REPUBLIKA E MAQEDONISË**  
**Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi“ - Shkup**  
**Fakulteti për elektroteknikë dhe teknologji informatike**

Në bazë të nenit 131 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 114/2011, 123/2012, 15/2013 и 24/2013, 41/2014, 116/ 2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 155/2015, 120/2016 и 127/216), nenit 51 të Rregullores për marrëdhënie të brendshme dhe punës së Fakultetit të elektroteknikës dhe teknologjisë informatike në përbërje të Universitetit Shën Kirili dhe Metodi në Shkup, Dekani i fakultetit për elektroteknikë dhe teknologji informatike solli vendim për shpalljen e

**KONKURSI**  
**Për zgjedhje të**

Shpallet konkurs për zgjedhje të

1. Mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor shkencor për lëndët nga sfera mësimore-shkencore **20207 - centralet elektrike dhe stacionet e shpërndarjes**, (zgjedhja është për kohë prej 5 vjet).
2. Një asistent për lëndët nga sfera mësimore-shkencore **21208 - teknologjitë kompjuterike dhe inxhinieri**.

Kushtet: Kandidatët, përveç kushteve të përgjithshme, duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta të parashikuara me Ligjin për arsim të lartë, Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në titujt arsimore-shkencore, shkencore, arsimore-profesionale dhe titujve të bashkëpunëtorëve në Universitetin Kirili dhe Metodi dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Fakultetit.

Me paraqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë: dokumentet për mbarimin e shkollimit, biografi të shkurtër, formular të mbushur ndaj raportit për zgjedhjen në titull arsimor-shkencor, listë të punimeve shkencore dhe profesionale, nga një ekzemplar të punimeve, vërtetim për njohjen e gjuhës së huaj dhe certifikatë të shtetësisë.

Orari i punës është në përputhshmëri me orarin e orëve në semestër, ndërsa pagesa themelore varet nga angazhimi mësimor në semestër.

Paraqitjet me dokumentet e kompletuara dorëzohen në arkivin e fakultetit, ose përmes postës në adresën rruga Rugjer Boshkoviq 18 - Shkup.

Konkursi zgjat 8 ditë që nga dita e shpalljes.

Nga FETI



Në pajtim me nenin 33 dhe 34 të Ligjit për vlerësim (Gazeta Zyrtare nr. 115/10, 158/11 dhe 64/12), Kryetari i Odës së vlerësuesve më datë 11.08.2017 thërret:

**KUVEND**  
Të Odës së vlerësuesve të RM  
**06.09.2017 (e mërkurë) në ora 12.00 në TCC Grand Plaza**  
**RENDI I DITËS**

*Pjesa procedurale:*

1. Zgjedhje të mbajtësit të procesverbalit të kuvendit
2. Zgjedhje të vërtetuesve të procesverbalit
3. Zgjedhje të numëruesve të votave
4. Zgjedhje të kryesisë punuese

*Pjesa e punës:*

1. Miratimi i procesverbalit nga kuvendi i kaluar
2. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit drejtues
3. Zgjedhja e kryetarit të Këshillit drejtues dhe kryetarit të Odës
4. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës
5. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit disiplinor
6. Të ndryshme

**Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë**

**PUBLIKON**

Kërkesë për dhënie të Lejes për shfrytëzim të ujit nga pusi për nevojat e instalacionit "RUEN INOKS AVTOMOBILE" SHPK Koçan, në PK 16470 KK Koçan, Komuna e Koçanit.

Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15, dhe 52/16), deri në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar Kërkesë për dhënie të Lejes për shfrytëzim të ujit nga pusi për ujitje, në PK 16470 KK Koçan me numër arkivues nr. UP1 11-5 378/2017 të datës 14.03.2017.

Parashtrues të kërkesës:

"RUEN INOKS AVTOMOBILE" SHPK KOÇAN

Rr. Todosija Paunov nr. 32 Koçan

Koordinatat e puseve të eksploatacionit B-1 PK 16470 KK Koçan, Komuna e Koçanit.

Pusi X - 7618815.59 Y - 4641902.92

Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të merr në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail [H.Rexhepi@moepp.gov.mk](mailto:H.Rexhepi@moepp.gov.mk)

Opinioni i tanguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të parashtrojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri tek Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor "Goce Dellçev" nr. 18 ndërtesë e RTM (kati 10), 1000 Shkup



Komuna e Tearcës  
Nr.. 10 - 730 / 10  
04.08.2017  
Tearcë

**SHPALLJE E B - LEJËS SË INTEGRUAR EKOLOGJIKE**

**Kryetari i komunës së Tearcës solli Vendim për dhënie të B - lejes së integruar ekologjike për**

**SHPNTSH "BAU - ENN" shpk eksport - import f. Tearcë**  
**Reperti punues "BAU - ENN" shpk eksport - import f. Tearcë**

Leja është në disponim për publikun gjatë kohës së ditëve të punës në periudhën prej orës 8:00 - 16:00 në zyrën nr.4 kati 1 në ndërtesën administrative të komunës së Tearcës, f. Tearcë, 1224 Tearcë.

Ankesat në lidhje me Vendimin mund të parashtrohen në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes, deri te komisioni i shkallës së dytë në rr. "Goce Dellçev" P.N. Shkup.

Të gjitha informatat e nevojshme mund të merren në tel. 044 381 336 ose në web faqen: [www.tearce.gov.mk](http://www.tearce.gov.mk).

**Kryetar**  
**Isen Asani**





Klopp shpallë formacionin kundër Hoffenheim

# Coutinho jashtë Liverpoolit



Philippe Coutinho nuk është përfshirë në listën e Liverpoolit kundër Hoffenheimit në Ligën e Kampionëve. Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp ka publikuar listën prej 22 lojtarëve të ftuar për ndeshjen kualifikuese të Ligës së Kampionëve ndaj Hoffenheim. Pjesë e kësaj liste nuk është ylli i skuadrës Philippe Coutinho, i cili thuhet se vuan nga një lëndim i shpinës. Por, shumë media në Angli shkruajnë se arsye e vërtetë e mungesës së tij është mundësia e transferimit në Barcelonë.

zhvillohet sot (e martë) në Gjermani nga ora 20:45. Lista e plotë e lojtarëve të ftuar nga Klopp: Alexander-Arnold, Moreno, Lovren, Milner, Wijnaldum, Henderson, Can, Mane, Salah, Firmino, Kent, Solanke, Origi, Gomez, Klavan, Flanagan, Robertson, Matip, Grujic, Mignolet, Karius, Ward. Jurgen Klopp ka premtuar se Liverpool është duke punuar që të transferojë disa lojtarë. Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, nuk është i kënaqur me skuadrën që ka në dispozicion dhe dëshiron më shumë transferime. Ai tha se skuadra po punon për

këtë, pasi ai nuk ka lojtarë të mjaftueshëm për të luajtur gjatë tërë sezonit. “Ne ende po punojmë në transferime”, tha fillimisht Klopp. “Ne jemi në bisedime dhe po punojmë në të gjitha anët. Për momentin nuk kemi lojtarë të mjaftueshëm në skuadrë. Kjo është e gjitha”. Liverpool në ndeshjen e parë të sezonit të ri të Premierligës barazoi 3:3 me Watfordin në udhëtim. Ndërkaq, përveç pritjes për zyrtarizmin e Coutinho, Barcelona ka vazhduar me blerjet. Përfundimisht ka arritur marrëveshje për transferimin e Paulinhos. Kapiteni

Pjesë e kësaj liste nuk është ylli i skuadrës Philippe Coutinho, i cili thuhet se vuan nga një lëndim i shpinës. Por, shumë media në Angli shkruajnë se arsye e vërtetë e mungesës së tij është mundësia e transferimit në Barcelonë

i Guangzhou Evergrande, Zheng Zhi e ka konfirmuar se Paulinho është transferuar në Barcelonë. Ai tha se ky nuk është vetëm një nder për Paulinhon, por për gjithë ligën kineze. “Transferimi i tij në Barcelonë, nuk është nder vetëm për Paulinhon, por për të gjitha klubet kineze. Ne i dëshirojmë sukses atij në Spanjë”, tha Zheng Zhi pas ndeshjes me Henan Jianye. Lajmi është konfirmuar edhe nga trajneri Felipe Scolari, i cili tha se i dëshiron Paulinhos shumë suksese në Barcelonë. Barcelona për Paulinhon do të paguajë 40 milionë euro, aq sa ishte edhe klauzola e tij.

## “Shpresoj që Arsenal do ta shes klientin tim”



Rodrigo Fernandez Lovelle, agent i sulmuesit të Arsenalit, Lucas Perez shpreson se Arsenal do ta shes klientin e tij. Ai tregoi se Deportivo ka ofruar 12 milionë euro, të cilat beson se janë të mjaftueshme për skuadrën londineze. “Mendoj se 12 milionë euro të Deportivos janë një marrëveshje e mirë.

Deportivo përfitoi 14 milionë euro verën e kaluar”, tha Rodrigo Fernandez Lovelle për Sky Sports. “Ata po japin gjithçka që të bëjnë që kjo marrëveshje të realizohet. Lucas dëshiron të luajë, por ka kontratë me Arsenalin. Shpresoj se kjo marrëveshje të realizohet”.

## “Po më trajtojnë si kriminel”



Diego Costa nuk është aspak i lumtur me mënyrën se si po trajtohet nga Chelsea. Sulmuesi spanjoll, Diego Costa, thotë se ai po trajtohet nga Chelsea sikur të ishte kriminel, pavarësisht asaj që ka bërë për këtë skuadrë. “Unë nuk jam kriminel. Nuk mendoj se është e drejtë kjo çka po ndodh me mua, pas asaj që kam bërë për

këtë skuadrë”, tha Costa. “Ata duan që unë të stërvitem me ekipin rezervë, por nuk do ta bëj. Unë nuk jam kriminel. Nëse ju duhem ata e dinë ku mund të më gjejnë”. Ai po ashtu tha se nuk do të shitet te skuadrat ku dëshiron Chelsea, të ato që paguajnë më shumë për të, por dëshiron të kthehet në Atletico Madrid.

## Inter kërkon yllin e Unitedit



Inter nuk e ka ndërmend të heq dorë nga anësori i Manchester

Unitedit, Anthony Martial. Skuadra italiane, Inter vazhdon të përcjellë

situatën e francezit të Manchester Unitedit, Anthony Martial, shkruan

Gazzetta dello Sport. Inter dëshiron të përfundojë edhe dy lojtarë para se të përfundojë afati kalimtar, një mbrojtës të djathtë dhe një anësor të majtë.

Dëshira e trajnerit Luciano Spalletti është Martial, por si pjesë e marrëveshjes nuk do të përfshihet kroati Ivan Pericis, për të cilin Inter i kërkon 55 milionë euro. Në listën e Interit janë edhe Emre Mor dhe Yann Karamoh

## Dua të qëndrojnë në Juventus përgjithmonë



Paulo Dybala është shumë i lumtur në Juventus dhe dëshiron të qëndrojë përgjithmonë. Sulmuesi argjentinas, Paulo Dybala, edhe një herë tjetër ka thënë se është shumë i lumtur që është pjesë e Juventusit. Ai madje tha se nëse presidenti dëshiron, ai do të qëndronte te kjo skuadrë për tërë jetën. “Jam shumë i lumtur në Juventus. E kam vazhduar kontratën tre muaj më parë”, tha Dybala për Sport Mediaset. “Unë dua të rritem këtu. Nëse presidenti më dëshiron, unë do të qëndroja përgjithmonë këtu”.

## Allgeri, akuza të mëdha lojtarëve pas humbjes nga Lazio



Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, nuk është i kënaqur me paraqitjen e lojtarëve në Superkupën e Italisë ndaj Lazios, ku u mposhten 3:2. Ai madje e pranoi se Lazio ka qenë skuadrë më e mirë dhe e ka merituar trofeun. “U treguam mendjelehtë, por Lazio e meritoi trofeun. Luajti më mirë dhe luftoi më shumë se ne. Për të paktën një orë nuk kemi luajtur futboll. Duhet të reflektojmë dhe të rikthehemi më

këmbë në tokë”, tha Allegri pas ndeshjes. Ai i ka porositur lojtarët që në ndeshjen ndaj Cagliariarit në

Serie A duhet të rikthehen te fitoja dhe të nisin sezonin në mënyrën më të mirë.





Pas humbjes në garën e 100 metrave, sprinteri i dha lamtumirën atletikës me një dëmtim muskular në stafetën 4x100 metra, në Botërorin që po zhvillohet këtë muaj në Angli

Legjenda e atletikës Bolt i jep fund karrierës

# Nuk do të kthehem më

“Nuk ka asnjë shans për një rikthim dramatik. Kam parë shumë njerëz që janë rikthyer pas pensionimit dhe vetëm sa i kanë përkeqësuar gjërat apo kanë turpëruar veten. Nuk do të jem një nga këta njerëz.”, deklaroi Bolt



Legjenda e atletikës, Usain Bolt deklaroi se përfundimisht i ka dhënë fund karrierës. 30-vjeçari e mbylli karrierën në mënyrën më të keqe të mundshme sepse nuk arriti ta përfundojë garën 4x100 metra në Kampionatin Botëror të Atletikës për shkak të një lëndimi të pësuar vetëm 50 metra para fundit të garës. Bolt u përshëndet nga Kampionati Botëror me medaljen e bronzit të fituar në garën e 100 metërshit.

“Nuk ka asnjë shans për një rikthim dramatik. Kam parë shumë njerëz që janë rikthyer pas pensionimit dhe vetëm sa i kanë përkeqësuar gjërat apo kanë turpëruar veten. Nuk do të jem një nga këta njerëz.”, deklaroi Bolt.

Kur të gjithë prisnin që njeriu më i shpejtë në

planet t'i bënte një mbyllje dinjitoze karrierës spektakolare, por tifozët që shpresonin në medaljen e artë të xhamajkanit panë dështimin dhe dëmtimin e Usain Bolt në Londër. Pas humbjes në garën e 100 metrave, sprinteri i dha lamtumirën atletikës me një dëmtim muskular

në stafetën 4x100 metra, në Botërorin që po zhvillohet këtë muaj në Angli. Një lamtumirë të tillë nuk do ta kishte imagjinuar asnjë, pasi Xhamajka ishte favorite në garën e stafetës, por Usain Bolt u shemb në pistë totalisht jashtë formës. Madje u mendua për më keq, kur asistencën i ofroi një karrixe me rrota atletik rekorde olimpik, por mesa duket Bolt e kishte më të dhimbshëm dëshpërimin për dështimin, sesa dhimbjen në muskuj. Ndërkohë, klima në stadiumin olimpik të Londrës ishte shënjuar nga një përzierje emocione unike, në një mbrëmje që do të kujtohet gjatë. Para Bolt, një tjetër monument i atletikës, Mo Farah u mund në garën e 5.000 metrave, një disfatë epokale për atë që, ashtu si Bolt, e kishte garën e fundit në tartan.

## McGregor thotë se do të bëhet “Zoti i boksit”



Luftëtari irlandez Conor McGregor shpreson që superioriteti i tij fizik do të jetë faktor vendimtar në përballjen me amerikanin Floyd Mayweather Jr më 26 gusht në Las Vegas, ndërsa kampioni i botës i dy kategorive të ndryshme në serinë më të madhe të arteve marciale të përziera UFC beson se do të mundë të shokojë botën. Ylli i UFC-së, që vlerësohet autsajder absolut, do të bëjë debutimin e tij në boks profesionist në “T-Mobile Arena” të Las Vegasit në një meç që vlerësohet më fitimprurësi në histori të boksit, ndërsa do të përballen dy prej emrave më të mëdhenj të sportit modern, shkruan “Daily Mail”, transmeton “Koha Ditore”. McGregor 29-vjeçar është i bindur se mund të dominojë në ring për shkak të madhësisë së tij, dhe ai e vlerëson

këtë si meçin më të madh të të gjitha kohërave. Irlandezi thotë se nuk është i huaj në boks dhe me të mposhtur Mayweatherin, ai thotë se do të dominojë këtë sport. “Unë kam një plan dhe do ta ekzekutoj atë në mënyrë perfekte, siç bëj gjithmonë në luftëra të mia”, ka thënë McGregor para mediave në Las Vegas. “Unë kam boksuar gjithë jetën time, kështu që kjo nuk është përvojë e re për mua. Unë do të dominoj si në artet marciale të përziera ashtu edhe në boks me grushtin tim të hekurt. Kritikët hedhin poshtë stërvitjet e mia, shkathtësitë e mia dhe arrijtjet e mia. Por, kjo nuk është gjë e re për mua, siç nuk është edhe boks. Të jem autsajder nuk është diçka e panjohur për mua. Unë jam i bindur se jam më i mirë. Dhe pas 26 gushtit, do të jem Zoti i boksit”

## Shpërthimi i futbollistëve shqiptarë në Kupën e Zvicrës

Liridon Mulaj ka shënuar shtatë prej 21 golave të skuadrës Neuchatel Xamax. Skuadra që bënë gara në Kategorinë e Dytë të Zvicrës, Xamax, të shtunën mposhti skuadrën e kategorisë së fundit të Zvicrës (9), Union-Sportive Montfaucon me rezultatin e thellë 21:0, në kuadër të raundit të parë të Kupës së Zvicrës në futboll. Fitortja e Xamaxit është edhe rekorde sa i takon futbollit zviceran. Rekordi për fitoren më të thellë ishte arritur 70 vjet më parë, në vitin 1947, kur skuadra NLA-Klub Grenchen e kishte mposhtur me shifrat 18:0 skuadrën e Tavannes. Por ai rekord u shfuqizua të shtunën nga Xamasi dhe Mulaj dha kontributin e tij të madh. Mesfushori ofensiv i lindur në Deçan, golat i shënoi në minutat 17, 25, 34, 38, 64, 71 dhe 86. Një gol e shënoi edhe sulmuesi tjetër kosovar, Samir Ramizi (35'). Si Mulaj ash-



tu edhe Ramizi kontribuuan edhe me nga tri asistime. Në futbollin e Zvicrës numri i lojtarëve shqiptarë është duke u rritur vazhdimisht. Një dëshmi për këtë është edhe numri i madh i golave që futbollistët shqiptarë realizuan në ndeshjet e rrethit të parë të Kupës, të luajtura të shtunën e të dielën. Futbollisti 18-vjeçar, Mulaj, ndjehet i lumtur që i ka ndihmuar ekipit të tij të shënojë një rekord të ri në futbollin e Zvicrës

## MotoGP, kryevepër e Dovizioso në Austri

Andrea Dovizioso triumfoi në Çmimin e Madh të Austrisë dhe regjistroi suksesin e tretë sezonal në MotoGP. Piloti i Ducatit e mbylli i pari garën në Spielberg, pas një dueli të jashtëzakonshëm me Marc Marquez, i cili u dorëzua përballë italianit vetëm në kthesën e fundit. Një betejë e cila hyn me të drejtë në historinë e kategorisë “Mbretëreshë”, pasi i la të gjithë tifozët në ankth deri në momentin kur motorët kaluan në finish. Një provë force ajo e çiftit italianë Ducati-Dovizioso, me pilotin që ngjitet në

kuotën e tre fitoreve, aq sa ka edhe Marquez, ndërsa tashmë ka vetëm 16 pikë diferencë nga lideri i botërorit. Në vendin e tretë të podiumit u pozicionua motori tjetër Honda i Dani Pedrosa, ndërsa Lorenzo e mbylli i katërti. jo në nivelet e pritura Maverick Vinales dhe Valentino Rossi me Yamaha, të cilët u renditën në vendet gjashtë dhe shtatë. Pas spektaklit në Austri, botërori i MotoGP konfirmoi se mbetet i hapur dhe mbi të gjitha spektakolar, me takimin e radhës emocionues që do të jetë në pistën e Silverstone.



## Kualifikimi historik i Kosovës në futbollin zviceran

Kosova e Zurichut ka shënuar edhe një tjetër sukses historik në futbollin zviceran. Kosova ka triumfuar për 1/32 e Kupës së Zvicrës ndaj Berolche-Gorgier me rezultatin 4:1, duke u kualifikuar kështu në rrethin e ardhshëm, shkruan albinfo.ch. Pjesa e parë përfundoi pa gola, ndërsa në atë të dytë, dy skuadrat shënuan nga një gol për të shkuar në vazhdim. E, në vazhdim, Kosova ishte fantastike, madhështore dhe jashtëzakonshme, duke shënuar edhe tre gola dhe duke siguruar kualifikimin historik në rrethin e ardhshëm, ku mund të përballen me



kundërshtarë shumë më të fortë. Golat për skuadrën shqiptare i shënuan Arben Buqay dy, Rexhep Thaqi një gol dhe Shqipërim Aliu një gol.

## Coleman e Stefanidi i ofrojnë shpresë atletikës

Me tërheqjen e yjeve Usain Bolt e Mo Farah nga bota e atletikës, sfidë ka mbetur që të gjenden emra të rinj që do të mund të marrin stafetën nga ta

Ndonëse është vështirë të zëvendësohen këta yje, prapë presidenti i Federatës Botërore të Atletikës (IAAF), Sebastian Coe, po shfaqet i qetë, shkruan “The Guardian”, transme-

ton “Koha Ditore”. Ai beson se në Botërorin 2017 në Londër janë shfaqur një numër i yjeve të rinj për të shkuar përkrah emrave të mëdhenj të konfirmuar tash si Wayde van Niekerk, Allyson Felix, Kendra Harrison e Nafissatou Thiam. Ai dëshiron që këta emra të rinj të promovojnë veten dhe sportin e tyre më mirë. “Agjentët dhe menaxherët janë jashtëzakonisht të mërzitshëm. Ata u thonë atletëve të tyre: ‘Nuk bën të thuash këtë,

nuk bën të thuash atë’. Ne duhet të jemi më të relaksuar në atë se çfarë thonë ata. Shikoni Conor McGregorin që ka shtyrë edhe fëmijët e mi të flasin për UFC-në. Unë nuk po them se njerëzit duhet të jenë si ai, por është mirë të japin mendimin e tyre në çështje të caktuara dhe të tregojnë personalitetin e tyre. Ne duhet të inkurajojmë atletët të jenë vetvetja. Kjo do të bëjë që mediat t'i shohin ata më interesant dhe do të ndihmojë që

publiku të angazhohet më tepër”, ka deklaruar Coe. “Usain Bolt, për çfarëdo arsye, ndoshta ka qenë personalitet në sekondën që ka ecur në klasën e tij. Unë po them se është me rëndësi që atletët të kuptojnë se janë pjesë të një biznesi të argëtimit. Arsyeja që Usain Boltit do t'i ndihet mungesa është jo vetëm për shkak të gjithë atyre medaljeve të fituara, por pasi ka qenë i gatshëm të japë mendimin e tij për gjëra të caktuara”.





## DASHI (20/III-20/IV)



-Dita fi llon pozitive për ju, për sa u përket miqësive dhe bashkëpunimeve në grup për projekte të rëndësishme. Jini më të kujdesshëm mbi nevojat e të tjerëve dhe do të keni avantazhe. Që sot mund të merrni vendime të rëndësishme, që do të ndryshojnë të ardhmen tuaj.

## DEMI (21/IV-20/V)



Kjo ditë nuk do jetë mjaftueshmërisht e mirë, por sot do të ndiheni në formë perfekte. Sot, për sa i përket humorit, nuk do të jeni në nivelin e duhur, por gjendja mendore dhe intelektuale do të jetë shkëlqyeshme, do të arrini shumë rezultate të mira në gjithçka që bëni.

## BINJAKËT (21/V-20/VI)



Energji e madhe pozitive, që ju bën të riktheheni në punë me entuziazëm. Bëni një analizë të kujdesshme të asaj që po u ndodh. Ndoshta ka shumë gjëra pa sqaruar. Afrohuni më shumë me një person që ishit larguar para pushimeve.

## GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Dita fi llon me një humor shumë të lëkundur, por mos e dramazoni shumë. Keni vetëm nevojë të gjeni një sens të ri mbi atë që do vendosni të bëni. Mos merrni shumë impenjime dhe vendime të rëndësishme sot, prisni nesër. Shëndeti do ju japë ndonjë shqetësim të vogël.

## LUANI (23/VII-22/VIII)



Dita do të fi llojë me ndonjë keqkuptim të vogël, por mos u shqetësoni. Sot në mbrëmje gjithçka do të sqarohet. Kështu që lërimi gjërat të ndjekin rrjedhën e tyre pa i forcuar ato. Kërkoni mbështetjen e një personi që nuk ju pëlqen, por që mund t'ju ndihmojë.

## VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)



-Do të jetë një ditë e shkëlqyer në punë dhe në aktivitetet e përditshme. Do të merrni stimuj për punën që keni kryer në të shkuarën, por gjithashtu edhe për sjelljen tuaj të shkëlqyer. Shëndeti nuk paraqitet shumë mirë.

## PESHORJA (23/IX-22/X)



Në ambientin e punës dhe familje është mirë të tregoheni më të rezervuar. Jeta juaj e përditshme mund të turbullohet si shkak i personave pak korrektë e pa skrupuj. Mundoni të shfrytëzoni intuitën tuaj për të kuptuar më mirë të tjerët.

## AKREPI (22/X-21/XII)



Asnjë nuk mund t'ju ndalojë sot. Në qoftë se jeni duke dhënë provime, ose do të bëni një takim pune, vazhdoni të qetë, sepse nuk keni pengesa për të kaluar. Në dashuri jeni të gatshëm të kaloni çdo rrezik të shtyrë nga forca e ndjenjave për të bërë për vete dikë që ju intereson.

## SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Është tamam koha për të vepruar në qoftë se doni të realizoni disa ambicie profesionale e fi nanciare përpara se të fi llojnë pushimet. Qetësia në sektorin e ndjenjave vjen si shkak i transitit planetar në fundjavë. Mundohuni të jeni të përgatitur për të shijuar shumë kënaqësi që ju fal dashuria.

## BRICJAPI (22/XII-20/I)



Me Marsin në pozicion strategjik duke fi lluar që sot dashuria dhe udhëtimet do të kenë më shumë hapësirë. Por nuk do të jetë vetëm dashuria që do të ketë avantazhe. Në fakt edhe puna e studimi do të jenë të favorizuara gjatë kësaj periudhe.

## UJORI (20/I-19/II)



Hëna dhe Mërkuri ju ndihmojnë të kuptoni se ku ju leverdis më mirë të perfeksiononi projektet tuaja. Edhe pse nuk do të mungojnë okazionet për të bërë miqësi të reja, për ju do jetë një motiv i madh kënaqësie të ripërtëri marrëdhënie të vjetra.

## PESHQIT (20/II-19/III)



Sot do të jetë e nevojshme të ruani qetësinë, të ulni ritmin e punës dhe t'u jepni drejtimin e duhur veprimeve tuaja. Në dashuri mos humbni kohë me një person që nuk ju përshatatet. Afërdita sot do ju ndihmojë të gjeni personin e duhur.

# Sudoku

	9			6	5		8	
3					9			4
	1		2				7	
1	4					6		
6				1				9
		7					2	1
	6				3		1	
2			6					8
	7		8	4			6	

## SOT U BËNË 31 VITE PA BIJËN, MOTRËN, HALLËN TONË



## LINDIME SHATE (31.03.1970 – 15.08.1986.)

Fjalët s'kanë forcë për ta shprehur mallin, dhimbjen dhe pikëllimin, për mungesën e bijës sonë të dashur... 31 vite pa Ty, pa buzëqeshjen tënde, shikimin engjëllor. Na mungon dhe do na mungojnë në përjetësi, prezenca dhe virtytet e larta që i posedoje...

Na ike në pranverën e rinisë, na ike duke na lënë me zëmër të thyer.

"Malli dhe kujtimi për ty, do të jenë të përjetshëm"...

Të përkujtojnë me mall dhe dashuri babai Arslan, Nëna Myzejen, vëllai Agron me Laurën dhe nipërit e mbesa; Elioni, Lindi, Egzona ...

LLQJ MOLLE	LLQJ VARGU TRE PUESOR QYTET NË SIBERI (SHQ.)	A	LUMË NË FRANCË	PJESËTAR I NJË FISË MONGOL	BANORË E NJERIT NGA KONTINENTET	HUMANISTJA E NUOHUR SHQIPTARË NË FOTO									
J															
PESHQIR															
BIRRË GJERMANE TEKSTI I FILMIT (SH. PASHQ.)															
S															
INFORMATION SYSTEM				RITUAL BOJË LUI PËR PIKTURIM (SHQ.)											
NË V. 2013, NGA ANA E VATIKANIT, HUMANISTJA JONË U SHPALL...	TANTAL LLQJ EMBËLSIRE TË THATE (SH.)				SHKOP BILARDOJE, TAK URUGUAJ					HUMANISTJA JONË FITOI ÇMIMIN NOBEL ...	KOHA	SHTET NEAZI	NXËNËSI ME I NUOHUR TBUDES	U.XH.	VEGËL PËR TË HAPUR DIÇKA (SH.)
E															
INTERNATIONAL TELECOMMUNICATION UNION					EMRI I VJETËR I STADIUMIT TË BUDAPESTIT INSAN						SHRAT ARMIKU I PUFEVE (SMURFS)				
SULFUR ENË PREJ NJË OKE, OKATARE		HUMANISTJA JONË NË FOTO, BOJAXHIU AKULLNAJË													
O															LITËR VENDVDEKIA E AKTIVISTES SONE
NJANCË E NGJYRES SE VERDHE, OKRA															
PJESA E BUTË E MISHIT FRONTI															
B															
PËREMËR VETOR				IDHULLI I PAGANEVE SHKËMB I MADH											KASËM TREBESHINA ERBIUM
Mensur Mamuti	VENDLINDJA E HUMANISTES SHPËTIM KASTRATI										USHTARAKU GREK ITROJES				Ë.R.
BURRË SHTETI											JO POSHTË SUPERMEN				
NJERËZ QË TË KEPLISIN, RRASKAPITESIT															FLORI

ZGJIDHJET: A, JONATAN, MARAMË, SPATEN, SKENARË, IS, RIT, TA, KE, E BEKUAR, ITU, NEP, KAUC, S, ANJEZË GONXHE, OKARE, ARARA, L, OKERI, PRENKË, TULL, SAGADAS, BALLI, PAQA, ALA, TI, TOTEMI, KT, SHKUPI, ENEU, SHJETAR, LARTE, KËPUTËSIT, AR.





## Ibra nxjerr video-lojën për celularë



Ndoshta nuk është futbollisti më i mirë në botë, por Zlatan Ibrahimović është pa dyshim një nga personazhet më të veçanta të botës së futbollit në vitet e fundit. Suedezi, i cili vuan një dëmtim në ligament, është për momentin pa ekip dhe po pret që ndonjë klub ta marrë me kosto 0. Në këto kushte, 35-vjeçari ka përfutur për të përgatitur video-lojën e tij që quhet "Zlatan Legends". Bëhet fjalë për një lojë për celularë që do të jetë e disponueshme nga data 17 gusht. E vetmja gjë që dihet për këtë lojë është se kostumi i Zlatan ngjan shumë me atë të Iron Man.

## Femrat punojnë më shumë se meshkujt

Salma Hayek ka ngritur zërin për pabarazinë gjinore, duke u shprehur se gratë punojnë më shumë sesa burrat por janë më pak të prirura për të kërkuar rroga të larta. Producentja dhe aktorja meksikane ka thënë se meshkujt kanë standard më të ulët, por ndihen të fuqishëm për të kërkuar më shumë para. Në një intervistë të dhënë së fundmi, ajo është shprehur: "Femrat punojnë më shumë sesa meshkujt. Ato janë më shumë kërkuese ndaj vetes dhe kanë ndjesinë që nuk kanë dhënë mjaftueshëm dhe për këtë arsye nuk guxojnë të kërkojnë një pozicion apo pagë më të mirë. Meshkujt punojnë më pak, ata janë më pak kërkues tek vetja dhe standardet e tyre janë më të ulëta. Por pavarësisht kësaj, ata kërkojnë një rritje apo promovim".



## Vjen Facebook TV, quhet "Watch"

Pas shumë thashethemeve për "Facebook TV", ai vjen vërtetë. Rrjeti social me 2 miliardë përdorues publikon "Watch", një aneks për videot ku nxjerr episode, spektakle, ngjarje sportive që do të bëjë trampolinën dhe për prodhime origjinale. Kjo risi për momentin është për një grup të ngushtë përdoruesish në SHBA, por pas kësaj faze fillestare ky opsion do të zgjerohet zonën e vet. Një lëvizje që sfidon platfor-



ma si YouTube apo Netflix.


"Të shohësh një spektakël nuk duhet të jesh pasiv, mund të jetë rasti për të shpërndarë një eksperiencë e për të bashkuar persona që duan të njëjtat gjëra", shpjegon Mark Zuckerberg në një postim.

Watch, shpjegon Facebook, do të jetë i aksesueshëm nga të gjitha platformat e rrjetit: web, aplikacioni për telefona dhe "smart tv".

## KALENDARI HISTORIK 15 GUSHT

939 - Beteja e Simankas-Spanja mund Murët.  
1538 - Bogotá në Kolumbi themelohet nga Gonzalo Jiménez de Quesada.  
1661 - Traktati i Hagës nënshkruhet nga Portugalia dhe Republika holandeze.  
1726 - Perandori Karli VI dhe carina Katerina e Madhe nënshkruajnë traktat ushtarak.  
1819 - Themelohet Universiteti i Norwich-it në Vermont si shkolla e parë private ushtarake në SHBA.  
1825 - Bolivia fiton pavarësinë nga Peru (Dita Kombëtare).  
1845 - Themelohet Shoqata Gjeografike Ruse në Shën Petersburg.  
1870 - Beteja e Spiherenit: Prusia mund Francën.  
1896 - Franca përvetëson Madagaskarin.  
1914 - Austro-Hungaria i shpall luftë Rusisë dhe Serbisë.  
1937 - SHBA dhe BRSS nënshkruajnë traktat tregtar.  
1940 - Estonia bëhet pjesë e Bashkimit Sovjetik.  
1962 - Xhamajka shpall pavarësinë pas 300 vjet sundimi britanik.

## A E DINI SE...



Apple ka më shumë para se që kanë Shtetet e Bashkuara në arkën shtetërore.

Një bebe ka mbi 60 kocka më shumë se sa një i rritur.



Në Amerikë, çdo ditë shërbehen afro 100 hektarë pica dhe çdo ditë hahen afro 22 milionë pula.

## BARSOLETA



### PSE PO GËNJEN?

**Gruaja:** Pse po gënjën, ti ishe duke shkuar 70 km/h.  
**Burri:** Moj ti, mos fol!  
**Polici:** Po ju s'keni vënë as rripin e sigurisë.  
**Burri:** Por unë e hoqa tani, pasi më ndaluat ju.  
**Gruaja:** Prapë po gënjën ti, rripin nuk e kishe.  
**Burri:** Mbylle gojën.  
**Polici:** Gjithmonë flet ky me ju kështu?  
**Gruaja:** Jo jo, vetëm kur është i dehur!

## THËNIA E DITËS

Arsyeja pse e quajnë "Ëndrra amerikane" është se duhet të jesh në gjumë ta besosh.  
(Xhorxh Karlin)

